

---

## BULETIN INFORMATIV

---

Maj 2024

AKADEMIA E SHKENCAVE  
E SHQIPËRISË

---



---

**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së  
Shkencave të Shqipërisë**

Maj, 2024

---

## Përmbajtje

Letër e hapur e kryetarëve të akademive kombëtare të shkencave të vendeve anëtare të Bashkimit Europian drejtuar kandidatëve për zgjedhjet e Parlamentit Europian 2024.....	7
Akad. Skënder Gjinushi, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, priti në një takim Presidentin e Komisionit Ndërkombëtar për Digat e Mëdha prof. Mishel Lino dhe Kryetarin e KKDM Arjan Jovanin.....	10
Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë sot u mbajt ceremonia e përirimit të Qendrës së ringritur të Studimit të Arteve si njësi kërkimore afatgjatë e ngritur pranë Akademisë së Shkencave .....	12
Themelohet pranë Akademisë së Shkencave si njësi afatgjatë Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës (QKBGj).....	15
Veprimtari përmblylësë në kuadër të 100-vjetorit të lindjes së shkrimtarit dhe studiuesit Jakov Xoxa .....	17
Vlerësohet e nderohet vepra e albanologut francez Mario Roques, anëtar i Akademisë së Shkencave të Francës dhe i Akademisë së Shkencave të Belgjikës .....	19
Përgëzime gjuhëtares Enkeleida Kapia, punonjëse shkencore e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë pranë ASHSH, fituese e çmimit të parë ndërkombëtar në konkursin e shpallur nga “Journal of International Phonetic Association” për studimin shkencor më të ilustruar, referuar punimit të saj “Toskërishtja veriore: ilustrim sipas parimeve të Alfabetit Fonetik Ndërkombëtar” .....	21
Shpallen veprat e nominuara nga juria për çmimin e veçantë "Pilika" .....	26
U zhvillua në Akademinë e Shkencave lectio magistralis me temë "Con-ri-sonanza" nga prof. dr. Thoma Simaku.....	29
“Nderi i Akademisë” për Theofan Popën.....	35
Nderohet në Akademi Theofan Popa, shpëtuesi, kataloguesi, mbrojtësi dhe studiuesi i trashëgimisë kishtare të Shqipërisë .....	36
Zhvillohet workshop-i ndërkombëtar “Përgjigjet ndaj streseve biotike dhe abiotike, kujtesa& diversiteti epigjenetik i drithrave .....	41

Akad. Arben Merkoçi, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, drejtues i njësisë së kërkim-studimit në nanoteknologji, njohur me emrin "NanoAlb", zgjidhet anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave .....	43
Dorëshkrimet ungjillore të ruajtura në hapësirën historike shqiptare: shija dhe luksi metropolitan në kodikët e Shqipërisë.....	45
Ali Aliu riboton me ripunim librin "Don Kishoti shqiptar" .....	48
Egon Gjadri e Enver Preza, "Nderi i Akademisë".....	50
Takimi rajonal për krijimin e një konsorciumi ballkanik për bimët aromatike dhe mjekësore (MAPs) .....	54
"Baladë dritash për Zef Zorbën", libri i sapobotuar i Viola Isufajt, botim i Akademisë së Shkencave, përurohet në bibliotekën "Marin Barleti" të Shkodrës.....	57
Akademia e Shkencave e Shqipërisë - veprimtari përruruese për "Fjalorin e pemëtarisë", në nderim të autorit, prof. dr. Agim Zajmi, në njëvjetorin e ndarjes së tij nga jeta. ....	59
"Kultura mesjetare në hapësirat arbërore" .....	64
Përkujtohet me nderim në vendlindjen e tij në Pallagorio (Puhëriu) veprimtaria e italo-arbëreshit Anselmo Lorecchio, në 100-vjetorin e ndarjes nga jeta .....	65
Për veprimtarinë shkencore kushtuar akademikut albanolog Mario Roques .....	68
Zhvillohet në Vienë mbledhja ceremoniale tradicionale për vitin 2024, organizuar nga Akademia e Shkencave e Austrisë (ÖWA).....	72
U mbajt në Mitrovicë forumi shkencor "Studimi gjeologo-sizmik i zonave së thyerjeve tektonike tërthore Kurbnesh-Kukës-Prizren dhe Shkodër-Pejë dhe vlerësimi i rrezikut sizmik" .....	75
Paweł Rowiński, President i ri i ALLEA-s.....	79
80 vjet nga Kongresi i Përmetit.....	80
Një studim për rolin diferencues të rivaliteteve kishtarë, kundërvëniet politike dhe transformimeve iluministe nga akad. Albert Doja .....	82
Viti i Anselmo Lorecchio-s: nderime shkencore e zyrtare në Itali nga njësia për arbëreshët pranë Akademisë së Shkencave dhe institucione të tjera .....	83



<b>Mbi ecurinë e Enciklopedisë Shqiptare .....</b>	<b>86</b>
Seminar informues dhe instruktiv i të gjitha redaksive të "Enciklopedisë shqiptare" në sallën "Aleks Buda", me pjesëmarrjen e kryeredaktorit të "Enciklopedisë" akad. Skënder Gjinushit .....	87
Bashkëbisedim informues dhe udhëzues i drejtuesve dhe anëtarëve të redaksive të fushave të "Enciklopedisë shqiptare" me redaksinë vendore .....	88
Sektori i enciklopedisë i QBAE për ecurinë e punës në redaksitë e fushave në fazën e përgatitjes dhe dorëzimit të fjalësit paraprak dhe për disa probleme drejt fjalësit themelor përfundimtar .....	92
"Enciklopedia shqiptare" do të realizohet duke zbatuar një disiplinë të vetme shkencore në përzgjedhje .....	96
Drejt stabilizimit të fjalësit të "Enciklopedisë shqiptare" .....	100
Takim i redaksive të fushës së arkeologjisë dhe historisë së lashtë të ngritura për "Enciklopedinë shqiptare" në Shqipëri dhe në Kosovë.....	103
U zhvillua takimi i redaksive të trashëgimisë kulturore dhe identitetit shqiptar të ngritura në Shqipëri e në Kosovë për "Enciklopedinë shqiptare" .....	105
U mbajt takimi i redaksive të arteve skenike, pamore dhe multimediale të ngritura në Shqipëri e në Kosove për "Enciklopedinë shqiptare" .....	107
Dy redaksitë për letërsinë, në Tiranë e në Prishtinë, takohen për fjalësin themelor të "Enciklopedisë shqiptare" .....	109
Përfunduan takimet e pesë redaksive të grupfushës së albanologjisë .....	111
Progresi në hartimin e "Enciklopedisë shqiptare": nga fjalësi i përbashkët (i njësuar) drejt fjalësit të stabilizuar .....	113
Njësimi i "Enciklopedisë shqiptare" nis me kriteret e miratuara nga redaksia qendrore dhe vijon me fjalësin e integruar dhe "pragjet" e barazuar për pranimin e njësive enciklopedike .....	116
Mbahen takimet e katër redaksive të ngritura në Tiranë me gjegjëset e tyre në Prishtinë për hartimin e "Enciklopedisë shqiptare" .....	120
Pesë redaksi të tjera, të shkencave teknike e natyrore, konvergojnë propozimet për një fjalës të përbashkët të "Enciklopedisë shqiptare" .....	123
Përfundojnë takimet dypalëshe të redaksive të ngritura sipas fushave / disiplinave në Tiranë e në Prishtinë për "Enciklopedinë shqiptare" .....	127

---

<b>Mbi ecurinë e projektit "Historia e Shqiptarëve" .....</b>	<b>132</b>
Takim i redaksisë së "Historisë së shqiptarëve" në Kryesinë e Akademisë së Shkencave .....	133
<b>Botime të reja .....</b>	<b>135</b>
Botohet italisht, me titullin "La guerra di Scutari - da un manoscritto sconosciuto di Marino Barlezio" ("Lufta e Shkodrës - nga një dorëshkrim i panjohur i Marin Barletit"), dalë më parë në shqip, me titullin "Barleti i hershëm", sipas një dorëshkrimi të panjohur të Marin Barletit .....	136
<b>Nekrologji.....</b>	<b>139</b>
U nda nga jeta prof. Andrea Shundi ("Nderi i Akademisë") .....	140

---

## **Letër e hapur e kryetarëve të akademive kombëtare të shkencave të vendeve anëtare të Bashkimit European drejtuar kandidatëve për zgjedhjet e Parlamentit European 2024**

- Europa qendron në krye në shkallë globale për shkencën dhe kërkimin shkencor
- E ardhmja e Europës është e varur nga shkenca dhe arsimimi
- Duhet të arrihet objektivi që të gjitha shtetet e Europës të arrijnë objektivin për të investuar 3 për qind të PBB në vit për kërkim e zhvillim
- Vendimmarrësit duhet të mbrojnë liritë akademike dhe autonominë institucionale
- Sigurimi i leadershipit global të Bashkimit European në shkencë dhe inovacion: shkenca nuk është vetëm për bashkëpunimin dhe ekonominë, shkenca prodhon mendim e reflektim tek politikëbërja

Europa qëndron në krye në shkallë botërore për shkencën, kërkimin dhe inovacionin. Shkencëtarët në gjithë Bashkimin European janë të angazhuar në kërkimin dhe zgjidhjen e problemeve themelore, praktike dhe sociale. Shkenca dhe inovacioni janë thelbësore për lirinë dhe qëndrueshmërinë e Bashkimit European, për konkurrencën, prosperitetin dhe mirëqenien e tij globale. Kjo nuk duhet të merret si e mirëqenë. Është thelbësore të ruhet natyra e hapur dhe bashkëpunuese ndërkombëtare e kërkimeve shkencore, të investohet në gamën e plotë të shkencës dhe të sigurohet që arritjet shkencore të përkthehen në politika që adresojnë sfidat kryesore me të cilat përballen shoqëritë tona demokratike.

### **Mbështetja financiare e një sistemi shkencor të fortë, të hapur dhe të lirë**

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shkëmbimi i hapur i njohurive, studiuesve dhe studentëve janë kapitali më i madh i Bashkimit European dhe ndarja e ndërsjellë e njohurive është një parakusht i rëndësishëm për përparimin shkencor dhe teknologjik. Bashkëpunimi i hapur shkencor ndërkombëtar është gjithashtu i rëndësishëm për marrëdhëniet ndërkombëtare, përtej fushës akademike. Vendimmarrësit duhet të tregohen të përmbajtur dhe të ruhen nga krijimi i pengesave dekurajuese në këtë drejtim. Ata duhet të mbrojnë parimet e lirisë akademike, autonominë institucionale akademike dhe shkëmbimin e hapur ndërkombëtar të njerëzve dhe informacionit, duke garantuar në çdo kohë kushte të sigurta dhe të qëndrueshme pune për studiuesit dhe studentët.

---

## **Investimet në shkencë dhe arsimim**

Shkenca dhe kërkimi akademik janë të rëndësishme jo vetëm për biznesin dhe prosperitetin ekonomik; ato prodhojnë mendim dhe reflektim të pavarur kritik, dhe kjo është baza për demokraci të gjalla dhe elastike. Për të siguruar lidershipin global të Europës në shkencë dhe inovacion kërkohen investime të fuqishme në kërkim, inovacion dhe arsimim. Për të ecur në një hap me pjesët e tjera të Botës, Bashkimi Europian dhe shtetet anëtare të tij duhet të arrijnë objektivin e rënë dakord bashkërisht për të investuar 3 për qind të PBB-së çdo vit në kërkim dhe zhvillim. Përveç kësaj, ata duhet - me përfshirjen e konsiderueshme të Parlamentit Europian - të forcojnë programin kuadër të Bashkimit Europian për kërkimin dhe inovacionin dhe cilësinë e arsimit europian në nivelin më të lartë.

### **Përdorimi i njohurive aktuale shkencore në politikëbërje**

Me programin e tij kuadër dhe me ERA-n (Zonën Europiane të Kërkimit), Parlamenti Europian, ka një përgjegjësi të madhe për promovimin e shkencës dhe inovacionit në vendet e Bashkimit Europian. Ne u bëjmë thirrje shteteve anëtare dhe institucioneve të Bashkimit Europian që, vazhdimisht dhe me maturi, t'i përdorin njohuritë shkencore në politikëbërjen e tyre. Sfidat që qëndrojnë para nesh - si ndryshimi i klimës dhe varfërimi i biodiversitetit, migrimi ndërkombëtar, siguria ushqimore, tranzicioni alternativ i energjisë - për të përmendur vetëm disa - janë kaq komplekse dhe urgjente, sa nuk mund të zgjidhen pa shkencë dhe pa një dialog të besueshëm midis shkencës, politikës, shoqërisë civile dhe aktorëve ekonomike. Pa këtë dialog nuk mund të ketë zgjidhje efektive.

Vijojnë nënshkrimet e kryetarëve të akademive të shkencave të vendeve anëtare të BE.



---

**Akad. Skënder Gjinushi, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, priti në një takim Presidentin e Komisionit Ndërkombëtar për Digat e Mëdha prof. Mishel Lino dhe Kryetarin e KKDM Arjan Jovanin**



Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi, sot më 15 maj 2024, priti në një takim Presidentin e ICOLD- The International Commission on Large Dams (Komisioni Ndërkombëtar për Digat e Mëdha), prof. Mishel Lino bashkë me Kryetarin e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM), Arjan Jovanin.



Në këtë takim ishte i pranishëm akad. Neki Frashëri, Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike pranë ASH.



---

U diskutua për bashkëpunimin me Akademinë e Shkencave, për këmbimin e përvojave ndërmjet ICOLD dhe KKDM dhe specialistëve brenda vendit me analogët e tyre jashtë vendit, për monitorimin dhe sigurinë e digave të mëdha, si dhe standardet në projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave të mëdha.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për vlerësimin me çmim nga Akademia e Shkencave të personaliteteve në sektorin e digave të mëdha të propozuara nga KKDM.

Vlerësimi do të bëhet në kuadër të simpoziumit teknik “Challenges and Innovations for Better dams”, që do të mbahet në datat 16-17 maj 2024 në “Hotel Tirana, në Tiranë.

Ne këtë simpozium do të shkëmbehen përvojat në lidhje me projektimin dhe monitorimin e digave në Shqipëri dhe në Francë, ku përfaqësues të KKDM dhe CFBR do të diskutojnë për sfidat dhe të rehat në kuadrin ligjor dhe organizativ për një reformë në sektorin e digave, standardet teknike të nevojshme për projektimin dhe monitorimin e digave si dhe për inovacionet e fundit për monitorimin e digave të mëdha dhe rezervuarëve të krijuar prej tyre.

## Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë sot u mbajt ceremonia e përrurimit të Qendrës së ringritur të Studimit të Arteve si njësi kërkimore afatgjatë e ngritur pranë Akademisë së Shkencave

Ceremonia u çel në praninë e emrave të njohur të artit shqiptar me një fjalë përshëndetëse nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave. Në vijim foli zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave akad. Vasil S.Tole.

Për punën e kësaj qendre dhe perspektivat e saj foli akad. Stefan Çapaliku.

QSA është një institucion kërkimor-shkencor pjesë e strukturës së Akademisë së Shkencave, i themeluar në vitin 1986.

Qendra ka si objekt studimin e arteve shqiptare: artet figurative, teatrin, kinemanë, muzikën, koreografinë, fushat e bashkëveprimit të arteve.

Studimet teorike dhe ato mbi problemet metodologjike ishin parësore përpara vitit 1991.

Pas vitit 1993 studimet e historisë së arteve në Shqipëri dhe vështrimet kritike e analitike mbi to zunë vendin kryesor, pa përjashtuar edhe studimet në rrafshin teorik e metodologjik, kur ishte e nevojshme.



QSA i kushtoi vëmendje trashëgimisë dhe traditave në artet shqiptare, duke filluar që nga periudhat e hershme, ajo e mesjetës e deri sot; trajtoi çështje e dukuri që lidheshin me rrjedhat bashkëkohore të arteve në Shqipëri. Ajo funksionoi si njësi unike e organizuar

në tre sektorë: ai i arteve figurative, ai i arteve skenike dhe kinematografisë dhe ai i muzikës dhe koreografisë.

QSA bashkëpunonte në projekte me rëndësi kombëtare, si ato të Qendrës Enciklopedike në Akademinë e Shkencave, me Akademinë e Arteve, me institutet e albanologjisë të Akademisë së Shkencave, me institucionet kulturore-artistike kombëtare, si dhe institucione kërkimore shkencore në Kosovë e gjerazi në Ballkan, Europë e gjetkë.

Libra të tillë si "Kumti që vjen nga trashëgimia teatrore", "Aktorët, regjisorët, poetikë regjisoriale", "Dialog me teatrin botëror", "Teatri Kombëtar" të Josif Papagjonit; "Paradokset e satirës dhe humorit", "Imazhe, kode, kumte", "Rrjedhave të artit paraprofesionist", "Poetika e dramaturgjisë dhe mendimi estetik" të Jakup Matos; "Letërsia dhe filmi", "Koha e filmit" (në dy vëllime); "Filmi në kapërcyell të shekullit" të Abdurrahim Myftiut; "Artet figurative në periudhën e Rilindjes dhe Pavarësisë", "Shqipëria nëpërmjet artistëve" të Ferid Hudhrit; "Hyrje në estetikë" të Stefan Çapalikut etj. janë mirëpritur nga lexuesi dhe opinioni kritik shkencor.



Në vitin 2000 QSA ndërmori projektin "Enciklopedia e artit shqiptar", në bashkëpunim me Akademinë e Shkencës dhe Arteve në Kosovë.

Studiuesit e saj kanë marrë pjesë me projekte dhe kumtesa në veprimtari shkencore e botuese brenda e jashtë vendit.

QSA boton revistën shkencore "Studime mbi artin", numri i parë i së cilës ka dalë në vitin 1995. Drejtorë të kësaj reviste kanë qenë: prof. asoc. dr. Çapajev Gjokutaj, prof. asoc. dr. Abdurrahim Myftiu, prof. dr. Jakup Mato, prof. dr. Ferid Hudhri, prof. dr. Josif

---

Papagjoni, prof. Stefan Çapaliku dhe sot dr. Jonida Gashi.

Në shtator 2007 ajo kaloi si institucion pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, e integruar si departament më vete në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Arteve.

Me reformën shkencore të vitit që shkoi Qendra e Studimit të Arteve doli edhe njëherë si njësi shkencore më vete, duke shtuar organikën e vet, e cila do vazhdojë të jetë në zgjerim.



Për momentin QSA është angazhuar në përpilimin e “Kalendarit historik të eventeve artistike” (1879-2024), një vepër madhore kjo që do të përbëjë objektin e punës të të gjithë studiuesve të artit.

Me këtë rast i urojmë jetë të gjatë dhe suksese të mëtjshme në punën për studimin e arteve të kultivuara shqiptare.

---

## **Themelohet pranë Akademisë së Shkencave si njësi afatgjatë Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës (QKBGj)**

- Sot në mbledhjen e Këshillit të Ministrave miratimi i Vendimit të propozuar nga ASHSH

- QKBGj, e para njësi afatgjatë që ngrihet bazuar në Ligjin nr. 53/2019

- Pas rikthimit të instituteve të albanologjisë, një hap tjetër për fuqizimin e ASHSH Këshilli i Ministrave miratoi sot ngritjen e njësisë së kërkim-studimit me aktivitet afatgjatë “Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës” pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, e cila ushtron veprimtarinë në fushat e bioshkencës dhe të gjenetikës.

Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës ka për qëllim të nxisë, të promovojë, të koordinojë e të organizojë kërkimin shkencor në drejtimet parësore më me ndikim, përmes projekteve dhe studimeve të përbashkëta me institucionet e arsimit të lartë e të shkencës dhe krijimit e angazhimit të rrjetit të bashkëpunëtorëve.

Sipas këtij vendimi, Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës funksionon në ambientet dhe me pajisjet që Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë i siguron sipas marrëveshjes përkatëse me Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Numri i punonjësve të kësaj qendre do të jetë 8 veta.

### **V E N D I M**

**Nr. 298, datë 15.5.2024**

**PËR**

**NGRITJEN E NJËSISË SË KËRKIM-STUDIMIT ME AKTIVITET AFATGJATË  
“QENDRA KËRKIMORE E BIOTEKNOLOGJISË DHE GJENETIKËS” PRANË  
AKADEMISË SË SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 53/2019, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

### **V E N D O S I:**

1. Ngritjen e njësisë së kërkim-studimit me aktivitet afatgjatë “Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës” pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, e cila ushtron veprimtarinë në fushat e bioshkencës dhe të gjenetikës.



---

2. Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës ka për qëllim të nxisë, të promovojë, të koordinojë e të organizojë kërkimin shkencor në drejtimet parësore më me ndikim, përmes projekteve dhe studimeve të përbashkëta me institucionet e arsimit të lartë e të shkencës dhe krijimit e angazhimit të rrjetit të bashkëpunëtorëve, në përputhje me përcaktimet në statutin e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.

3. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Qendrës Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, detyrat dhe kompetencat e organeve të saj drejtuese, zgjedhja, rekrutimi i drejtuesve dhe i anëtarëve, si dhe i personelit ndihmës përcaktohen në përputhje me ligjin nr.53/2019, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me statutin dhe rregulloret e brendshme të Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.

4. Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës funksionon në ambientet dhe me pajisjet që Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë i siguron sipas marrëveshjes përkatëse me Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

5. Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës ka buxhetin e vet, që përbën zë të veçantë në buxhetin e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë. Administrimi i buxhetit dhe veprimet e tjera zyrtare kryhen nga administrata e Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.53/2019, “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me statutin e saj, si për njësitë afatgjata.

6. Numri i punonjësve të Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës është, gjithsej, 8 veta.

7. Shpenzimet financiare për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës përballohen nga buxheti i miratuar për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, për vitin 2024.

8. Ngarkohet Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.




## Veprimtari përmbyllëse në kuadër të 100-vjetorit të lindjes së shkrimtarit dhe studiuesit Jakov Xoxa

- Sot në sallën "Aleks Buda" të Akademisë së Shkencave:
- Premierë e dokumentarit "Jakov Xoxës, në 100-vjetorin e lindjes", me regji të Ylli Pepos



"Jakov Xoxa, shkrimtari dhe studiuesi", botim i ri i Akademisë së Shkencave, akte të konferencës së organizuar vitin e kaluar, me pjesëmarrjen e studiuesve të letërsisë bashkëkohore nga gjithë rrjeti i universiteteve shqiptare.

- "Unë dhe Jakovi", kujtime të Dhurata Xoxës



---

Veprimtaria u drejtua nga aktori Mevlan Shanaj. Për paraqitjen e librit të akteve të konferencës shkencore foli akad. Shaban Sinani, përkujdesës i botimit, së bashku me dr. Brunilda Priftin. Libri përmban 17 referime dhe 3 përshëndetje.



Veprimtaritë për 100-vjetorin e Jakov Xoxës u hapën në prillin e vjetshëm, me dhënien për herë të parë të çmimit që mban emrin e tij gjatë panairit të librit akademik dhe shkencor në Prishtinë. Në këtë kuadër, me bashkëpunimin e Fondacionit "Fan S. Noli", u bë ribotimi fototipik i librit më të rëndësishëm shkencor të Jakov Xoxës, "Hyrje në shkencën e letërsisë" (një prej tre teksteve universitare të tij), i ribotuar tri herë në Tiranë, dy herë në Prishtinë dhe një herë në Tetovë, më pas padrejtësisht i lënë mënjanë.

Me këto botime dhe me konferencën shkencore, tha Sinani, u rikonfirmua vendi i rëndësishëm i letërsisë së Jakov Xoxës në historinë e letërsisë së re shqipe, si një autor i pangjashëm në jetë e i pangjashëm në vepër. Ai theksoi se dukuria e vetëlargimit, që përbën një nyje kthese të jetës së Jakov Xoxës, është rast më vete dhe nuk është studiuar ende. Jubileu shërbeu gjithashtu edhe për të adresuar tek kërkuesit e rinj teza e mikroteza studimore nivelesh të ndryshme, prej identifikimit gjuhësor të karaktereve deri tek ikja e kujdesshme nga realizmi socialist drejt realizmit.

Për rëndësinë që pati nisma e Akademisë së Shkencave për nderimin e 100-vjetorit të Jakov Xoxës dhe për bashkëpunimin e disa institucioneve të tjera në këtë kuadër foli gjithashtu z. Agron Xoxa, djali i shkrimtarit. Libri "Jakovi dhe unë" u prezantua nga znj. Valentina Leskaj, njëherësh edhe mike e kolege e autores Dhurata Xoxa.

Çmimi "Jakov Xoxa" do të jetë i përvitshëm.

## Vlerësohet e nderohet vepra e albanologut francez Mario Roques, anëtar i Akademisë së Shkencave të Francës dhe i Akademisë së Shkencave të Belgjikës

- Tryezë shkencore "Mario Roques, themelues i filologjisë shqipe", organizuar nga departamenti i studimeve letrare i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë



U paraqitën katër kumtesa, nga studiues të letërsisë, të historisë së shkrimeve dhe të filologjisë kritike. Prof. dr. Tomorr Plangarica referoi për temën "Mario Roques - vijues i një tradite dhe nismëtar i një tjetre (shqyrtimet filologjike dhe mësimdhënia e shqipes në Francë)"; prof. dr. Anila Omari për temën "Mario Roques, themelues i filologjisë së teksteve të vjetra shqipe"; prof. dr. Mimoza Priku për temën "Mario Roques në vëmendjen e gjuhëtarëve shkodranë" dhe prof. asoc. dr. Evalda Paci për temën "Mario Roques, magister et philologus omnium temporum" / "Mario Roques, mjeshtër dhe filolog i të gjitha kohërave".

Në emër të Kryesisë së ASHSH përshëndeti sekretari shkencor Shaban Sinani. Ai tha se kjo tryezë kushtuar njërit prej themeluesve të filologjisë së tekstit dhe posaçërisht të studimeve për librin më të vjetër shqip, "Mesharin", akademikut Mario Roques, njëherësh inkuadrohet në programin e Vitit të Gjuhës Shqipe. Vendi i "Mesharit" në studimet gjuhësore, dialektore, kulturologjike e fetare; në studimet për historinë e shkrimit të shqipes dhe të evolucionit të saj në të gjitha rrafshet, është gjithnjë në qendër; ndërsa shumë konsiderata të albanologut Mario Roques janë edhe sot, pas një shekulli, të paqortueshme.

Në këtë kontekst Sinani rishtroi pyetjen për të cilën Akademia e Shkencave ka organizuar disa vjet më parë një konferencë shkencore ndërkombëtare: cili duhet të jetë qendrimi shkencor i studiuesve ndaj "gjuhës së dytë" në dy shekuj e gjysmë letërsi; gjuhës së besnikërisë dhe garancisë kanonike, gjuhës së burimit të tekstit, gjuhës së krahasimit, gjuhës së përshtatjes, rikrijimit dhe krijimit (latinisht, italisht, greqisht). A do të vlerësohet edhe teksti "në gjuhën tjetër" pjesë e veprës autoriale? Kjo është një pyetje e pashmangshme, sidomos për letërsinë dygjuhëshe të shekullit të romantizmit, periudhë e letërsisë së autopërkthyer.



Në vijim ai veçoi si arritje pavarësimin e filologjisë kritike si disiplinë më vete, krahas studimeve letrare e gjuhësore, si dhe rëndësinë e profilizimit të mëtejshëm të shkollës së filologjisë vendëse, duke formuar specialistët e nevojshëm në disiplinat e ngushta (paleografi, epigrafi) dhe në gjuhët e kulturave të hershme (latinisht e greqisht).



---

**Përgëzime gjuhëtares Enkeleida Kapia, punonjëse shkencore e Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë pranë ASHSH, fituese e çmimit të parë ndërkombëtar në konkursin e shpallur nga “Journal of International Phonetic Association” për studimin shkencor më të ilustruar, referuar punimit të saj “Toskërishtja veriore: ilustrim sipas parimeve të Alfabetit Fonetik Ndërkombëtar”**



- Bashkautorë të studimit: Stefano Coretta (Universiteti i Edinburgut), Josiane Riverin-Coutlee (Universiteti “Ludwig Maximilian” i Mynihut) dhe Stephen Nichols (Universiteti i Oksfordit)

Prof. asoc. dr. Enkeleida Kapia, punonjëse shkencore e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, së bashku me kolegët e saj, Stefano Coretta (Universiteti i Edinburgut), Josiane Riverin-Coutlee (Universiteti Ludwig Maximilian i Mynihut) dhe Stephen Nichols (Universiteti i Oksfordit) janë nderuar nga “Journal of International Phonetic Association Most Illustrative Illustration Prize” me çmimin e parë për studimin e tyre me titull “Northern Tosk Albanian: an IPA Illustration” (“Toskërishtja veriore: ilustrim sipas parimeve të Alfabetit Fonetik Ndërkombëtar”).

Ky çmim u jepet autorëve për metodologjinë bashkëkohore të përdorur në studim, në ndërveprim me mënyrat tradicionale të ilustrimit dhe të shpjegimit të detajuar të tingujve dhe të sistemit intonacionor të toskërishtes veriore.

Vlerësimi është bërë sipas parimeve “peer review” të anëtarëve të jurisë, e përbërë nga gjuhëtarë dhe foneticienë nga e gjithë Bota.

## Northern Tosk Albanian

**Stefano Coretta** Linguistics and English Language, University of Edinburgh  
*s.coretta@ed.ac.uk***Josiane Riverin-Coutlée** Institute of Phonetics and Speech Processing, Ludwig-Maximilians-Universität München  
*josiane.riverin@phonetik.uni-muenchen.de***Enkeleida Kapia**Institute of Phonetics and Speech Processing, Ludwig-Maximilians-Universität  
München & Academy of Albanological Sciences  
*enkeleida.kapia@phonetik.uni-muenchen.de***Stephen Nichols** Linguistics, Philology and Phonetics, University of Oxford & Language  
and Linguistics, University of Essex  
*stephen.nichols@phon.ox.ac.uk*

Albanian (endonym: *Shqip*; Glotto: alba1268) is an Indo-European language which has been suggested to form an independent branch of the Indo-European family since the middle of the nineteenth century (Bopp 1855, Pedersen 1897, Çabej 1976). Though the origin of the language has been debated, the prevailing opinion in the literature is that it is a descendant of Illyrian (Hetzer 1995). Albanian is currently spoken by around 6–7 million people (Rusakov 2017: 552; Curtis 2018: 1800), the majority of whom live in Albania and Kosovo, with others in Italy, Greece, North Macedonia and Montenegro. Figure 1 shows a map of the main Albanian-speaking areas of Europe, with major linguistic subdivisions according to Gjinari (1988) and Elsie & Gross (2009) marked by different colours and shades.

At the macro-level, Albanian includes two main varieties: Gheg, spoken in Northern Albania, Kosovo and parts of Montenegro and North Macedonia; and Tosk, spoken in Southern Albania and in parts of Greece and Southern Italy (von Hahn 1853, Desnickaja 1976, Demiraj 1986, Gjinari 1985, Beci 2002, Shkurtaj 2012, Gjinari et al. 2007). At the meso-level, Gheg and Tosk are usually further divided into the following sub-varieties (Gjinari 1988): Gheg includes Northwestern Gheg, Northeastern Gheg, Central Gheg and Southern Gheg; while Tosk includes Northern Tosk, Southern Tosk, Cham, Arvanitika and Arbëresh. The speakers recorded for this illustration were all born and raised in areas where Northern Tosk is spoken, namely the counties of Përmet and Fier. Thus, we consider the dolect (Cysouw & Good 2013) discussed here to belong to Northern Tosk.

Northern Tosk differs from other Tosk and Gheg varieties on several phonological and phonetic features. For instance, Gheg has contrastive vowel nasalisation, while Tosk lacks it, e.g. ‘drink.IMP:2SG’ and ‘numb.IMP:2SG’ are realised as /pi/ vs /pĩ/ in Gheg but as /pi/ vs /mpi/ in Tosk (Beci 1995). Northern Tosk also lacks vowel length contrasts, whereas pockets



---

Anëtari 1:

Vota ime shkon për studimin mbi toskërishten veriore, i cili shquhet për mënyrën se si kombinon përdorimin e të dhënave sasiore dhe cilësore për të mbështetur ilustrimin sipas parimeve të alfabetit fonetik ndërkombëtar. Veçanërisht mbresëlënës është integrimi i teknikave të shumta për imazhin e aspekteve të artikulimit, disa prej të cilave (si palatografia dhe labiogramet) janë me kosto të ulët dhe lehtësisht të zbatueshme. Cilësia e vizualizimit të të dhënave është një tjetër pikë e fortë e këtij studimi, dhe përshkrimi i përgjithshëm është i detajuar, por tejet i qartë.

Anëtari 2:

Është një ilustrim vërtet ilustrues, kështu që merr votën time.

Anëtari 3:

Më duket veçanërisht mbresëlënëse përfshirja e dy metodologjive artikuluase (imazheria e ekos së traktit vokal dhe palatografia statike) përveç analizës akustike - një shembull i bukur se sa i pasur mund të jetë një ilustrim i një gjuhe pa aq shumë karakteristika të jashtëzakonshme.

Anëtari 4:

Për mendimin tim, ky është një përshkrim i shkëlqyer i fonetikës segmentore dhe mbisegmentale të toskërishtes. Vlerësoj faktin se autorët kanë zgjedhur teknika të ndryshme analize dhe paraqitje grafike të ndryshme për të treguar karakteristikat më të rëndësishme fonetike të kësaj të folmeje të shqipes. Një pikë tjetër e fortë është lista shteruese e referencave bibliografike që kanë të bëjnë me fonetikën në përgjithësi dhe atë të gjuhës shqipe në veçanti.

Anëtari 5:

Unë votoj për toskërishten veriore. Transkriptet janë të qarta dhe të sakta. Ilustrimi është konciz dhe fokusohet në vetitë unike fonetike të shqipes, veçanërisht, kontrasti apikal dhe laminal i vërejtur në mbylltorët postalveolarë. Ky kontrast gjendet më rrallë në gjuhët e tjera. Përdorimi i palatogrameve, një pajisje tradicionale, ilustron dallimet apikale dhe laminalë, ndërsa imazhet me ultratinguj, pra me ekografi, një teknologji e re, qartësojnë dallimet gjuhësore midis aproksimanteve anësore dentare të velarizuara dhe atyre alveolare. Nga një këndvështrim sasior, hapësirat VOT dhe F1/F2 të zanoreve të folësve individualë japin vlera të detajuara. Figura 14 ofron gjithashtu kohëzgjatjen, intensitetin dhe f0 të theksit leksikor në tre rrokjet fundore të fjalëve.

---

Anëtari 6:

Nga pikëpamja metodologjike, mendoj se studimi për toskërishten veriore është më i pasuri dhe kandidati më i mirë pasi paraqet të dhëna palatografike dhe ekografike dhe për këtë arsye është shumë ilustrues dhe mbresëlënës.

Anëtari 7:

Studimi për shqipen është më shteruesi nga pikëpamja studimore dhe ka transkriptimin më të saktë.

Anëtari 8:

Për mendimin tim, studimi për toskërishten veriore ka kombinimin më të mirë të analizave akustike dhe artikulative (palatografi statike, ultratinguj, labiogramë) për të ilustruar aspekte të ndryshme të sistemit zanor me figura të përgatitura mirë, informative që ilustrojnë, [p.sh.](#) (fig. 4 & 5), artikulimi i mbylltoreve dhe të afrikateve (fig. 7) ose imazheria ekografike e traktit vokal kur shqiptohen /l/ dhe /ll/ (fig 10) ose zanoret (fig. 13).

Anëtari 10:

Ky ilustrim në veçanti tregon shumë mirë se si mund të përdoren metoda artikuluese me kosto të ulët (palatografi statike, fotografi) në përshkrimin e çdo gjuhe.

Anëtari 11:

Toskërishtja e Veriut për shumëllojshmërinë e metodave fonetike të përdorura.

Anëtari 12:

Punimi është shkruar mirë. Të dhënat janë vjelë nga pesë informatorë, duke ofruar njohuri të vlefshme edhe për variacionin mes folësve. Përveç provave akustike, studimi përfshin të dhëna me ultratinguj, palatogramë dhe labiogramë. Ai përfshin gjithashtu një syth mbi prozodinë në kontekste të ndryshme. Shifrat janë të lavdërueshme për qartësinë dhe transparencën e tyre, duke rritur cilësinë e përgjithshme të studimit. Mbresëlënëse është gjithashtu që autorët kanë përdorur edhe teknika të metodologjisë së artikulimit. Unë gjithashtu u jam mirënjohës që ata kanë ofruar një diskutim të ndjeshëm të prozodisë në nivel frazash.

Anëtari 13:

Shkruar shumë qartë dhe organizuar në mënyrë të përshtatshme; një kampion i konsiderueshëm folësish (5 informatorë); të gjitha materialet përkatëse (kodi në paketën R, formularët e miratimit, etj.) mund të sigurohen të gjitha përmes OSF; një përdorim i

---

shkëlqyer i analizave sasore të të dhënave akustike, spektrogrameve, grafikëve të formantëve, lakoreve të lartësisë së tingujve, etj., duke mbuluar të gjitha aspektet e dukshme të fonetikës së gjuhës; kjo plotësohet nga të dhënat e palatografisë statike (me cilësi të shkëlqyer) dhe gjurmimet e gjuhës me ultratinguj, pra me ekografi; fragmenti i paraqitur është transkriptuar për kategoritë sintaksore/morfologjike; skedarët zanorë janë të një cilësie të mirë (3 përsëritje për çdo fjalë) dhe duken të transkriptuara saktë.

Anëtari 14:

Ky punim është plot me ilustrime me të dhëna eksperimentale cilësore dhe me figura e tabela të përgatitura mire ... Prezantimet e kategorive të ndryshme të tingujve si edhe ato të prozodisë shoqërohen me pohime përshkruese koncize.

Anëtari 15: Votoj toskërishten veriore. Kam marrë parasysh qartësinë, saktësinë, përdorimin e analizave të të dhënave akustike dhe artikuluese (palatograme, UTI (imazheri ekografike e traktit vocal), labiogramë), risinë ([d.m.th.](http://d.m.th) mungesën e përshkrimeve të mëparshme) dhe përputhshmërinë me parimet e "Open Science".

---

## Shpallen veprat e nominuara nga juria për çmimin e veçantë "Pilika"

Juria e ngritur me vendimin nr. 29 datë 8.3.2024 të Kryesisë së Akademisë së Shkencave për organizimin e konkursit kombëtar për çmimin e veçantë "Pilika", që jepet për veprimtari të suksesshme në shkencat e matematikës; pasi vlerësoi prurjet në këtë konkurs, në përputhje me kalendarin e miratuar, shpalli veprat dhe autorët e nominuar:

I. Për disertacionin më të vlerësuar, mbrojtur e publikuar nga studiues shqiptarë gjatë periudhës 2010-2023 në shkencat matematike (renditja sipas alfabetit):

1. Besiana Çobani (Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, departamenti i matematikës, 2014): "Studime në teorinë e problemeve të anasjellta për ekuacionet me derivate të pjesshme";




2. Dhurata Valera (Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, departamenti i matematikës, 2015): "Rezultate në studimin e masës pseudo-aditive dhe aplikime të saj";



---

3. Enkeleda Zajmi-Kotonaj (Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i matematikës, 2014): “Mbi strukturat kuazi të normuara dhe disa aspekte integrimi në to”.



II. Për punimin më cilësor të realizuar nga studiues shqiptarë në këto shkenca, nën moshën 60 vjeç (renditur sipas alfabetit):

1. Artion Kashuri (autor i parë): “Some new Hermite-Hadamard type inequalities and their applications” / “Disa tipe të rinj mosbarazimesh Hermite-Hadamard dhe zbatime të tyre”; botuar në “Studia Scientiarum Mathematicarum Hungarica”, nr. 56 (1), p. 103-142 (2019);



2. Eriola Sila (autore e parë): “Equivalent Cauchy Sequences in  $(q_1, q_2)$ -quasi

---

metric-like space and applications to fixed-point theory” / “Vargjet e njëvlefshëm Cauchy në  $(q_1, q_2)$ -hapësirat pothuaj të ngjashme metrike dhe zbatime në teorinë e pikave fikse”; botuar në “Hindawi Journal of Mathematics”, vol. 2021, Article ID 5542787;



3. Kastriot Zoto (autor i dytë): “Bhaskar-Guo-Lakshmikantam-Ćirić type results via new functions with applications to integral equations” / “Rezultate të tipit Bhaskar-Guo-Lakshmikantam-Ćirić nëpërmjet funksioneve të rinj me zbatime në ekuacionet integrale”; botuar në “Applied Mathematics and Computation”, nr. 357 (2019), p. 75–87;



Shpallja e fituesve do të bëhet me një ceremoni të veçantë në ditët e konferencës kombëtare të matematikës, që do të zhvillohet në fillim të muajit qershor 2024.



## U zhvillua në Akademinë e Shkencave lectio magistralis me temë "Con-ri-sonanza" nga prof. dr. Thoma Simaku

- Kompozitori i shquar foli për filozofinë e krijimit dhe sfidat e procesit të krijimtarisë
- Moderatori i veprimtarisë prof. as.dr. Edmond Buharaja rrëfen veprimtarinë ndërkombëtare dhe prezanton dy CD-të e kompozitorit Thoma Simaku



Qendra e Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë organizoi lectio magistralis me temë "Con-ri-sonanza" nga prof. dr. Thoma Simaku.

Ishin të pranishëm Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi, zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave akad. Vasil Tole, drejtues të seksioneve dhe qendrave albanologjike pranë ASHSH, artistë, muzikantë, si dhe studentë të arteve.

Veprimtarinë e çeli drejtori i Qendrës së Studimit të Arteve akad. Stefan Çapaliku.

Akad. Çapaliku falënderoi Kryetarin e ASH, akad. Gjinushin për praninë në këtë veprimtari dhe kujtoi pjesëmarrësit se profesor Simaku vjen nga bota universitare britanike, ku ka kompozuar një listë mbrselenese veprash dhe ka një numër të konsiderueshëm çmimesh dhe ekzekutimesh ndërkombëtare.



Lektios magistralis për Thoma Simakun e moderoi prof. asoc. dr. Edmond Buharaja.

Buharaja bëri më parë prezantimin e kompozitorit. Ai tha se Simaku është profesor i kompozicionit pranë The University of New York. Ai ka lindur në Shqipëri në Kavajë më 18 prill të vitit 1958 dhe studioi në Akademinë e Muzikës dhe Arteve të Shqipërisë në vitet 1978-1982. U diplomua për kompozicion në Konservatorin e Tiranës, në vitet 1978-'82 me prof. Tonin Harapin.

Punoi si shef muzike në Shtëpinë e Kulturës në Përmet në vitet 1982-'85. Më pas, punoi në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve në Tiranë, në Seksionin e Muzikës në vitet 1985-'91.

Në vitin 1991-1996 ndoqi studimet doktorale në York University (Angli) në klasen e David Blake.

Në vitin 2000 ai u bë qytetar anglez dhe jeton në York me familjen e tij.

Përveç punës si profesor i kompozicionit në York University, Thoma Simaku ka një aktivitet mjaft të pasur ndërkombëtar.

Prof. Buharaja e pyeti profesor Simakun se si ndihet pas këtij rrugëtimi artistik; më shumë kavajas, përmetar, tiranas apo jorkez, apo të gjitha nga pak.

Thoma Simaku tha: “Para se të përgjigjem, falënderoj Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe të pranishmit, sepse është kënaqësi që jam këtu. Do të doja të vija më shpesh, por kam pesë vjet që kam munguar, u shpreh Simaku, duke kujtuar se arsyeja ishin dy fatkeqësitë e kaluara tërmeti dhe pandemia COVID -19.

Më është bërë një pyetje sesi ka hyrë muzika shqiptare në muzikën tuaj, -kujtoi

Simaku dhe u shpreh se -“Përgjigjja ime është se muzika shqiptare as ka hyrë, as ka dalë, sepse ajo ka qenë gjithmonë aty brenda meje. Dhe unë nuk kam bërë sforcim, që të organizohem; që në dy ditë javës do të bëjë muzikë nga jugu dhe pastaj në pjesën tjetër do të bëjë muzikë nga veriu. Ajo që është brenda meje, me atë muzikë që jam rritur, ajo del natyrshëm, se po nuk doli natyrshëm, atëherë krijimtaria do të bëhet e zorshme”.

Moderatori Buharaja bëri më tej një paraqitje më të zgjeruar të krijimtarisë së Thoma Simakut, ku kujtoi se veprat e tij janë ekzekutuar në festivalet kryesore në mbarë Europën, në Amerikë dhe Japoni dhe janë pazgjedhur nga juri ndërkombëtare, duke e shpallur atë fitues në të paktën 10 edicione të ISCM World Music Days dhe janë përfshirë në festivale ndërkombëtare.

Në vitin 1993 iu akordua çmimi i madh “Lionel Robbins Memorial Scholarship” – Simaku ishte i vetmi në të gjithë Anglinë që e fitoi këtë çmim atë vit.

Më pas, në Konkursin Ndërkombëtar të Kompozicionit në Varshavë u nderua me çmimin e pare, ku mes 160 veprave të autorëve nga 37 vende të botës u shpall fitues krijimi i kompozitorit shqiptar Thoma Simaku me banim në Angli.

Çmime të tjera ndërkombëtare i janë akorduar nga Dega e Arteve e British Academy, Leonard Bernstein Felloëship në Amerikë, Leverhulme Fellowship në Londër, Akademia e Letrave, Arteve dhe Shkencave në Romë etj.



Polonia, për tre vite me radhë, i ka akorduar çmime ndërkombëtare kompozitorit shqiptar: në vitin 2004 Simaku fitoi çmimin “Serocki”, ndërsa në vitin 2005 çmimin “Lutoslawski” – tre çmime këto që mbajnë emrat e tre kompozitorëve të shquar polakë të shekullit XX.

Ka fituar shumë çmime ndërkombëtare, si Çmim Nderi në Konkursin Ndërkombëtar “Personalitet Muzikore 2006”, i organizuar nga Shoqata Alexander

---

Tansman për Promovimin e Kulturës, nën patronazhin e Ministrisë së Kulturës të Polonisë.

Vepra e tij 'Arc-En-Ciel' Koncert për Violonçel dhe Orkestër është një nga pjesët e zgjedhura nga juria ndërkombëtare prej 401 kompozitorëve nga 51 vende që morën pjesë në konkurs.

Është shpallur 'Kompozitor i Vitit', nga Akademia Britanike e Kompozitorëve në vitin 1995. Në vitin 1995 vepra e tij "Epitaph" për Orkestër Harqesh u zgjodh nga Juria Ndërkombëtare në festivalin Ditët e Muzikës Botërore në Gjermani.

Më pas veprat e tij kanë përfaqësuar Shqipërinë në festivalet e ISCM të viteve 1999, 2000, 2001, 2003, 2004, dhe më 2005 në Zagreb.

Simaku ka kompozuar më shumë se 40 vepra, të cilat janë të botuara në Angli nga University of York Music Press dhe Emerson Edition.

Muzika e tij është transmetuar nga stacione të ndryshme radiofonike si Radio-Franca, BBC-World Service, ABC (Australi), ORF (Austri), dhe stacione të tjera në Evropë, e deri në Japoni dhe Brazil.

Vepra që ka krijuar një surprizë të vërtetë për publikun dhe kritikën, është "Soliloquy".

Kompozitori shqiptar Thoma Simaku demonstroi një njohje mahnitëse të instrumentit të violinës. Është vlerësuar, gjithashtu, për elegancën dhe tingullin e ngrohtë "Tri këngët shqiptare" e Thoma Simakut. Është vlerësuar pjesa "Imazhet e Detit" e bazuar në muzikën e filmit "Duaje emrin tënd", si dhe vepra "Radius për 11 Harqe", por edhe "La Leggiadra Luna" mbështetur mbi një poemë të poeteshës Safo apo versioni i tij i këngës arbëreshe "Moj e bukura More" për piano, violinë dhe violonçel, si dhe "Ulërima" për orkestër harqesh bazuar në pikturën legjendare të Edvard Munch-it, e cila e pati premierën më 2017-n, performuar nga Orkestra Koncertore e BBC-së, etj.

Pas prezantimit të krijimtarisë dhe veprimtarive artistike, Buharaja bëri paraqitjen e dy CD-ve dhe e pyeti kompozitorin Simaku për veprën Soutary Poems, sesi është përfshirë në këtë vepër fryma popullore. Simaku tha se janë më shumë kompozime me frymën popullore sesa citime direkte të motiveve.

"A vihet re një programin në veprat e tua" -pyeti Buharaja, -si tek veprat me tema letrare "Ura me tri harqe", apo "Pesha e Kryqit" të Kadaresë?

Kompozitori Simaku tha se "Nuk janë muzikë me program. Nuk mundohem të bëjë përkthim në muzikës së një vepre letrare. Marr vetëm pikënisjen. Logjika është se ku do të shkojë muzika. Është momenti që në bazë të kësaj logjike kompozitori ta bëjë idenë muzikore që të gjejë rrugën e vet, jo me plan.

Për përcaktimin në rryma të modernitetit, Simaku tha se vërtetë Bartok, Stravinsky, Berio, Boulez, Birtwhistle, Xenakis, Lutoslawski e me radhë, patën ndikimin e tyre gjatë viteve të studimit, por me muzikën e Ligetit dhe Kurtagut, ndjeva se zbulova

diçka shumë të veçantë, që ishte më shumë sesa frymëzim për mua. Ai tha se aty zbuloi vlerën që ka filozofia e krijimit.

“Një tingull ka një fuqi magnetike, që i mban të gjitha notat e tjera. Një notë e vetme, edhe kur nuk është shpreh rëndësinë e saj me mungesën e saj”.-tha Simaku. Ai ndaloi tek veprat e tij për të argumentuar filozofinë e krijimit që merr zë me eksplorimin e instrumentit, si ide e pikënisjes së një vepre.

Ndërsa bëri prezantimin e CD “Soliloquy IV”, kompozitori Simaku foli për motivet e krijimit. Universi nuk prodhon tinguj, prodhon zhurma. Tingujt janë elementë kulturorë- tha ai, duke ju referuar kompozimit të tij me fagotë, kombinuar me vibrimin në kapakun e hapur të pianofortes që qëndron e heshtur.

Për veprën “Solitary poem#14”, Simaku foli për motivin e përqendrimit tek një tingull, një notë. Ai e konsideron veprën si shpalsje melodike , me një saksofon që “ligjëron” bukur. Është një lloj isoje, -tha kompozitori.



Buharaja e pyeti për elementët e strukturimit të muzikës. Simaku u shpreh se është si të imagjinosh një ndërtesë tingullore që i duhen edhe shtyllat për të mbajtur këtë ngarkesë.

Më tej Simaku foli për korifenjtë e muzikës së shekullit të 20-të, si Ligeti, Kurtagu, Xenakis, Lutoslavski e me radhë, që patën ndikimin e tyre gjatë viteve të studimit, “por me muzikën e Ligetit dhe Kurtagut, ndjeva se zbulova diçka shumë të veçantë, që ishte më shumë sesa frymëzim për mua”, tha Simaku.



---

Buharaja e pyeti kompozitorin sesi e koncepton ai marrëdhënien me publikun.

Simaku tha se interesohem që muzika ime t'i flasë kujtdo dhe kujtoi se vetë kritika e ka vlerësuar krahas profesionalizmit krijues shijimin e kësaj muzike nga dëgjuesi i thjeshtë. "Kompozitori duhet ta ketë parasysh për kë po e shkruan muzikën".-tha Simaku.

Buharaja kujtoi se vepra për flaut e piano "Duaje emrin tënd", që u krijua nga Simaku fillimisht për filmin me të njëjtin titull, e punuar nga Marsida Koni para disa muajsh u dha nga Radio Franca.

Më tej, akad. Vasil Tole e falënderoi profesor Thoma Simakun për ligjërimin dhe i bëri ftesën për të qenë më afër institucioneve dhe kolegëve shqiptarë, duke e konsideruar shumë të nevojshëm bashkëpunimin me të.

Ai e pyeti për veprën "Ulërima" frymëzuar nga piktura e njohur e Edvard Munch; nëse në këtë rast e ka me program veprën muzikore që u performua nga Orkestra Koncertore e BBC-së, më 2017-n.

Simaku tha se në krijimin e kësaj vepre ka ndjerë përgjegjësinë për kontaktin me dëgjuesin, dhe gjatë krijimtarisë u shpreh se është mjaftuar që pikënisja të jetë e qartë pa harruar se kemi të bëjmë më veprën muzikore, dhe përtej programit ai ka ndjekur logjikën e tingullit.

Pas diskutimeve, akad. Stefan Çapaliku, drejtori i Qendrës së Studimit të Arteve pranë ASHSH, e falënderoi kompozitorin Thoma Simaku për bisedën fantastike, jo vetëm në planin artistik por edhe për argumentet teknike.


Ndiqni veprimtarinë në linkun:

<https://www.facebook.com/share/v/YqBogpoBfX1J4sdT/?mibextid=oFDknk>



## “Nderi i Akademisë” për Theofan Popën

-Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi i jep certifikatën e mirënjohjes “Nderi i Akademisë”




Diploma e mirënjohjes Nderi i Akademisë iu akordua me vendim të jurisë studiuesit Theofan Popa (pas vdekjes), me motivacionin:

Për meritat e tij të jashtëzakonshme, të vlerësuara brenda dhe jashtë vendit, në shkallë rajonale, si mbledhës, përshkrues dhe katalogues i dorëshkrimeve kishtare të ruajtura në Shqipëri gjatë shekujve VI-XVII; si studiues epigraf, kopjues, transkriptues dhe përkthyes i mbishkrimeve kishtare e laike-historike mesjetare; si koleksionues e shpëtues i fondit ikonografik të vendit, që u mbijetoi rreziqeve për zhdukje në kohëra të vështira; personalitet me kontribute të papërsëritshme në të gjitha fushat ku u përfshi, me një vullnet e dedikim të pakufishëm, që e ktheu mbrojtjen dhe studimin e trashëgimisë kulturore shqiptare të kërcënuar për shkak të ateizmit në qëllimin e jetës së tij.

Nderimi u bë në kuadër të përrurimit të librit “Theofan Popa, martir i shkencës”, përmbledhje studimesh e autorëve Pirro Thomo, Aleksandër Mexi, Kostandinos Giakoumis, Sokol Çunga, Andi Rëmbeci, Era Xhaferaj; përgatitur për botim nga Pirro Thomo dhe Anisa Ymeri.

## Nderohet në Akademi Theofan Popa, shpëtuesi, kataloguesi, mbrojtësi dhe studiuesi i trashëgimisë kishtare të Shqipërisë

- Ceremoni për "Nderin e Akademisë", përrurim i librit-kushtim "Theofan Popa - martir i shkencës"
- Të pranishëm akademikë, studiues të trashëgimisë kishtare, klerikë, restauratorë, miq e bashkëpunëtorë të Theofan Popës
- Kumtuan, ndër të tjerë, prof. Aleksandër Mexsi, prof. Pirro Thomo, prof. Neritan Ceka, prof. Neritan Ceka, prof. Kostandinos Giakoumis, dr. Andi Rëmbeci, dr. Anisa Ymeri
- Në emër të familjes së Theofan Popës përshëndeti z. Dhimitër Popa
- Një fjalë të shkurtër falënderimi mbajti gjithashtu Hirësi Asti



Sot, më 3 maj 2024, në sallën "Aleks Buda" në Akademinë Shkencave të Shqipërisë u zhvillua ceremonia e dhënies së certifikatës dhe diplomës "Nderi i Akademisë" studiuesit të mirënjohur të dorëshkrimeve, mbishkrimeve, ikonografisë dhe trashëgimisë kishtare në përgjithësi Theofan Popa.

Zhvillimi i kësaj ceremonie u drejtua nga prof. Neritan Ceka, kryetar i komisionit të përhershëm të historisë dhe arkeologjisë, i cili ftoi Kryetarin e Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushin për të dorëzuar certifikatën dhe diplomën "Nderi i Akademisë".

Akad. Gjinushi tha se i jepet diploma e mirënjohjes "Nderi i Akademisë" studiuesit

Theofan Popa (pas vdekjes) me motivacionin:

"Për meritat e tij të jashtëzakonshme, të vlerësuara brenda dhe jashtë vendit, në shkallë rajonale, si mbledhës, përshkrues dhe katalogues i dorëshkrimeve kishtare të ruajtura në Shqipëri gjatë shekujve VI-XVII; si studiues epigraf, kopjues, transkriptues dhe përkthyes i mbishkrimeve kishtare e laike-historike mesjetare; si koleksionues e shpëtues i fondit ikonografik të vendit, që u mbijetoi rreziqeve për zhdukje në kohëra të vështira; personalitet me kontribute të papërsëritshme në të gjitha fushat ku u përfshi, me një vullnet e dedikim të pakufishëm, që e ktheu mbrojtjen dhe studimin e trashëgimisë kulturore shqiptare të kërcënuar për shkak të ateizmit në qëllimin e jetës së tij".

Z. Dhimitër Popa, i cili përshëndeti në emër të trashëgimtarëve, shprehu falënderime të përzemërta për mirënjohjen e lartë që iu akordua babait të tij Theofan Popa për punën dhe kontributin, jo vetëm në ikonografinë shqiptare, por edhe më gjerë, në rrafshin e trashëgimisë kulturore.



"Ne fëmijët e Theofanit jemi të befasuar, në një farë mënyre, dhe kjo vëmendje e ky nderim i sotëm ndoshta ngjan si surreale; por do t'ju pohojmë se në familjen tonë, i vetmi që e dinte, i vetmi që nuk kishte pikën e dyshimit se kjo ditë e njohjes së kontributit të tij në shkencën e ikonografisë shqiptare do të vinte, është pikërisht munguesi kryesor sot në këtë sallë, Theofan Popa. "Puna ime do të njihet në të ardhmen na thoshte", por ne qeshnim. Ne fëmijët e Theofanit e dinim se siç kishim lindur ashtu dhe do të vdisnim në atë sistem që nuk lejonte kisha dhe as besimin në Zot, dhe nuk mund të shihnim atë që shihte babai. Sot pyesim veten e ndonjëherë edhe njëri-tjetrin e pyesim se ç'dinte babai ynë, ç'shikonte ai përtej që ne nuk arrinim ta shihnim. Këtë ne ende nuk e dimë, por dimë që babai shikonte me sytë e besimit".

Në fund të fjalës së tij, ai kujtoi punën dhe kontributet që dha Theofan Popa si

profesor, redaktor e studiues:

“Babanë e mbajmë mend si një shqiptar të mirë, si një elbasanlli të devotshëm nga lagja “Kala”, që e deshi atdheun pa e ngatërruar asnjëherë me regjimin 50-vjeçar. A e deshi Theofani Shqipërinë, po aq sa Perëndinë?, - mund të pyesë dikush. Ne fëmijët e tij përgjigjemi: "Patjetër që po".

Më pas, me rastin e këtij nderimi, u bë përrurimi i librit “Theofan Popa, martir i shkencës”, përmbledhje studimesh e autorëve Pirro Thomo, Aleksandër Meksi, Kostandinos Giakoumis, Sokol Çunga, Andi Rëmbeci, Era Xhaferaj; përgatitur për botim nga Pirro Thomo dhe Anisa Ymeri; përgatitur për botim nga Pirro Thomo e Anisa Ymeri.

Dr. Anisa Ymeri, pasi falënderoi të gjithë bashkëpunëtorët e këtij libri, shprehu vlerësimin dhe mirënjohjen për veprën e Theofan Popës, jeta e të cilit qëndron midis besimit dhe shkencës.



Prof. Pirro Thomo shprehu mirënjohjen për Akademinë e Shkencave, që i akordoi Theofan Popës vlerësimin e lartë "Nderi i Akademisë" dhe në vijim vuri në dukje meritat e tij si njohës i gjuhëve të huaja (greqishtes bizantine dhe sllavishtes) dhe mbi të gjitha si një studiues cilësor i paleografisë; një objekti studimi me pasoja të rrezikshme për ideologjinë e periudhës së para viteve 1990.

Theofan Popa ishte themelues e vijues i traditës së studimeve në fushën e epigrafisë, tha prof. Thomo.

Ai kujtoi se në një periudhë shumë të vështirë, si specialist i Institutit të Monumenteve, Theofan Popa u caktua për të mbledhur mbishkrimet e kishave të Shqipërisë, por bëri shumë më tepër se aq. Shkoi në çdo skaj të Shqipërisë dhe regjistroi e koleksionoi të gjitha objektet me vlerë dhe mbishkrimet kishtarë.

Prof. Thomo, përmes ilustrimeve me fotografi të rralla, mes të cilave ishte edhe një

foto me Migjenin, rrëfeu kontributet e Theofan Popës dhe vuri në dukje se vepra e tij është vlerësuar nga studiues shqiptarë, profesorë të universitetit të Vjenës dhe specialistë të njohur në Europë.

Në fjalën e tij prof. Aleksandër Mexsi rrëfeu kujtimet në lidhjet zyrtare dhe ato miqësore gjatë viteve të bashkëpunimit si koleg me Theofan Popën për studimin, skedimin, koleksionimin, klasifikimin dhe ruajtjen e monumenteve kishtare. "Theofani kishte një punë të vështirë në të gjitha aspektet dhe ka punuar pa rezerva dhe me përkushtim, - tha prof. Mexsi. Ai sugjeroi që dy veprat e Theofan Popës për mbishkrimet dhe pikturën kishtare, të botuara para dy dekadash e më shumë nga Akademia e Shkencave, të ribotohen prej saj me një redaktim shkencor më cilësor dhe të përkthyer në anglisht.

Prof. Konstantinos Giakoumis përgëzoi Akademinë e Shkencave për vlerësimin e nderimin e figurës së Theofan Popës. Pasi foli për kontributin e madh që ka Theofan Popa në epigrafikën bizantine dhe pasbizantine në Shqipëri. Prof. Giakoumis tha se kontributi i Theofan Popës në studimin e historisë së artit kishtar, bizantin dhe pasbizantin ishte po aq i çmuar, sa dhe kontributi i tij në epigrafikën e kishave dhe ikonave të Shqipërisë. Theofan Popa ishte i pari në Shqipëri që, së bashku me Viktori Puzanovën dhe më vonë Dhorka Dhamon, e vendosën ikonografinë e artit kishtar në Shqipëri në kuadër të studimeve ndërkombëtare të fushës, edhe pse studimi i tyre që shumë më i koklavitur për ideologjinë komuniste sesa në fushat e tjera të arkeologjisë, arkitekturës dhe të arteve.



Dr. Andi Rembeci tha se Theofan Popa ia kushtoi jetën studimit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Ai e vlerësoi mes të tjerash Theofan Popën si protagonist të shpëtimit të shumë monumenteve kulturore në Shqipëri, por edhe si një studiues nismëtar të artit të krishterë në vend, me një vepër voluminoze, ku ai punoi pa u lodhur për gjurmimin, studimin dhe mbrojtjen e pasurive kulturore.





Më tej Rëmbeci foli për punën kolosale të Theofanit si mbledhës i 10 mijë ikonave. Ai tha se puna e Popës konsistonte në hartimin e skedave përmbledhëse për dokumentet e shkruara në greqisht, në mënyrë që këto t'i përdornin, më pas, arkivistët gjatë procesit të përpunimit tekniko - shkencor të dokumenteve dhe për hartimin e mjeteve të informimit. Pa njohjet gjuhësore të Popës dhe ekspertizën e tij teologjike dhe historike, do të kishte qenë i pamundur përpunimi tekniko- shkencor i një pjese të madhe të dokumenteve të AQSH shkruar në greqisht, - tha Rëmbeci, - dhe theksoi se artikujt e Theofan Popës kanë hedhur dritë për piktorët dhe familjet e piktorëve që kishin kryer veprimtaritë e tyre artistike në monumentet e vendit tonë, duke shkruar artikuj për Onufrin dhe Nikollën, Joanin dhe Onufër Qipriotin, David Selenicën dhe vëllezërit korçarë Kostandin dhe Athanas Zografn, Kostandinin nga Shpati dhe Çetirët nga Grabova, si dhe për shumë piktorë të tjerë.



## Zhvillohet workshop-i ndërkombëtar “Përgjigjet ndaj streseve biotike dhe abiotike, kujtesa& diversiteti epigjenetik i drithrave

U zhvillua sot më 2 maj 2024 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dita e parë e workshop-it ndërkombëtar Biotic and Abiotic stress responses, Memory & Epigenomic Diversity in Crops. (“Përgjigjet ndaj streseve biotike dhe abiotike, kujtesa& diversiteti epigjenetik i drithrave”.)



Në këtë veprimtari morën pjesë kërkuesit shkencorë që punojnë mbi metilimin e ADN-së, strukturën e kromatinës, modifikimet e histoneve, në speciet e drithërave apo modele të tjera, si edhe kërkuesit vendorë, lektorët dhe studentët e interesuar në mekanizmat epigjenetikë dhe ato eko-fiziologjikë të adaptimit të bimëve.

Veprimtaria zhvillohet me dy tryeza diskutimesh mbi konceptet bashkëkohore dhe perspektivën e përdorimit të epigjenetikës në rezistencën e drithërave dhe sigurinë ushqimore, të planifikuara në 2 maj në Tiranë dhe në 3 maj në Vlorë.

Dita e dytë e workshop-it (sipas programit më poshtë) do të zhvillohet të martën, më 3 maj 2024, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe do të vijojë pranë Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore në Vlorë.

Kjo veprimtari u organizua në bashkëpunim me COST Action CA22157-EPICATCH, Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Universitetin Bujqësor të Tiranës, Universitetin e Tiranës, dhe Qendrën për Transferimin e Teknologjive Bujqësore, Vlorë.

EPICATCH, projekt i kategorisë COST-EU, synon të përcaktojë, zhvillojë, krijojë dhe shpërndajë dije dhe metodologji të avancuara mbi studimin e mekanizmave epigjenetike që rregullojnë përshtatjen e bimëve ndaj streseve mjedisore të nxitura nga ndryshimet klimatike.



Workshopi mbahet mbi dy drejtime kryesore:

1. Kujtesa epigjenetike e drithrave ndaj streseve & diversiteti epigjenomik
2. Mekanizmat epigjenetike që rregullojnë adaptimin e drithrave

Workshop-i u organizua nga prof. dr. Ariola Bacu, koordinatore (Universiteti i Tiranës); Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike pranë ASHSH, Komisioni për biologji, bujqësi dhe veterinari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; akad. Fatbardh Sallaku, Rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës; Mëno Besimaj, drejtor i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Vlorë, Shqipëri.

Komiteti organizues i EPICATCH:

Federico Martinelli, Universiteti i Firences, Itali

Ariola Bacu, Universiteti i Tiranës & Akademia e Shkencave e Shqipërisë;

Sotirios Fragkostefanakis, Universiteti "Gëte", Frankfurt, Gjermani;

Gloria Catarina Pinto, CESAM, Universiteti i Aveiro-s, Portugali;

Valya Vassileva, IPPG, Akademia Bullgare e Shkencave, Bullgari;

Maury Stephane, Universiteti i Orleans, Francë.

---

**Akad. Arben Merkoçi, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, drejtues i njësisë së kërkim-studimit në nanoteknologji, njohur me emrin "NanoAlb", zgjidhet anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave**



Më parë akad. Merkoçi u zgjodh si ekspert vlerësues i projekteve shkencore europiane në "European Research Area" - ERA.

Është një privilegj i vërtetë të bëhesh pjesë e komunitetit të nderuar të Akademisë Europiane të Shkencave EurASc së bashku me anëtarë të tjerë të shquar të komunitetit shkencor ndërkombëtar, shprehet akad. Merkoçi.

Mirënjohje për kolegët e mi në EurASc që më rekomanduan, si dhe për të gjithë ata që mbështetën nominimin tim.

Falënderoj nga zemra familjen time për mbështetjen e palëkundur, për kontributin e paçmuar të grupit tim kërkimor dhe për institucionet e nderuara që kanë qenë të rëndësishme në mbështetjen e përpjekjeve të mia kërkimore ndër vite.

Falënderime të veçanta për mentorët e mi dhe shkencëtarët shembullorë që më

---

kanë udhëhequr gjatë gjithë karrierës sime: prof. Carlo Maccà në Università degli Studi di Padova; prof. Salvador Alegret në Universitat Autònoma de Barcelona; prof. Joe Wang në [#UCSanDiego](#)

Falë këtyre institucioneve të shkëlqyera, në të cilat jam i përkushtuar në rolin tim si kryetar i grupit të punës ERA për ALLEA - Federata Europiane e Akademive të Shkencave dhe Shkencave Humane dhe si anëtar bordi i Shoqatës Katalanase të Kimisë (SCQ) në Institut d'Estudis Catalans, duke kontribuar në mënyrë aktive në avancimin e shkencës dhe nxitjen e rritjes së saj.

Faleminderit!

Arben Merkoçi

"NanoAlb" - Albania

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

ICREA - Institució Catalana de Recerca dhe Estudis Avançats

Institut Català de Nanociència i Nanotecnologjisë (ICN2)

Instituti i Shkencës dhe Teknologjisë në Barcelonë (BIST)

ICERCA - Qendrat de Recerca de Catalunya

## Dorëshkrimet ungjillore të ruajtura në hapësirën historike shqiptare: shija dhe luksi metropolitan në kodikët e Shqipërisë

- Ligjëratë e hapur e akad. Shaban Sinani me studentë shqiptarë, grekë, bullgarë e maqedonas në Universitetin "Fan S. Noli" të Korçës, në kuadër të "Akademisë së dytë verore ndëruniversitare



Universiteti i Korçës "Fan S. Noli", në bashkëpunim me Universitetin "St. Cirili e Metodi" të Velika Trnovo-s, me Universitetin "Aristotle" të Selanikut, me Institutin "Goethe" në Tiranë, po organizojnë ditët akademike ndërbalkanike me temë "Ballkanet: në rrënjët e studimeve gjuhësore, letrare, historike dhe etnografike" / "The Balkans in the roots of linguistic, literary, historical and ethnographic studies".





Veprimtaria ka nisur më datën 7 maj dhe përfundon më 17 maj 2024.

I ftuar për të mbajtur një ligjëratë të hapur rreth modulit "Trashëgimia kulturore, etnohistoria, gjuha dhe identiteti në Ballkan" / "Cultural heritage, ethnohistory, language and identity in the Balkans", akad. Shaban Sinani referoi sot për temën "Dorëshkrimet kishtare: karakteri universal dhe disa elementë të përveçimit etnik, në kontekst të ndërkulturorësisë".

Në pjesën e parë të kësaj ligjërate çështje kryesore ishin:

- Ndryshe nga disa pikëvështrime difidente, kryesisht të studiuesve romantikë e neoromantikë të Perëndimit, që e kanë cilësuar rajonin tonë, me kënaqësinë e zbuluesit, herë "Balkan-Babel" e herë "Balkan-war", në brendësinë e vet gadishulli i qytetërimeve të lashta dhe i udhëtimeve apostolike është ndryshe.

- Afërsitë gjuhësore janë aq të mëdha, të ballkanizuara, sa formojnë sistem dhe mbi këtë bazë ka lindur ballkanologjia si disiplinë shkencore.

- Bashkëpërkimet në shtresat më të hershme të folklorit ("les concordances") përjashtojnë rastësinë dhe gjithnjë e më shumë trajtohen si ligjësi të zhvillimit të përbashkët (motivi i flijimit, ringjalljes, rinjohjes, shkeljes së tabusë: në "Digenis Akritas", në "Srpske junačke pjesme" dhe në trashëgimi të tjera.



- Heterogjeniteti në besim, në alfabetë, në orientimin kulturor, asnjëherë nuk ka determinuar jetën e përbashkët ndërbalkanike. Arketipi ballkanas në letërsi është arketipi më përbashkues. Plaka Nicë e Kadarese, Zorba i Kazantzakis, Baj Gano i bullgarëve, janë sa të popujve të origjinës aq dhe të "tjetrit". Realizmi social i viteve 1930 në Ballkan krijoi yllësi: Migjeni, Seferis, Kosta Racin, Krleža, Srečko Kosovel, Zogović,



---

janë sivëllezër të së njëjtës dukuri. Empati, simpati apo urrejtje? Gjykuar nga historia dhe vlerat shpirtërore, Ballkani është "pluribus in unum".

Në pjesën e dytë të ligjëratës autori theksoi rëndësinë botërore të dy kodikëve të purpurt të Beratit (gjegjësisht mesi i shek. VI dhe shek. IX) si shkollë e ndërmjetme shkrimesh, si arketipe të kaligrafisë dhe kodifikimit të Shkrimit të Shenjtë, si pika reference për krahasim e kronologjizim të dorëshkrimeve të krishtera ("jo më parë se", "jo më vonë se"), si shprehje elitare e ndërthurjes së kultit dhe kulturës.

Me "Codex Purpureus Beratinus" lidhen 15 shekuj histori krishterimi, prej periudhës apostolike deri në kohët moderne; një histori shumë e gjatë devocioni e qytetërimi; histori përballjeje me rreziqet dhe grabitjen përgjatë njëmijë vjetëve; një histori e ndërlidhjes së universalitetit të besimit me përveçimin etnik-lokal për ruajtjen dhe mbijetesën; një histori e shijes dhe luksit metropolitan në "periferitë" e perandorive; një histori komunikimi me kryeqendrat e mëdha europiane të Shkrimeve dhe dorëshkrimeve.

## Ali Aliu riboton me ripunim librin "Don Kishoti shqiptar"

Instituti i Librit dhe Promocionit, shtëpia botuese "Toena" dhe Akademia e Shkencave përurojnë veprën "Don Kishoti shqiptar" të akademikut Ali Aliu, vepra më e përkthyer dhe më e ribotuar e tij, që mban nëntitullin "Një histori letërsie ndryshe".

Veprimtaria u organizua në 90-vjetorin e lindjes së autorit dhe vijon dy veprimtari akademike të mëparshme në këtë kuadër.



Përrurimi u hap nga znj. Irena Toçi, drejtore e Institutit të Librit dhe Promocionit.

Kryetari i Akademisë së Shkencave prof. Skënder Gjinushi përshëndeti veprimtarinë dhe uroi akad. Ali Aliun për ditën e lindjes dhe për veprën e tij me shtrirje në mbi 60 vjet.



---

Për veprën e sapo ribotuar (me ripunim nga autori), si dhe për personalitetin e tij,  
folën Shaban Sinani, Zija Çela, Majlinda Rama dhe Arian Leka.

Qendra e Librit dhe Komunikimit i dorëzoi akad. Ali Aliut diplomën e vlerësimit.

## Egon Gjadri e Enver Preza, "Nderi i Akademisë"

- Akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, u dorëzoi trashëgimtarëve të projektuesve të mëdhenj Egon Gjadri e Enver Preza mirënjohjen "Nderi i Akademisë"



Në kuadër të 60-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në Komitetin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (ICOLD) u zhvillua dita e parë e simpoziumit teknik ndërkombëtar "Sfida dhe inovacione për diga të sigurta" me praninë e presidentit të ICOLD prof. Michel Lino, presidentes së EUROCOLD Sara Lazaridou dhe zëvendëskryeminstres znj. Belinda Balluku.

U mbajt sot më 16 maj 2024 në kuadër të 60-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në Komitetin Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (ICOLD) simpoziumi teknik ndërkombëtar "Challenges and innovations for better dams" ("Sfida dhe inovacione për diga të sigurta").

Simpoziumi u zhvillua në Hotel Tirana, i organizuar nga Komisioni Ndërkombëtar për Digat e Mëdha (ICOLD), Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha të Shqipërisë (KKDM) dhe Komiteti Francez i Digave dhe Rezervuarëve (CFBR), me pjesëmarrjen e akademikëve dhe të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë,

drejtuesve të lartë të ICOLD dhe përfaqësuesve të saj, përfaqësuesve të CFBR dhe KKDM, si dhe inxhinierëve të rinj dhe përfaqësuesve të shfrytëzuesve të digave në Shqipëri.

Gjithashtu, në simpozium morën pjesë përfaqësues të KKDM, CFBR, përfaqësues të Ambasadës Franceze në Tiranë, MIE, MBZHR, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti "Polis" dhe Universiteti Metropolitan, agjencitë e huaja që mbështetin projekte të ndryshme në Shqipëri, përdoruesit e digave më të mëdha, si dhe inxhinierë në fushën e projektimit dhe zbatimit të digave të mëdha e të vogla në Shqipëri.

Simpoziumin e përshëndeti Kryetari i Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha z. Arjan Jovani. Ai bëri një prezantim të pasurisë së digave të mëdha në Shqipëri dhe theksoi se Shqipëria është vendi që ka numrin më të madh të digave në raport me numrin e banorëve apo në raport me sipërfaqen në metra katrorë të vendit.

Më tej, z. Jovani foli për problematikat, duke e vënë theksin tek mungesa e standardeve teknike të nevojshme për projektimin dhe monitorimin e digave, si dhe për inovacionet e fundit për monitorimin e digave të mëdha dhe rezervuarëve të krijuar prej tyre.



Në seancën e parë të këtij simpoziumi përshëndetën edhe Presidenti i Komisionit Ndërkombëtar për Digat e Mëdha prof. Michele Lino, presidenti i CFBR z. Denis Aelbrecht, zëvendëkryeministrja Belinda Balluku, këshilltari i parë i Ambasadës së



Francës në Shqipëri Samuel Richard, si dhe presidentja e EUROCOLD Sera Lazaridou.

Ata folën rreth përvojave në lidhje me projektimin dhe monitorimin e digave në Shqipëri dhe në Francë dhe për sfidat dhe të rejtat në kuadrin ligjor dhe organizativ për një reformë në sektorin e digave.

Në mbyllje të seancës së parë, Kryetari i Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha z. Arjan Jovani ia dha fjalën akad. Skënder Gjinushit, Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Akad. Gjinushi pas fjalës përshëndetëse u dorëzoi trashëgimtarëve të projektuesve të mëdhenj Egon Gjadri e Enver Preza mirënjohjen "Nderi i Akademisë" me motivacionet:

Egon Gjadri

Bashkëhartues i skemës së shfrytëzimit të energjisë ujore në rrjedhën e lumit Drin; me kontribut original tekniko-shkencor për projektimin e tuneleve të veprave të mëdha hidroteknike dhe të konstruksioneve të tjera hekurudhore e rrugore; si dhe për organizimin dhe drejtimin profesional të ekipeve të suksesshme për projektimin e digave më të mëdha të vendit tonë, si drejtues i suksesshëm në zbatimin krijues të shkencës në projektim.





Enver Preza

Për merita të shquara tekniko-shkencore në fushën e projektimit të çimentimeve të thella poshtë digave të mëdha, elemente kryesore ndër më të rëndësishmit në veprat e mëdha hidroteknike të ndërtuara në kaskadën e lumit Drin; që zgjidhi probleme nga më të ndërlikuarat në projektimin e perdeve të çimentimit dhe të tuneleve; të bllokimit të lëvizjes së ujërave nëntokësore; personalitet që dhe pas shumë dekadash është vështirë të kapërcehet.



\*\*\*

Simpoziumi do të vijojë edhe në datën 17 maj, ku do të shkëmbehen përvojat në lidhje me kontrollin dhe monitorimin shtetëror të digave të mëdha në Shqipëri dhe në 15 vende europiane, ku përfaqësues të Italisë, Francës, Zvicrës, Greqisë, Rumanisë, Norvegjisë, Finlandës, Austrisë, UK, Suedisë, Portugalisë etj, do të diskutojnë për sfidat dhe të rejat në kuadrin ligjor dhe institucional për kontrollin e digave, si dhe në mënyrë të veçantë për monitorimin e digave pas instalimit të impianteve FV në diga dhe rezervuare, si dhe kontrolli i digave të vogla.

## Takimi rajonal për krijimin e një konsorciumi ballkanik për bimët aromatike dhe mjekësore (MAPs)

Ministrja e Bujqësisë znj. Anila Denaj premtoi mbështetjen e projektit për krijimin e një konsorciumi ballkanik të bimëve aromatike dhe mjekësore (MAPs) në Europën Juglindore, që do të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori në vendin tonë, duke nxitur krijimin e mundësive të punësimit dhe të ardhurave për banorët e zonave rurale.



Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë sot më 17 maj 2024 në sallën "Libri akademik" u zhvillua konferenca ndërkombëtare me temë "Regional meeting to establish a Medicinal Aromatic Plants (MAPs) Balkan Consortium in South East Europe".

Ky takim i rëndësishëm u organizua nga Akademia e Shkencave, Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Insituti Kombëtar i Kërkimeve Bujqësore në Zvicër ("Agroscope").

Ne cermoninë e hapjes ishin të pranishëm Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural znj. Anila Denaj, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi, Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës akad. asoc. Fatbardh Sallaku dhe akademikë, profesorë e studiues të kësaj fushe nga Shqipëria dhe me shumë se 15 vende të Europës dhe rajonit, si Zvicra, Italia, Slovakia, Greqia, Turqia, Slovenia, Kroacia, Serbia, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut etj.

Veprimtaria u çel nga kryesuesi i grupit organizues të saj prof. dr. Sokrat Sinaj, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Prof. dr. Sinaj përshëndeti të pranishmit dhe paraqiti objektivin kryesor të këtij takimi: krijimin e një konsorciumi rajonal për bimët aromatike dhe mjekësore (MAPs) në bashkëpunim me vendet e Ballkanit, institucione të tjera nga Europa, të përkushtuara në

adresimin e sfidave dhe nxitjen e zhvillimit e këtij sektori, kryesisht nga zonat malore.

Rektori i Universitetit Bujqësor akad. asoc. Fatbardh Sallaku në fjalën e tij përshëndetëse shprehu gadishmërinë për mbështetjen e krijimit të konsorciumit, i cili i dedikohet një sektori të rëndësishëm të bujqësisë shqiptare si ai i bimëve aromatike dhe mjekësore.



Ministrja e Bujqësisë znj. Anila Denaj në fjalën e saj, vlerësoi rëndësinë e këtij aktiviteti për ekonominë bujqësore të vendit tonë dhe falënderoi organizatorët e këtij event të rëndësishëm shkencor. Ajo premtoi mbështetjen e kësaj iniciative, që do të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm në sektorin e bimëve mjekësore dhe aromatike dhe mbështjen për prodhimin sipas standardeve bashkëkohore.

Dr. Christoph Carlen ("Agroscope", Zvicër) në fjalën e tij theksoi se rajoni dhe veçanërisht Shqipëria ka një potencial të madh për prodhimin dhe eksportin e bimëve aromatike dhe mjekësore.

Dr. Carlen shprehu mbështetjen e "Agroscope" për konsorciumin dhe bashkëpunimin në projekte të përbashkëta me vendet e rajoni në këtë fushë.

Konferenca ishte e organizuar në katër sesione.

Në sesionin e parë paraqitën punimet e tyre prof. dr. Alban Ibraliu (Shqipëri), dr. Xavier Simonnet (Zvicër), prof. dr. Zlatko Šatović (Kroaci), prof. dr. Dea Baricevic (Slovenia) dhe prof. dr. Avni Hajdari (Kosovë).

Sesioni i dytë vazhdoi me prezantimet e dr. Paschalina Chatzopoulou (Greqi), prof. dr. Katya Uzundzhaliëva (Bullgari), prof. dr. Gjoshe Stefkov (Maqedonia e Veriut) dhe prof. dr. Zoran Jovovic (Mali i Zi).

Në sesionin e tretë prezantuan punimet e tyre prof. dr. Nazim Şekeroğlu (Turqi), dr. Andrea Primavera (Itali), prof. dr. Ivan Šalamon (Slovaki) dhe prof. dr. Zora Dajic (Serbi).

Sesioni e fundit iu dedikua formaliteteve për krijimin e konsorciumit, një artikulli

---

shkencor rajonal për problemin e MAPs dhe përgatitjes së një projekti shkencor për MAPs në nivel rajonal.





**"Baladë dritash për Zef Zorbën", libri i sapobotuar i Viola Isufajt, botim i Akademisë së Shkencave, përrurohet në bibliotekën "Marin Barleti" të Shkodrës**



- Me praninë e pedagogëve të Universitetit të Shkodrës dhe të studiuesve të tjerë

Më datën 17 maj 2024, në bibliotekën publike "Marin Barleti" të qytetit të Shkodrës, u zhvillua veprimtaria përruruese e veprës me titull "Baladë dritash për Zorbën", punim monografik i sapodalë nga shtypi, me autore prof. asoc. dr. Viola Isufaj, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Të pranishëm në këtë veprimtari ishin të afërm, miq të autorit Zef Zorba (1920-1993), pedagogë e studiues të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Autorja e punimit monografik Viola Isufaj bëri një paraqitje të shtjelluar të punës së saj me lëndën autoriale të përbërë nga krijime të Zef Zorbës, një pjesë e të cilave dhe të konsultuara në variant dorëshkrimi, si dhe me dëshmi dokumentare të sistemuara në kapituj të veçantë të veprës së saj.

Një paraqitje kritike dhe analitike të këtij punimi u krye nga prof. asoc. dr. Evalda Paci, përgjegjëse e departamentit të studimeve letrare të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me një vëmendje të përqendruar në profilin e Zef Zorbës si autor, studiues i letërsisë dhe i arteve të bukura, përkthyes dhe hartues libretesh për vepra të vëna në skenë.

Aktorja Merita Smaja interpretoi pjesë të zgjedhura poetike nga krijimtaria e Zef Zorbës, lexime që u shoqëruan nga një sfond muzikor i përzgjedhur dhe i luajtur mjeshtërisht nga artisti



---

Gjon Shllaku.

Veprimtaria u ndoq me interes nga të pranishmit dhe u përshëndet në përmbyllje me një fjalë domethënëse dhe nga prof. asic. dr. Arben Prendi, përgjegjës i departamentit të letërsisë pranë Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi".



## Akademia e Shkencave e Shqipërisë - veprimtari përruruese për "Fjalorin e pemëtarisë", në nderim të autorit, prof. dr. Agim Zajmi, në njëvjetorin e ndarjes së tij nga jeta.

- Agim Zajmi, ish-profesor i Fakultetit të Bujqësisë në Universitetin e Prishtinës, ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm jo vetëm për shqiptarët e Kosovës, por për gjithë kombin shqiptar

- Akad. Valter Memishaj: "Fjalori i pemëtarisë" shënon një shkallë të re në terminografinë shqiptare, mbështetur dhe në traditën më të vyer europiane botërore. Vepra shërben si burim informacioni e si dije referuese për një spektër të gjerë përdoruesish. Vepra vlerësohet për makrostrukturën, sepse ka një pasuri e vlerësueshme njësisish, 3.000 emërtime



Veprimtaria u çel nga akad. Neki Frashëri, Kryetar i Seksionit të Shkencave Teknike dhe Natyrore.

Mbajtën fjalën përshëndetëse z.Imri Demelezi, zëvendësministër i bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural, Kosovë; akad. asoc. Fatbardh Sallaku, Rektor, Universiteti Bujqësor i Tiranës që vlerësuan kontributin e veprës së Agim Zajmit.

Prof. dr. Bedri Dragusha, dekan, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Universiteti i Prishtinës, paraqiti kumtesën "Agim Zajmi - një jetë kushtuar pemëtarisë". Ai bëri një vlerësim të figurës së profesor Agim Zajmit, në njëvjetorin e ndarjes së tij nga jeta.

Më tej, akad. emeritus. Efigjeni Kongjika paraqiti kumtesën "Prof. Agim Zajmi, shkencëtari frymëzues i bashkëpunimit të frytshëm të ASHSH me kërkuesit e Kosovës në fushën e frutikulturës".

Prof. dr. Endrit Kullaj mbajti kumtesën "Pemëtaria" e njohurive; rëndësia e "Fjalorit të pemëtarisë".

Prof. dr. Dionis Çakalli bëri një vlerësim të terminologjisë profesionale në veprën e Zajmit;

Akad. Valter Memisha bëri një vlerësim mbi "Fjalorin". Ai theksoi se mjediset shkencore, universitare dhe kërkimore, por dhe më gjerë, e kanë pasur të domosdoshme në Shqipëri e Kosovë hartimin e një fjalori emërtimeve për pemëtarinë.



Tashmë ne e kemi në duar një të tillë, që erdhi si kurorëzim i një pune dhjetëvjeçare në mësimdhënien akademike universitare, parauniversitare, në punën kërkimore e shkencore e atë eksperimentuese të mbështetur në tekste të tipologjive të ndryshme, hartuar nga profesorë e specialistë me kompetencë shkencore e metodologjike.

Akad. V. Memisha, pasi përmendi traditën në hartimin e fjalorëve për emërtimet dhe termat në fushën e botanikës, të bujqësisë dhe drejtpërdrejt për pemët frutore, vuri në dukje se vepra "Fjalori i pemëtarisë" shënon një shkallë të re në terminografinë shqiptare, mbështetur dhe në traditën më të vyer europiane botërore. Vepra shërben si burim informacioni e si dije referuese për një spektër të gjerë përdoruesish. Hartimi i veprës është drejtuar nga profesor Agim Zajmi, i cili është larguar para një viti nga jeta,

dhe botimi i Fjalorit vjen si homazh për gjithë kontributin e tij shkencor në fushën e Pemëtarisë, në fushën akademike dhe në atë terminografike. Vepra vlerësohet për makrostrukturën, sepse ka një pasuri e vlerësueshme njësisish, 3.000 emërtime, ndër të cilat përmendim: emërtime pemësh frutore; emërtime procesesh që lidhen me mbarështimin e me jetën e këtyre bimëve, emërtime sëmundjesh të pemëtarisë, emërtime për përbërje kimike, për hormone etj, emërtime për veprimtari që lidhen me pemëtarinë, emërtime për disiplina shkencore që, drejtpërdrejt apo tërthorazi, kanë të bëjnë me pemëtarinë, emërtime insektesh që dëmtojnë pemëtarinë etj. “Fjalori i pemëtarisë” mishëron shkencërisht sistematikën e paraqitjes së termësit, si kriteri parësor i ndërtimit të lëndës në një fjalor terminologjik. Klasat, nënklasat, llojet kanë ngritur pemën taksonimike për dhjetëra e dhjetëra fusha konceptoro-terminologjike. Kjo taksonimi vërehet lehtë dhe tregon punën e kujdesshme të hartuesve të tij. Përmendim këtu fushën konceptore që të çon te dardha, te molla, te rrushi, te kumbulla, te pjeshka, tek acidet, etj.



Fjalori dallohet për punën e mirë e me kompetencë shkencore në përzgjedhjen e emërtimeve, në të cilin gjenden emërtime shqip, sidomos emërtime mbarëpopullore, kalkime, terma ndërkombëtarë etj.

Fjalori jep zakonisht edhe gjegjëset e tyre në latinishte. Vepra standardizon dhe kodifikon njëherazi dhe shumësinë e emërtimeve. Ajo jo vetëm regjistron një gjendje të tyre, por hedh në qarkullim në mënyrë shkencore për specialistin, por edhe përdoruesin e gjerë mijëra njësi të fushës. Vepra sjell një pasuri të jashtëzakonshme të emërtimeve popullore, duke treguar dhe aftësinë, mençurinë e përvojën e popullit për të ngritur apo



ndërtuar emërtime mbi tregues të veçantë të pemëve apo të frutave të tyre. Këtu del dhe një vlerë tjetër e veprës, ajo e përhapjes, e përshtirjes së emërtimeve popullore të shumë përdorues, duke i dhënë kështu përparësi pasurisë shqipe në këtë fushë.

Fjalori përfshihet në tipologjinë e fjalorëve terminologjikë me shpjegime. Saktësia dhe qartësia e shpjegimeve mishërojnë përvojën e hartuesve së pari në njohjen shumë të mirë të koncepteve dhe prej këtej në paraqitjen e tyre gjuhësore. Fjalori nuk është thjesht një vepër terminografike. Ai kthehet në dije informuese dhe çka është me rëndësi në dije referuese: për specialistin e bujqësisë, për pedagogun, për studentin, për leksikografin, për enciklopedistin, për qytetarin.

Ai ka krijuar gjedhe shkencore për akribinë me të cilën identifikohet, por dhe gjedhen shkencore të bashkëpunimit ndërmjet studiuesve në hapësirat shqiptare. Mesazhi i veprës në këtë aspekt, si fryt i punës së hartuesve nga Shqipëria e Kosova është domethënës për ta zgjeruar këtë lloj bashkëpunimi dhe në fusha të tjera të dijes.

Gjatë kësaj veprimtarie, prof. dr. Arben Myrta foli për personalitetin e Agim Zajmit, duke e kujtuar si një koleg dashamirës dhe shkencëtar modest, ndërsa prof. asoc. dr. Vahid Avdiu iu përcolli të pranishmëve kujtimet si student dhe koleg i profesorit të nderuar.



Mbresa dhe kujtime sollën në këtë veprimtari edhe prof. dr. Ilir Çiçi, dhe familjarët. E bija, Krenare Zajmi-Leti përshëndeti në emër të familjes dhe falënderoi organizatorët e veprimtarisë.

"Fjalori i pemëtarisë" është hartuar nga specialistë nga Universiteti i Prishtinës (Fakulteti i Bujqësisë) dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës: prof. dr. Agim Zajmi, dr.



---

Lavdim Lepaja, prof. dr. Endrit Kullaj, prof. asoc. dr. Kujtim Lepaja, Akad. Efigjeni Kongjika, prof. asoc. dr. Ilir Çiçi, prof. dr. Vjollca Ibro, prof. dr. Arben Myrta, prof. asoc. dr. Vahid Avdiu, Msc. Naim Krasniqi; me recensentë: prof. dr. Tokli Thomaj, Dr. Sabri Braha, me korrektore gjuhësore: Enkelejda Misha, me kopertinën të dizenuar nga Lejla Ibrahimimi dhe me thyerjen teknike nga Kujtim Lepaja. Vepra është botuar në Prishtinë, 2024.

## **"Kultura mesjetare në hapësirat arbërore"**

- Konferencë shkencore ndërkombëtare -

Më 23 maj 2024, Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave, në bashkëpunim me Institutin e Historisë "Ali Hadri" (Prishtinë), zhvilluan konferencën shkencore ndërkombëtare me temë "Kultura mesjetare në hapësirat arbërore", në bibliotekën e Universitetit "Luigj Gurakuqi".

Konferenca u zhvillua në dy seanca paralele dhe në të morën pjesë 16 studiues të njohur të periudhës së historisë mesjetare shqiptare.

Pjesëmarrësit vinin nga gjashtë institucione të ndryshme, si Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave, Instituti i Historisë "Ali Hadri"; "Albanisches Institut" i St. Gallenit (Zvicër); departamenti i historisë i Universitetit "Luigj Gurakuqi"; departamenti i historisë i Universitetit të Tiranës, si dhe nga Universiteti "Eötvös Loránd" (ELTE) Budapest.



Çështjet që u trajtuan në konferencë ishin të shumta. Ato prekën një periudhë kohore nga Mesjeta e hershme e deri në Mesjetën e vonë. Tematikat ishin të fushave të ndryshme. Ato kishin të bënim me historinë kishtarë të trojeve shqiptare; me hulumtime arkeologjike të kishave dhe qyteteve të ndryshme mesjetare; me çështje të historisë ekonomike; me çështje administrative, sidomos me administrimin venedikas të Shkodrës në shekullin XV, si dhe me veprimtarinë politike të grave fisnike në Arbëri gjatë Mesjetës së vonë.

Në fund të seancave u bënë edhe diskutime në lidhje me temat e mbajtura.

## Përkujtohet me nderim në vendlindjen e tij në Pallagorio (Puhëriu) veprimtaria e italo-arbëreshit Anselmo Lorecchio, në 100-vjetorin e ndarjes nga jeta

- Organizatorë të veprimtarisë shkencore-jubilare - Fondazione Universitaria "Francesco Solano" dhe komuna e Puhëriut arbëresh

- Me pjesëmarrjen e drejtuesve dhe bashkëpunëtorëve të njësisë së kërkim-studimit për arbëreshët, arvanitët dhe arbneshët pranë Akademisë së Shkencave (Nj.K-S.A.A.A.)

- Kumtuan për personalitetin e Anselmio Lorecchio-s anëtarët e jashtëm të ASHSH Francesco Altimari dhe Matteo Mandalà, njëherësh drejtues të Nj.K-S.A.A.A.; si dhe prof. Blerina Suta, bashkëpunëtoresh e kësaj njësie

- I ngarkuar nga Kryesia e ASHSH, në emër të saj përshëndeti prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi, drejtor i QBAE



Veprimtaria u zhvillua në dy pjesë: nderimet ceremoniale-protokollare, me pjesëmarrjen e autoriteteve të larta nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut e Mali i Zi (presidentë e ish-presidentë, kryeministra e ish-kryeministra); dhe sesioni shkencor kushtuar Anselmo Lorecchio-s, veprimtar politik për çështjen shqiptare gjatë Rilindjes dhe Pavarësisë; themelues e drejtues i së mirënjohurës "La nazione albanese"; që advokoi me zell, vendosmëri e diplomaci në mbrojtje të Shqipërisë së pavarur.

Pasi përcolli përshëndetjet e Kryesisë prof. M. Kasmi theksoi se personaliteti i Anselmo Lorecchio-s përbën një nga shembujt më tipikë të nevojës për të plotësuar e rishikuar historinë tonë kombëtare. "I dënuar" pa shkak me harresë nga historiografia shqiptare në vitet 1945-1990, i rizbuluar në fillimvitet 1990, por i trajtuar pjesërisht e me gjithë mangësitë tipike metodologjike të kësaj periudhe, të inkurajuara edhe nga

mungesa e burimeve arkivore.

Studimet për Lorecchion vijnë në këtë përvjetor të 100-të ndarjes së tij nga jeta në një formë më të plotë e më objektive. Një hap cilësor në ndriçimin e kontributit atdhetar të Lorecchios është hedhur me botimin e "Fjalorit Enciklopedik Shqiptar" në vitin 2008 nga Akademia e Shkencave. Në botimet e mëparshme enciklopedike emri i tij nuk ekziston as për t'u pohuar, as për t'u mohuar. Disa pasaktësi që përmban FESH (2008) do të sqarohen në artikullin që do t'i kushtohet atij në "Enciklopedinë shqiptare" që po hartohet nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Tanimë, si pasojë edhe e ballafaqimit me një dokumentacion arkivor më të shumtë, jemi në gjendje të bëjmë një vlerësim më të plotë të veprimtarisë së tij.

Në rol të rëndësishëm luan në procesin e ndriçimit të historisë dhe trashëgimisë arbëreshe Nj.K-S.A.A.A., e ngritur në vitin 2021 pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e cila ka në misionin e saj organizimin e bashkëpunimit brenda bashkësisë së studiuesve të botës arbëreshe-arvanite-arbneshe për të mundësuar thellimin e kërkimeve dhe studimeve për trashëgiminë materiale e shpirtërore, historike e kulturore, gjuhësore e letrare të diasporës shqiptare.



Duhet theksuar se Lorecchio kishte një përvojë të madhe politike dhe e njëjtte mirë gjendjen në Shqipëri. Zhvillimi i reformave drejt autonomisë së saj në fund të shek. XIX mbështetej me forcë nga Lorecchio. Sipas tij, linja më e frytshme e qëndrimit të shqiptarëve në kontekstin gjeopolitik të asaj kohe ishte kryerja e reformave dhe rregullimeve të brendshme, që do ta bënin Shqipërinë të zonjën të kishte marrëdhënie me botën e qytetëruar. Shqiptarët duhej që të kërkonin në vazhdimësi ndihmën e Italisë dhe të fuqive të tjera për t'ia arritur këtij qëllimi. Ata duhej të ngulnin këmbë që të mos lejonin të cenohej atdheu i tyre. "Vetëm kur ne shqiptarët e Italisë do të mundim të kemi marrëdhënie me vëllezërit tanë përtej Adriatikut duke kapërcyer vigjilencën arrogante të

---

porteve austriake, shkruante Lorecchio, do të mundim të kundërshtojmë me armë të barabarta ndikimin grek, sllav dhe austriak, sikundër edhe qendrimet e "Propaganda Fide-s", që shkojnë krah për krah me këto të fundit".

Sipas Lorecchio-s, unifikimi i territoreve shqiptare nuk mund të arrihej nëse nuk rishikohej Traktati i Kongresit të Berlinit. Duke qenë se në këtë pikë Italia dhe Shqipëria kishin interesa të përbashkëta, ai propozonte një aksion politik të Italisë në dobi të kombit shqiptar. Kjo mbështetje duhej të vinte në formën e shpalljes së autonomisë së Shqipërisë. Duhet theksuar se, pas përfshirjes në politikë të lëvizjes italo-shqiptare, pati përfaqësues të elitës shqiptare, si Faik Konica, që nuk e mirëpritën këtë gjë. Ndërsa Ismail Qemali kërkonte marrëdhënie të mira me italo-shqiptarët dhe ishte pritur gjithmonë mirë në Kalabri dhe Siçili.

Lorecchio pati pohuar haptazi se dy parime themelore udhëhiqnin përpjekjet politike të italo-shqiptarëve. E para që shprehur në sloganin "Shqipëria për shqiptarët", që përputhej edhe me politikën italiane të kohës. Slogani i dytë i tij ishte që "Adriatiku ishte një det italian dhe shqiptar". Të dytën italianët nuk do ta pranonin, duke dëshiruar që Adriatiku të ishte një det vetëm italian. Më vonë, gjatë bashkëpunimit të italo-shqiptarëve me irredentizmin italian, që u ringjall pikërisht nga çështja shqiptare, ata u akuzuan për krijim turbullirash në dëm të qeverisjes. Megjithatë, ata nuk u sprapsën nga përgjegjësia që binte mbi ta nga të quajturit e irredentizmit "si një mjet ndihmës për zhvillimin e tezës kryesore: "Shqipëria për shqiptarët".



## Për veprimtarinë shkencore kushtuar akademikut albanolog Mario Roques

Më datën 10.5.2024, në sallën “Akademikët” u mbajt tryeza shkencore kushtuar filologut dhe albanologut frëng Mario Roques (1875-1961), si bashkëpunim mes Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.



Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Shaban Sinani mbajti fjalën e hapjes së kësaj tryeze shkencore, duke nënvizuar më së pari rëndësinë e përkujtimit të kontributeve të filologut Mario Roques në disa fusha themelore të gjurmimeve albanologjike, ndër të cilat dallohen pikërisht hulumtimet mbi tekstet më të hershme shqipe dhe çështje të dokumentimit shkrimor të tyre. Për vetë formimin kompleks dhe njohjen e disa disiplinave studimore, me arritjet e tij M. Roques nxiti një perspektivë të gjerë trajtesash, duke spikatur jo pak dhe me gjurmimet mbi tekstet e vjetra shqipe, reflektuar dhe në veprën me të njëjtin titull që pa dritën e botimit në vitin 1932, pothuaj në një kohë të afërt me botimin fotomekanik të "Dicionarit latinisht-shqip" të Frang Bardhit, botuar për herë të parë në vitin 1635 nga tipografia e kongregacionit të Propaganda Fide-s.

Formimi i veçantë i studiuesit Mario Roques dhe historiku i kontributeve specialistike të studiuesve francezë që janë interesuar për gjuhën shqipe dhe kulturën shqiptare qenë argumente të trajtuara gjerësisht dhe me një arsenal të dhënash të pasura nga prof. dr. Tomorr Plangarica (Institutit i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), i cili mbajti referimin me titull “Mario Roques - vijues i një tradite dhe nismëtar i një tjetre (shqyrtimet

filologjike dhe mësimdhënia e shqipes në Francë”. Personaliteti kompleks i filologut frëng Mario Roques u ilustrua me një sërë të dhënash mbi angazhimet e tij në fushë të kërkimit shkencor e të mësimdhënies universitare, por dhe në komisione e redaksi shkencore të cilat mbajtën gjatë në përbërje të tyre emrin e tij.

Për kontributin e studiuesit frëng Roques në lidhje me tekstet e vjetra shqipe dhe domosdoshmërinë e vështrimit filologjik të tyre foli gjerësisht prof. dr. Anila Omari (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë), e cila u ndal në disa aspekte të trajtesave të tij në këtë drejtim. Grafemat speciale që gjurmohen në tekstet e e librit të parë të njohur deri më sot të shkruar në gjuhën shqipe dhe që janë të ndryshme nga ato të alfabetit latin, ekzemplarët e veprave të letërsisë së vjetër shqipe të shekullit XVII dhe njohja e historikut të tyre (në veçanti përpilimet e Pjetër Budit), ndikimet nga kultura të tjera shkrimore dhe vendi i mundshëm i shtypjes së “Mesharit” të Gjon Buzukut, në dritë dhe të arritjeve më të fundit nga studiues që njohin e konsiderojnë dhe pikëpamjet e M. Roques, u trajtuan hollësisht nga prof. dr. Anila Omari.



Prof. dr. Mimoza Priku (Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”) u ndal në trajtimin e kontributit të albanologut Mario Roques në vështrimet e studiuesve shkodranë, duke nënvizuar në veçanti reflektimet e F. Fishtës, W. Kamsit (njëherësh dhe përkthyes i parathënies së plotë të M. Roques në hyrje të botimit fotomekanik të "Dictionarit latinisht-shqip" të F. Bardhit që daton në vitin 1932), M. Camajt, T. Osmanit etj. Përkujtimi i emrit të W. Kamsit në këtë kumtesë, njëherësh kultivues i fondeve të albanologjisë në bibliotekat e qytetit të Shkodrës u lidh ngushtë dhe me kujdesin e tij që të sillte sa më të plotë ndihmesat e M. Roques dhe në veprën e përkthyer disa vite më

parë, pikërisht “Gjurmime mbi tekstet e vjetra shqipe”, Botime Françeskane, Shkodër, 2011.

Prof. asoc. dr. Evalda Paci (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë) mbajti referimin me titull “Mario Roques (1875-1961), magister et philologus omnium temporum”, duke nënvizuar disa momente të rëndësishme të rrugëtimit të tij profesional, të lidhura me lindjen e interesave ndaj filologjisë, leksikologjisë, studimeve mbi tekstet mesjetare, historisë së shkrimeve të vjetra në disa gjuhë të Europës. Artikuj të veçantë në të cilat ai trajton dhe çështje të njohjes së një gjeografie të shpërndarjes së ekzemplarëve të veprave më të rëndësishme të letërsisë së shkruar shqipe (trajtuar dhe në veprën e mirënjohur “Recherches sur les anciens textes albanais”, Paris, 1932), por dhe vepra të plota të shkruara prej tij u përmendën në këtë trajtesë, bashkë me interpretime komemorativë të përpiluara nga viti 1961 nga dishepuj e kolegë të tij (Jean Frappier, Félix Lecoy, Alfred Merlin, Maurice Delbouille etj.), me të njëjtat interesa studimi e kërkimi.



Mario Roques ka hyrë në traditën e studimeve shqiptare për një sërë sprovash dhe trajtesash studimore në të cilat ai bën fjalë për tekstet e vjetra shqipe dhe evidentimin e modeleve librore mes të cilave njihen këto të fundit. Emri i tij është i pranishëm në vëllime enciklopedike të rëndësishme në disa gjuhë, në të cilat nënvizohet pikërisht kompleksiteti i interesave të tij studimore dhe ndërthurja metodologjike e vështrimeve shkencore mbi një sërë fushash. Burimet letrare më të hershme në gjuhën frënge, provencalishtja, latinishtja vulgare, gjuhët romane (ndër të cilat dhe rumanishtja), gjuha shqipe dhe dëshmimi shkrimor i saj më i hershëm, korpuset leksikore për të cilat ruajti deri në fund një interes të madh (në veçanti "Novum Glossarium"), periodikët shkencorë për të cilët u

---


kujdes në vijimësi (në veçanti revista “Romania”), shkrimet e shumta përkujtimore në nder të tij u përmendën në këtë veprimtari të sotme shkencore, të iniciuar si bashkëpunim mes Seksionit Shkencor të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike dhe Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.



---

## Zhvillohet në Vienë mbledhja ceremoniale tradicionale për vitin 2024, organizuar nga Akademia e Shkencave e Austrisë (ÖWA)

- Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të akademive anëtare të ALLEA-s (All European Academies)



Me një solemnitet të lartë, atmosferë festive, kulturë zyrtare, rregull aristokratik ceremonial dhe pak humor, Akademia e Shkencave e Austrisë zhvilloi mbledhjen e saj vjetore, e njohur si "asambleja ceremoniale e majit", me praninë e përfaqësuesve të akademive anëtare të ALLEA-s dhe të organizatave shkencore ndërkombëtare. Përveç përfaqësuesve të ALLEA-s, të pranishëm këtë vit edhe drejtues të EUSAC ("European Academies - Science Advisory Council") dhe të "The World Academy of Sciences" - TWAS).

Në seancën e parë, pas fjalës së hapjes nga kryetari Heinz Fassman, përhëndeti ministri për arsimin, shkencën dhe kërkimin Martin Polaschek. Më tej kryetari Fassman paraqiti raportin vjetor të institucionit mbi veprimtarinë shkencore gjatë vitit të kaluar, i cili u miratua me duartrokitje të gjata nga të pranishmit: akademikë, anëtarë të jashtëm të ÖWA, anëtarë nderi, përfaqësues të institucioneve të larta të vendit dhe të ftuar. Kryetari Fassman iu referua disa herë gjatë raportimit prej rreth 30 minutash letrës së hapur të kryetarëve të akademive të vendeve anëtare të BE-së (botuar në faqen zyrtare të ASHSH shqip e anglisht) drejtuar kandidatëve për eurodeputetë për bashkëpunimin e politikës me shkencën dhe mbështetjen e kërkimit. Pyetjet dhe diskutimet rreth raportit, sipas standardit austriak, parashtrohen në analiza të mëpërparshme në seksione, institute dhe departamente.



Pas një intervali muzikor me pjesë nga Johann Sebastian Bach u kalua në seancën e dytë, në të cilën presidenti i "Kronos Bio" Norbert Bischofberger paraqiti referatin "Von Mellau in die Welt, ein Wissenschaftler als Gründer" / "Nga Mellau (vendlindje e autorit, një vendbanim i vogël në kufijtë Austri-Zvicër) drejt Botës së madhe - një shkencëtar që ka hedhur themele". Në këtë ligjëratë të hapur Bischofberger paraqiti rrugën e gjatë të formimit të tij, nga një universitet në tjetrin (Innsbruck, Zürich, Oxford, Berkeley, Yale, Harvard) dhe më pas të zbulimeve të mëdha me rëndësi historike për shëndetin e njerëzimit, që prej sëmundjeve pulmonare, hepatiti C, sëmundjet infektive në përgjithësi, deri tek përdorimi i IA në funksion të shëndetit. Ndër të tjera është e njohur botërisht vaksina "Bischofberger Tamiflu".



Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave e Austrisë kanë një bashkëpunim tradicional, i fuqizuar me nënshkrimin e marrëveshjes së re vitin e kaluar nga kryetarët Gjinushi e Fassman. Në frymën e kësaj marrëveshjeje, gjatë një bashkëbisedimi me kryetarin Fassman dhe drejtorin për marrëdhëniet ndërkombëtare Bernhard Plunger, sekretari shkencor i ASHSH Shaban Sinani, i pranishëm si përfaqësues i saj në mbledhjen ceremoniale, foli për disa nisma shkencore me interes të përbashkët që do të realizohen këtë vit dhe gjatë vitit 2025, si konferenca për lashtësinë e shqipes si gjuhë indoeuropiane (nëntor 2024: prof. Joachim Matzinger dhe dy kolegë të tij nga ÖWA do të referojnë); konferenca shkencore shqiptaro-austriake për kulturën e shkëmbimeve në mijëvjeçarin e parë p. K. sipas gjetjeve të arkeologjisë (me rastin e ekspozimit të "Kalorësit të Babunjës" në "Golden Salle" të Muzeut Historik të Natyrës); konferenca kushtuar personalitetit të Karl Gegës - Ritter Karl von Gega - në proces bashkëpunimi tashmë me "Museo Correr" të Venecias, nën drejtimin e albanologes Lucia Nadin. Akad. Sinani informoi gjithashtu për ngritjen e një qendre të re afatgjatë të bioteknologjisë pranë ASHSH, si një mundësi e fuqizuar për një bashkëpunim relativisht tradicional dypalësh. U ra dakord që këto projekte të ndiqen hap pas hapi bashkërisht.

---

Në takimin me prof. Wim van Saarloos, president i EASAC, veprimtaria e së cilës mbështetet në sloganin "Science Advice for the Benefit of Europe", ASHSH u ftua që të anëtarësohet e të kontribuojë në fushat prioritare të kësaj organizate: shëndeti, mjedisi dhe klima.

Për bashkëpunimin sipas marrëveshjeve u diskutua edhe me kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Malit të Zi Dragan K. Vukčević, i cili njoftoi se vepra e akademikut shqiptar Ismail Kadare "Kur sunduesit grinden" është përkthyer tashmë në gjuhën e vendit të tij dhe, në përputhje me marrëveshjen, do të botohet së shpejti me titullin "Kad se vladari zvedjaju"; me kryetarin e Akademisë së Shkencave të Sllovenisë Peter Štih; me kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Bosnjës Muris Čičić etj.

Mbledhja ceremoniale u mbyll me himnin e Europës dhe me një pjesë muzikore nga kompozitori Jeremiah Clarke "Trumpet Voluntary".

[https://youtu.be/SO-IG\\_xwOeo?si=QBfpqTrkEd36Rb6O](https://youtu.be/SO-IG_xwOeo?si=QBfpqTrkEd36Rb6O)

---

## **U mbajt në Mitrovicë forumi shkencor “Studimi gjeologo-sizmik i zonave së thyerjeve tektonike tërthore Kurbnesh-Kukës-Prizren dhe Shkodër-Pejë dhe vlerësimi i rrezikut sizmik”**

- Veprimtaria është koordinuar nga njësia e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive pranë Akademisë së Shkencave. Organizimi i kësaj veprimtarie u bë i mundur nën kujdesin e Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi dhe Kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës akad. Mehmet Kraja. Kjo njësi ka sot në përbërje 11 grupe kërkimore shkencore me 80 bashkëpunëtorë të shtrira në Shqipëri dhe Kosovë -



Më 22 maj 2024 në Mitrovicë u mbajt forumi shkencor “Studimi gjeologo-sizmik i zonave së thyerjeve tektonike tërthore Kurbnesh-Kukës-Prizren dhe Shkodër-Pejë dhe vlerësimi i rrezikut sizmik”.

Veprimtaria u mbajt në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, gjegjësisht njësinë e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive; Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës; Universitetin “Isa Boletini” dhe Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit të Shqipërisë.

Organizimi i kësaj veprimtarie u bë i mundur nën kujdesin e Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi; Kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës akad. Mehmet Kraja dhe të Rektorit të Universitetit

“Isa Boletini” të Mitrovicës prof. dr. Nurten Deva.

Veprimtaria u çel nga akad. asoc. Rrapo Ormëni, i cili mbajti fjalën përshëndetëse si drejtues i njësisë kërkimore të gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive.

Ai përgëzoi Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe UMIB për organizimin e këtij forumi shkencor dhe më tej falënderoi prof. Naser Pecin për angazhimin e vazhdueshëm në aktivitetet e njësisë kërkimore të gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive dhe për bashkëpunimin e ngushtë që është krijuar me Fakultetin e Gjeoshkencave në universitetin “Isa Boletini” të Mitrovicës dhe institucionet e ndërmarrjet e tjera në Kosovë, që kanë të bëjnë me gjeoshkencat dhe gjeoinxhinieritë.



Është e një rëndësie të veçantë të jemi të mbledhur sot këtu në qendrën e gjeoshkencave të Kosovës, por dhe mbarëkombëtare, për të shkëmbyer idetë dhe strategjitë më të mira për studimin gjeologo-sizmik dhe vlerësimet e rrezikut sizmik për një jetë më të sigurt, tha z. Ormëni dhe theksoi se sistemi i thyerjeve tektonike aktive me shtrirje në Shqipëri-Kosovë paraqitet si një zonë me rrezik sizmik potencial për sa u përket zonave urbane, infrastrukturës dhe veprave inxhinierike me karakter strategjik, të cilat ndodhen në Shqipëri dhe Kosovë.

Ai vuri në dukje se qëllimi i kësaj veprimtarie është që të shohim së bashku sesi mund të përdorim këto njohuri për të zhvilluar politika për vlerësime të gjeorrezizqeve përmes bashkëpunimeve/projekteve ndërshtetërore që do të na çojnë drejt një jete më të sigurt.

Akad. Ormëni kujtoi se me kërkesën gjithnjë në rritje të dy akademive, ASHSH dhe ASHAK, për ngritjen e nivelit të kërkimit shkencor mbarëshqiptar, u mundësua ngritja para një viti e njësisë kërkimore në fushën e gjeoshkencave pranë ASHSH.

Në tetor të vitit kaluar, disa muaj mbas krijimit të kësaj njësie, në Fakultetin e

Gjeoshkencave në Mitrovicë u mbajt takimi për të diskutuar mbi objektivat nxitjen dhe koordinimin e aktiviteteve shkencore dhe ngritjen e rrjetit të bashkëpunëtorëve me përkushtimin e plotë nga dekani Festim Kutllovci dhe gjithë stafit akademik.

Deri më sot njësia e gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive ka nxitur dhe koordinuar shumë aktivitete shkencore dhe projekte shkencore të përbashkëta Shqipëri-Kosovë të realizuara në këtë periudhë të shkurtër, por mjaft intensive. Njësia ka sot në përbërje 11 grupe kërkimore shkencore me 80 bashkëpunëtorë të shtrira në Shqipëri dhe Kosovë.

Njësia realizoi një projekt me AKKSHI-n dhe ka fituar dy projekte bilaterale Shqipëri-Kosovë po në kuadër të AKKSHI-t me bashkëdrejtues dhe anëtarë nga Shqipëria dhe Kosova, ku marrin pjesë UMIB dhe UP. Ka fituar gjithashtu dhe 3 projekte me mbështetje nga ASHSH, si dhe ka aplikuar për dy projekte bashkëpunimi të ASHSH me ASHAK dhe në 3 projekte të tjera e kuadër të AKKSHI-t. Mbledhja e këtij forumi do të çojë patjetër edhe në aplikime projektesh më madhore me rëndësi kombëtare në fushat gjeologji, sizmologji, dhe hidrometrologji etj., tha akad. asoc. Ormeni.



Veprimtaria u zhvillua me dy sesione bazë: zona e thyerjes tërthore Kurbnesh-Kukës-Prizren; zona e thyerjes tërthore Shkodër-Pejë. Mbjatën kumtesa akad. asoc. Rrapo Ormeni, bashkëkryeta; prof. dr. Naser Peci; akad. Fejzullah Krasniqi; prof. dr. Fetah Podvorica, anëtar korrespondent i ASHAK; prof. dr. Behxhet Shala. prof. dr. Ismail Hoxha; prof. dr. Zenun Elezaj; prof. dr. Sabri Avdullahi; prof. asoc. dr. Nazmi Hasi; dr. Arjol Lule; dr. Shemsi Mustafa; dr. Dhurata Ndreko.

Qëllimi i këtij forumi që u mbajt në Mitrovicë është studimi i thyerjes tektonike aktive Kurbnesh- Kukës-Prizren, që paraqitet si një zonë me rrezik sizmik potencial për sa iu përket zonave urbane, infrastrukturës dhe veprave inxhinierike me karakter



---

strategjik, që ndodhen të afërsi të saj. Kjo thyerje ndërkufitare, që shtrihet në të dyja shtetet tona, përfshirë territorin e Shqipërisë deri në atë të Kosovës ka gjeneruar një seri tërmetesh të madhësive të ndryshme.

Gjatë zhvillimit të këtij forumi u trajtuan një sërë tematikash të lidhura edhe me rrezikun sizmik:

- Njohja e mirë e këtyre thyerjeve, lidhur këto me disa tërmete të ndodhur së fundmi;

- Njohja me aktivitetin sizmik të thyerjeve tektonike do të hedhin dritë mbi sizmotektonikën e zonave;

- Qasje ndër-disiplinare ku të përfshihen inxhinierë gjeologë, gjeofizikantë, sizmiologë, ekspertë të GIS-it etj. për të studiuar në mënyrë më të thelluar aktivitetin e lartë sizmik të këtyre thyerjeve tektonike.

Forumi synon të rekomandojë:

- Rëndësinë e veçantë të metodave gjeofizike dhe gjeologo-inxhinierike, së bashku me karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike të nënshtresave lokale, për një studim të thelluar të aktivitetit të thyerjeve tektonike tërthore;

- Forcimin e lidhjeve të bashkëpunimit midis akademikëve, profesorëve dhe shkencëtarëve nga Shqipëria dhe Kosova duke përmirësuar praktikën akademike në tematikat e gjeologjisë inxhinierike, sizmologjisë dhe gjeofizikës së aplikuar.

---

## Paweł Rowiński, President i ri i ALLEA-s



Paweł Rowiński holds a degree in mathematics by the University of Warsaw, and doctoral and habilitation degrees in earth sciences with a specialisation in geophysics by the Institute of Geophysics, Polish Academy of Sciences. Among others, his research interests include mathematical methods in geophysics, geophysical flows, river hydrodynamics, and fluvial hydraulics.

Paweł Rowiński has published more than 160 refereed scientific publications. He serves as Associate Editor for several prominent scientific journals and publications. In 2018 he was elected the Vice Chair of the Europe Division Leadership Team of the International Association for Hydro-Environment Engineering and Research IAHR. Since May 2015, he serves as Vice-President of the Polish Academy of Sciences (second term in office).

## 80 vjet nga Kongresi i Përmetit

- Kuvend i antifashizmit të popullit dhe i vendimeve historike -
- Fjalë përshëndetëse nga Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi në veprimtarinë kushtuar 80-vjetorit të Kongresit të Përmetit -



Veprimtaria u mbajt në sallën “Aleks Buda” në Akademinë e Shkencave, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizatës së veteranëve të luftës antifashiste dhe familjeve të tyre, të studiuesve të historisë bashkëkohore dhe të përfaqësuesve të shtypit. Takimi u drejtua nga dr. Saemira Pino.

Akad. Skënder Gjinushi, kryetar i ASHSH, u uroi të pranishmëve mirëseardhjen në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe përgëzoi organizatorët, organizatën e veteranëve të Shqipërisë, për zhvillimin e kësaj veprimtarie në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të vendit.

Ne e vlerësojmë organizatën e veteranëve dhe të pasardhësve të familjeve të tyre e të dëshmorëve të vendit si një organizatë e kujtesës historike.

Kongresi i Përmetit, me vendimet e tij, është një ngjarje me rëndësi për periudhën e Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri e në trojet shqiptare.

Është ngjarje që shënon kalimin në fazën e çlirimit të plotë të vendit nga nazifashistët, në një moment kur forcat nacionalçlirimtare ishin të riorganizuar për ta zgjidhur përfundimisht këtë detyrë. Fuqitë demokratike dhe aleanca antifashiste e kishte fituar betejën në mbarë botën.

Rezultatet e fitores antifashiste botërore përcaktuan rrjedhën dhe rendin e ri botëror për 40-50 vjetët e ardhshëm.

Që prej fillimeve të përplasjes së kampeve e aleancave të mëdha kundërshtare Shqipëria dhe shqiptarët u rreshtuan drejt, përkrah krahut demokratik. Midis fashizmit e antifashizmit shqiptarët zgjodhën antifashizmin; midis komunizmit e demokracisë, në fundin e viteve 1990, ata zgjodhën krahun e demokracisë.



Antifashizmi është vlerë edhe sot e jo vetëm një vlerë historike. Fashizmi i ri i Putinit po përdoret për të justifikuar pushtimin e Ukrainës, me sloganin e "luftës antinaziste".

Veprimtari të tilla vlejnë për të vënë në pah këto vlerat historike të shqiptarëve, për të mos lejuar deformimin e historisë dhe përbaltjen e luftës së shqiptarëve ndaj fashizmit në Shqipëri e në Kosovë; qendresën e shqiptarëve në Kosovë ndaj genocidit serb më 1998-1999. Kjo është detyra e historianëve. Historia rishkruhet, por nuk ribëhet, nuk përmbysset nga bardhë-e-zi në zi-e-bardhë.

Në konferencë z. Naxhi Zhupa, veteran dhe pedagog i historisë ushtarake, mbajti një kumtesë për efektet e vendimit të Kongresit të Përmetit për kalimin e formacioneve partizane në ushtri të rregullt.

Në vijim dr. Shaqir Vukaj mbajti kumtesën "Kongresi i Përmetit dhe fundi i të quajturave elita shqiptare"; prof. dr. Ksenofon Krisafi mbajti kumtesën "Shqiptarët dhe koalicioni antifashist" dhe akad. Pëllumb Xhufi kumtesën "Viti 1944: shqiptarë mbrojtës dhe shqiptarë shitës së kufijve".

---

## **Një studim për rolin diferencues të rivaliteteve kishtare, kundërvëniet politike dhe transformimeve iluministe nga akad. Albert Doja**

- Botuar së fundmi në revistën "Studime historike" -

Një përmbledhje e artikullit në vijim:

Në pjesën e parë të këtij studimi u shqyrtua përdorimi i hershëm fetar i gjuhës shqipe, kryesisht në shek. XVII dhe XVIII, që në kombinim me rivalitetet kishtare duhet të ketë promovuar një lloj procesi të natyrshëm diferencimi kulturor.

Në pjesën e dytë theksi vihet mbi kundërvëniet e ndryshme politike ndaj sundimit otoman, si dhe mbi përballjen kishtare dhe kundërveprimet misionarizuese kryesisht në Shqipërinë e Jugut.



Në veçanti argumentohet se si motivimet kontradiktore të politikave të ndryshme të përdorimit të gjuhës në shërbesat e kishës dhe në mësimdhënien e shkollës duhen parë edhe në kontekstin e përhapjes së ideve iluministe dhe të kundërsulmeve kishtare për riungjillëzimin ortodoks. Në përgjithësi, këto lloj kundërvëniesh kanë përforcuar proceset kufindarëse që duhet të kenë shërbyer për riorganizimin social të ndryshimeve gjuhësore dhe kulturore, veçanërisht midis të krishterëve ortodoksë greqishtfolës dhe shqipfolës.

Për të gjithë ata që janë të interesuar për artikullin të plotë linku më poshtë:

<https://doi.org/10.61773/q6f6bg26>



## Viti i Anselmo Lorecchio-s: nderime shkencore e zyrtare në Itali nga njësia për arbëreshët pranë Akademisë së Shkencave dhe institucione të tjera

- Posta italiane - një vulë postare filatelike dhe një kartolinë e dedikuar për njëqindvjetorin e vdekjes së Anselmo Lorecchio / Poste italiane - un annullo filatelico e una cartolina dedicata per il centenario della morte di Anselmo Lorecchio -

- Zhvillohet edicioni i 29-të i manifestimeve kulturore dhe folkloristike për vlerësimin e pakicave etnike në Itali. Kjo traditë gati 30-vjeçare sivjet i kushtohet personalitetit të Anselmo Lorecchio-s, italo-arbëresh me veprimtari krijuese, publicistike, diplomatike; i njohur për drejtimin dhe botimin e gazetës "La Nazione Albanese", në 100-vjetorin e ndarjes nga jeta -

- Njësia e kërkim-studimit për arbëreshët, arvanitët dhe arbneshët, e drejtuar nga akademikët Francesco Altimari e Matteo Mandalà; Fondazione Universitaria "Francesco Solano" dhe laboratorit i albanologjisë i Universitetit të Kalabrisë - organizatorë të veprimtarisë njëditore -

- Të pranishëm e kumtues njohës së veprës së gjerë të Lorecchio-s, miq të botës arbëreshe, përfaqësues të qeverisjes rajonale dhe diplomatë -



Sipas shtypit të vendit, "l'obiettivo della manifestazione, rinnovato da circa trent'anni, dedicato quest'anno alla figura di Anselmo Lorecchio, è quello di tutelare il patrimonio storico, linguistico e culturale delle comunità di etnia minoritaria sparse per il Mezzogiorno d'Italia". Jo rastësisht kjo lidhje e emrit të Lorecchio-s me gjuhën dhe kulturën e pakicave në Itali. Ai që i pari që shtroi juridikisht çështjen e mësimin të arbërishtes në shkollat e të gjitha komuniteteve arbëreshe, me një përkrahje të të gjitha komunave dhe të intelektualëve, një "lobim modern" që shfrytëzoi me shtypin me rastin e kërkesës së De Radës për katedrën e parë të shqipës në Universitetin e Napolit "L'Orientale", shkruan Francesco Altimari.

Veprimtaria u zhvillua nën titullin "Anselmo Lorecchio e il suo tempo: Italia, Arbëria e mondo albanese tra fine Ottocento e inizi del Novecento". Ambasadorja e Shqipërisë Anita Bitri dhe ambasadorja e Kosovës Lendita Haxhitasim përshëndetën organizatorët dhe të pranishmit.

Francesco Altimari, drejtues dhe folës kryesor në këtë ngjarje shkencore-jubilare; Matteo Mandalà, Blerina Suta, Spartaco Capogreco, Shaban Sinani e Francesco Fabbriatore referuan për aspekte të ndryshme të veprës së Lorecchio-s.

Akad. Sinani e paraqiti "në linjë" video-kumtesën e tij "Anselmo Lorecchio, protagonist i dy periudhave historike shqiptare". Për një kohë të gjatë emri dhe vepra e Lorecchio-s në Shqipëri nuk janë njohur, theksoi autori. Edhe kur përmendej "La Nazione Albanese", emri i tij nuk ishte aq i dëshiruar. Në plot raste të tjera, veprat e tij të mirënjohura, "Il pensiero politica albanese in rapporto agli interessi italiani", "Relazioni diplomatiche tra la Santa Sede e lo Stato Albanese", "Gli italo-albanesi per la redenzione della loro patria di origine", janë konsideruar më shumë si kontribute të një mendimtari italian se të një arbëreshi. Rikthimi i Lorecchio-s në vendin e nderit ka qenë e vazhdon të jetë i ngadaltë.

I ardhur prej shekullit të romantizmit, prej projekteve ideale për një Shqipëri të ëndërrt, Anselmo Lorecchio jetoi dhe shkroi e veproi më shumë kur pavarësia e Shqipërisë u kthye në projekt, një projekt që nuk ishte vazhdim linear i utopisë etnocentriste rilindëse. Si njohës i shkëlqyer i situatës në vendin e origjinës pas shembjes së perandorisë teokratike otomane dhe në kushtet e luftërave ndërballkanike për të shtyrë kufirin në dëm të njëri-tjetrit, Lorecchio nuk mund t'i lejonte vetes ta shihte të ardhmen symbyllur. Kjo gjendje e ndërlikuar dhe e rrezikshme e zhvendosi Lorecchio-n nga idealizmi në realpolitikë.



Doktrina e tij kishte lidhje me frikën se Shqipëria e dalë jashtë supershtetit otoman, edhe nëse do t'i njihej pavarësia në kufijtë historikë, nuk do të ishte në gjendje të vetëmbrohej. Me të drejtë ai i vlerësonte arbëreshët si një faktor që, në çdo rast, nëse Italia

---

fqinje mund të merrte përgjegjësi për një pavarësi të mbrojtur të Shqipërisë, ata nuk do të lejonin që proteksionizmi të kthehej në një formë tjetër ksenokracie. Lorecchio e shihte Italinë si vendin më pak rrezikues për pavarësinë e Shqipërisë, krahasuar si me fqinjët, ashtu dhe me fuqitë europiane. Por në historiografinë e mëhershme zyrtare të Shqipërisë pranimi i nevojës për mbështetje nga një faktor i jashtëm konsiderohej rënie në autonomizëm dhe thujtje kapitullim e tradhti. Kjo është një nga arsytet e dënimit të gjatë me heshtje të veprës politike atdhetare të Lorecchio-s, dhe për ta thyer këtë heshtje nuk i erdhi në ndihmë as vepra "Imperialismo latino-italico nell'Oriente Europeo e gli italo-albanesi - appunti e ricordi".

Duke ndjekur një këshillë shumë të vlefshme të profesorit të nderuar Francesco Altimari iu drejtua burimeve arkivore shtetërore në Tiranë për të vërejtur e krahasuar gjurmën e dorëshkrimeve të Lorecchio-s në to. Dy konstatime janë të rëndësishme lidhur me këtë, pas një ekskursioni kërkimor në përgjigje të pyetjes së prof. Altimarit në rrjetin e arkivave në Tiranë. E para, nuk ka dokumente të fondit të tij në arkivat e institucioneve kërkimore, dëshmi tjetër kjo se koleksioni i dorëshkrimeve të Lorecchio-s gjendej në to kryesisht për t'u ruajtur, jo për t'u këshilluar. E dyta, pikërisht atje ku gjendej si trashëgimi në ruajtje, larg duarve të kërkuesve, në AQSH, fondi i Lorecchio-s të mahnit me larminë dhe vëllimin e tij. Patëm mundësinë të shfletojmë e të sigurojmë kopje të nevojshme edhe për kolegët tanë arbëreshë vetëm nga 12 dosje, që përmbajnë mijëra fletë dokumente: shtypshkrime, daktiloshkrime, dorëshkrime; vepra të botuara dhe boca të tyre; gazetën "La Nazione Albanese" dhe kopyra gazetash të tjera; ditar politik, poezi dhe rrëfime autografe, thirrje, fletë-volante, artikuj, nota proteste, nota diplomatike, lutje, letërkëmbim, portrete shqiptarësh, arbëreshësh e italianesh të shquar, skeda me shpjegime për çështje shqiptare historike dhe kulturologjike, shkrime sensibilizuese në gjuhët e mëdha të diplomacisë, komunikime me kanceleri e institucione, projekt-rezoluta, memorandume, ultimatumë, këngë popullore arbëreshe e shqiptare, krijimtari të poetëve të kohës, si dhe një himn kombëtar shqiptar.

Lorecchio, në tërë veprën e vet, i qendroi besnik sloganit që zgjodhi që në krye: "Skyperia avanti!". Ai e dinte mirë se çfarë ishte ideale, por njëherësh kishte formimin e thellë të kuptonte se zgjidhja e çështjeve gjeopolitike, vendimmarrjet për themelimin shtetesh të rinj, duhej të kuptoheshin e të përgatiteshin për realizim në kuadër të së mundshmes. Të shumtë kanë qenë ata atdhetarë që pas njohjes së pavarësisë, menduan dhe thanë: "Shqipëria u bë, por unë e doja ndryshe". Lorecchio e dinte mirë se ç'ishte determinizmi gjeohistorik dhe nuk kishte arsye të zhgënjehej. Referuar regjistrin të studiuesve që i kanë këshilluar dokumentet e tij në AQSH numri i tyre edhe sot është tejet i kufizuar. Por sa më shumë të njihet ky koleksion i mendimit dhe veprimit politik e diplomatik të tij, aq më shumë do të kuptohet se sa shumë advokoi Lorecchio për çështjen shqiptare, sa shumë e donte vendin e të parëve me një pavarësi të mbrojtur. Veprimi inercial i kufizimeve të së shkuarës do të marrë fund vetëm duke u takuar drejtpërdrejt me mendimin e tij burimor.

<https://we.tl/t-P8O52TJKQQ>

<https://www.cosenzapost.it/poste-italiane-un-annullo.../>

<https://www.lacnews24.it/.../minoranze-etniche-all.../>

---

# **Mbi ecurinë e Enciklopedisë Shqiptare**



---

## Seminar informues dhe instruktiv i të gjitha redaksive të "Enciklopedisë shqiptare" në sallën "Aleks Buda", me pjesëmarrjen e kryeredaktorit të "Enciklopedisë" akad. Skënder Gjinushit

Sot, më 30 prill 2024, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua një workshop me gjithë redaksitë e "Enciklopedisë shqiptare" për Tiranën.

Fjalën e hapjes e mbajti kryeredaktori i "Enciklopedisë shqiptare" dhe kryetar i ASHSH, akad. Skënder Gjinushi, i cili në fjalën e tij theksoi rëndësinë e këtij projekti madhor albanologjik dhe sfidat që mbart me vete.



Prezantojnë materialet e përgatitura akad. Shaban Sinani, drejtues i redaksisë vendore të Shqipërisë dhe sekretar shkencor i ASHSH; prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi, drejtor i QBEA dhe dr. Arian Leka, shef i sektorit të enciklopedisë në QBEA.





## **Bashkëbisedim informues dhe udhëzues i drejtuesve dhe anëtarëve të redaksive të fushave të "Enciklopedisë shqiptare" me redaksinë vendore**

- "Enciklopedia shqiptare" nuk është një bashkim i fjalorëve ekzistues: midis tyre ka dallime tipologjike e strukturore, tha kryeredaktori Gjinushi. Përcaktimi i pragjeve të njëjtë për pranimin e njësive enciklopedike si në Shqipëri, ashtu dhe në Kosovë; si dhe realizimi i shembujve ilustrues nga çdo redaksi fushe, sipas modeleve të propozuara e miratuara nga redaksia qendrore, janë detyra parësore të tyre

Takimi u hap me fjalën e kryeredaktorit të "Enciklopedisë shqiptare" akad. Skënder Gjinushi, kryetar i Akademisë së Shkencave. Në vijim akad. Shaban Sinani njohu të pranishmit me kalendarin e veprimtarisë së redaksive të të tre niveleve gjatë vitit 2024, miratuar në mbledhjen e fundme të redaksisë qendrore, duke përfshirë kalendarin e takimeve të redaksive sipas grup-fushave, në Tiranë e në Prishtinë. Gjithashtu ai paraqiti një relacion për ecurinë e punëve në këto redaksi dhe për disa probleme që kërkojnë zgjidhje praktike.

Prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi, drejtor i Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike (QBEA), informoi për krijimin e një faqeje të dedikuar për "Enciklopedinë shqiptare"; si dhe për mundësitë që tashmë ofrohen për shpejtimin e procesit të punës për realizimin e saj prej gjuhësisë kompjuterike dhe aplikimeve të saj.



"Ecuria e fazës së parë për "Enciklopedinë shqiptare": çështje të strukturës dhe përmbajtjes" ishte titulli i referimit të dr. Arian Lekës, përgjegjës i sektorit të enciklopedisë

të QBEA.



Diskutuan për këto problematika akad. Ilirjan Malollari, akad. Marenglen Verli, akad. Jorgo Kaçani dhe prof. Aziz Pollozhani (drejtues i redaksisë së posaçme për trashëgiminë shqiptare në Maqedoninë e Veriut).

Në fjalën e tij kryeredaktori Gjinushi theksoi rëndësinë e "Enciklopedisë shqiptare" si projekt madhor në albanologji, për realizimin e së cilës do të bashkëpunojnë qindra studiues të të gjitha fushave. "Enciklopedia shqiptare", tha ai, nuk është një bashkim i dy fjalorëve enciklopedikë ekzistues, me ca shtesa apo përzgjedhje. Në koncept "ESH" dallohet prej fjalorëve, dhe kjo shprehet në strukturë e në raporte. Dallimi midis fjalorëve dhe "Enciklopedisë" duhet të jetë i qartë dhe të zbatohet.

Në vijim keyeredaktori Gjinushi theksoi se problem i rëndësishëm për t'u zgjidhur nga redaksitë e fushave dhe redaksitë vendore është përcaktimi e dakordësimi për pragje të njëjtë pranimit në "ESH" si në Shqipëri, ashtu dhe në Kosovë e kudo. Për këtë duhet të ndihmojë edhe sektori i enciklopedisë i QBEA, që tashmë është jo vetëm njësi për të koordinuar, por edhe me pjesën e vet kërkimore-shkencore, forcuar prej fillimit të këtij viti.

Kërkohen zgjidhje praktike, tha ai në vijim, sepse jemi në fazë pune. Redaksitë e fushave duhet të realizojnë shembuj ilustrues për të gjitha kategoritë që përmban fjalësi: personalitete, ngjarje, dukuri, terma të përgjithshëm; si dhe për të gjitha madhësitë apo formatet e artikujve.

Redaksitë e ngritura sipas disiplinave janë ndarë në gjashtë grup-fusha (njësoj dhe në Kosovë) dhe takimet e para të tyre për të zgjidhur problemet e diskutueshme do të bëhen në periudhën 10-25 maj 2024. Në fund të majit është parashikuar takimi i dy redaksive vendore dhe në javën e parë të korrikut do të mblidhet redaksia qendrore. Të

gjitha takimet e 6-mujorit të parë do të bëhen në Tiranë, kurse takimet e dyta në Prishtinë, në 6-mujorin e dytë.



Në fjalën e tij prof. asoc. dr. Kasmi ndër të tjera theksoi se Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike ka marrë masat për të digjitalizuar procesin e hartimit të “Enciklopedisë shqiptare” duke mbuluar çdo fazë deri në publikimin online të veprës që do të jetë e hapur për të gjithë lexuesit anembanë botës. Dr. Brikena Liko, specialiste e gjuhësisë kompjuterike, ka përgatitur, mirëmban dhe pasuron vazhdimisht një platformë të posaçme kushtuar të gjithë nevojave të autorëve dhe redaktorëve të “Enciklopedisë” me burime të ndryshme për autorët. Faqja e autorëve është në gjuhën shqipe dhe është ndërtuar mbi parimin e lehtësimit të punës hartuese dhe thjeshtësisë në përdorim.

Bazuar në fazat e punës ajo është e strukturuar në 3 pjesë:

I. Shkëmbimi dhe ruajtja e dokumenteve / imazheve ku mundësohet ngarkimi dhe përpunimi i materialeve të redaksive përkatëse, konsultimi me materiale të redaksive të tjera dhe me burime të përgjithshme që do të shërbejnë si një bibliotekë portative për autorët.

II. Puna hartuese. Këtu gjenden mjete të tjera të nevojshme që u shërbejnë autorëve për shkrimin e artikujve të rinj në bazën e të dhënave, redaktimin e artikujve ekzistues dhe konsultimin e artikujve të tjerë. Një tjetër mjet pune i rëndësishëm në këtë fazë është funksioni për kontrollimin automatik të referencave të kryqëzuara, lidhjen me terma a fjalë kyçe të pranishme në artikuj të tjerë dhe sugjerimin për shtimin e tyre, që do t’u kursejë kohë autorëve dhe do të sigurojë ndërlidhjen e artikujve të enciklopedisë me njëri-

---

tjetrin sipas përmbajtjes.

III. Faza e tretë është pjesa e publikimit online të veprës. Është përgatitur një ndërfaqe për lexuesin që e bën Enciklopedinë të thjeshtë në kërkim, bën sugjerim të artikujve të ngjashëm, grupim sipas fushave, lehtësi për citime të gatshme, shpërndarje, printim etj. Kjo faqe do të jetë në shqip dhe anglisht, ashtu si dhe artikujt e “Enciklopedisë”.

Dokumentimi i punës është një tjetër tipar i platformës e cila krijon gjurmë për çdo ndryshim dhe funksionon si një vulë digjitale për punët e dorëzuara. Materialet janë të ruajtura në servera të sigurtë, faqja është brenda të gjithë parametrave të sigurisë dhe krijohen kopje ruajtjeje përditë (backup), gjë që u krijon autorëve besimin se puna e tyre është e sigurt dhe e rikthyeshme.

Në seancën e dytë redaksitë u mblodhën sipas përkatësisë në grup-fusha.

## Sektori i enciklopedisë i QBAE për ecurinë e punës në redaksitë e fushave në fazën e përgatitjes dhe dorëzimit të fjalësit paraprak dhe për disa probleme drejt fjalësit themelor përfundimtar

- Nga relacioni i përgjegjësit të këtij sektori dr. Arian Leka sot në takim informues dhe udhëzues me redaksitë e fushave



Me fjalësin paraprak për "Enciklopedinë shqiptare" është përmbyllur faza e parë e një veprimtarie që, referuar prurjeve, dëshmoi nivel kompetence shkencore dhe kapacitet organizativ në sigurimin e bazës së një rrjeti të gjerë referencash. Në ndihmë të këtij hapi të parë, por të rëndësishëm për projektin enciklopedik, redaksitë e të tre niveleve prodhuan dokumente normative - marrëveshje, protokolle, udhëzues e rregullore - dhe vunë në lëvizje praktika pune, që thekojnë sfidën e projektit për tejkalimin, jo thjesht formal të sasisë së prurjeve ndaj "Fjalorit enciklopedik" të mëparshëm dhe transformimin e zërave të tij në njësi enciklopedike të formatit "artikuj", por mbulimin gjithëpërfshirës të asaj që përfaqëson Shqipërinë, shqiptarët dhe shqiptaren si ngjarje, personalitete, fenomene, dukuri e trashëgimi, për të maksimalizuar vlerën e ESH.

Duke e përfytyruar "Enciklopedinë shqiptare" si një sistem të hapur ndër-referencial, hartuesit e fjalësit të çdo fushe përfshinë në të këndvështrimeve shkencore



---

mbi parardhësin-përfaqësues dhe dijen teorike të hapur ndaj botës shqiptare bashkëkohore.

Në formën që na paraqiten sot, prurjet paraprake të fjalësit themelor sjellin mbulimin sistematik më të plotë nga gjithë sa ka ndodhur si tipologji shkrimi mbi lëndën enciklopedike shqiptare. Vërejmë se me këtë fjalës sigurohet baza nistore e një rrjeti referimesh të hapura në përdorim, me të dhëna afatgjata në qëndrueshmërinë e dijeve të përditësuara, të cilat, falë formatit të enciklopedisë dinamike, do të ofrojnë përmirësim të vazhdueshëm, hyrje të lehta në përdorim, pluralizim të mendimit shkencor dhe demokratizim të dijes.

Që nga nisja e veprimtarisë së redaksive të fushave u deshën muaj për ta pasur në duar këtë qelizë enciklopedike dhe sot mund të vëzhgojmë se një nga tiparet e fjalësit të ESH është shpërndarja e ekspertizës drejt një numri të madh kontributorësh, duke përfshirë në proces pothuajse të gjithë antëtarët e redaksive.

Në këtë fazë të procesit, sektori i enciklopedisë shqiptare ka ofruar konsulencë mbi çështje të ekspertizës së përpunimit mes fjalësit dhe udhëzuesit; komunikim e koordinim me redaksitë; ka administruar hap pas hapi gjendjen dhe ka analizuar në mënyrë korrekte prurjet. Procesi është vendosur në kufi kronologjikë dhe terma përmbajtësorë, jo thjesht numerikë, metodologjikë që i ka vështruar prurjet si zhvillime, me përmirësime të vazhdueshme, plotësim të mungesave dhe zgjidhje të problematikave, që konsideron çdo prurje si përvojë pasuruese.

Nga shqyrtimet e prurjeve, shprehur në shifra, konstatatojmë se, nga gjithësej 27 redaksi të fushave në Shqipëri dhe 1 redaksi e posaçme në Maqedoninë e Veriut, pra gjithësej 28 redaksi, fjalësit paraprakë të dorëzuar pranë sektorit të enciklopedisë janë nga 21 redaksi.

Si proces dukumentues, mes redaksive, 15 e kanë dorëzuar fjalësin si në formën elektronike, ashtu edhe në formën fizike të nënshkruar, ndërsa gjashtë redaksi e kanë dorëzuar fjalësin vetëm në formën digjitale, përmes përcjelljes elektronike. Gjashtë redaksi të tjera nuk kanë arritur ta dorëzojnë në kohë fjalësin paraprak, por komunikimi me këto redaksi ka qenë i vazhdueshëm, duke prodhuar reagime të natyrave të ndryshme, mes të cilave edhe kërkesa për një afat të dytë dorëzimi, për shkak të volumeve apo punës në proces përfundimi.

Shprehur në përqindje, do të kishim këtë panoramë: - fjalës i dorëzuar në formë fizike apo elektronike 75 %; redaksi me fjalës të padorëzuar ende, por me komunikim dhe pa kërkesë për shtyrje afati: 21 %; redaksi që nuk e kanë dorëzuar fjalësin ende dhe nuk kanë komunikuar afatet: 4 % ose një redaksi.

Prurjet tërësore të fjalësit të depozituar përmbajnë afërsisht 7500 kontribute të natyrave të ndryshme, ardhur si referenca prej 106 anëtarëve të redaksive të fushave përkatëse, nga 111 anëtarë gjithësej.

---

Vërejmë gjithashtu se, në tërësinë e emërtesave të mbërritura prej redaksive të fushave, ka kontribute zërash të trashëguar nga "Fjalori enciklopedik", që, në këtë formë paraprake të fjalësit, propozohen si njësi enciklopedike të riformatuara tematikisht.

Janë administruar jo pak propozime edhe për artikuj të rinj, të cilët, në pjesën më të madhe përfaqësojnë koncepte apo aspekte teorike. Po kështu vërehet zgjerim edhe në artikujt për ngjarje, dukuri, figura e personalitete, cilësuar si hyrje të reja, që, për shkak të formave të ndryshme të kufizimeve, nuk ishin pjesë e botimeve të mëparshme enciklopedike.

Përfundimi i këtij klasifikimi në bazë artikujsh apo përcaktimi i madhësisë së artikullit, ndonëse janë objekt pune për fazën e ardhshme, në jo pak redaksi është kryer paraprakisht, me shënimet "artikull i vogël" apo "artikull i madh", ose shprehur në faqe shkrimi. Janë rreth 50 % e redaksive që e kanë kryer këtë plotësim, duke lehtësuar punën për fazat e ardhshme. Shumë redaksi kanë përfshirë në listat e tyre edhe propozimet për hartuesit-autorë të artikujve, duke e plotësuar materialin me komente apo me autorin e mëparshëm apo me tematikat orientuese të përmbajtjes, ku rasti më përfaqësues gjendet në prurjet e redaksisë së posaçme të Maqedonisë së Veriut.

Po kështu, të nevojshme për fazën e re drejt së cilës po shkon përpunimi i fjalësit, janë edhe shprehjet e raporteve në përqindje mes rendit të artikujve pasi, në disa prurje vërehet mungesa e artikujve-personalitete, në disa të tjerë mangësi në zëra të rinj etj. Më shumë mund të kontribuohet në pasurimin e kritereve të brendshme të redaksive të fushave për rastet e veçanta, siç mund të intesifikohet bashkëpunimi ndër-redaksional, koordinimi me redaksitë në Kosovë për artikujt e përbashkët apo zgjedhja e përkatësisë për personalitetet me kontribute në më shumë se sa një fushë të dijes.

Vërejmë gjithashtu se, përballë zgjerimit të informacionit, jo të gjitha redaksitë janë njëloj të ekspozuara, pasi në disa prej tyre prurjet dhe qasjet janë më të shumta në numër, siç dhe ndjeshmëritë e debatet janë më të mëdha se në redaksitë e tjera. Kjo ka bërë që procesi të zhvillohet me më shumë se sa një ritëm, sidomos në fazën e përzgjedhjes së artikujve dhe dorëzimi të materialit në kohë.

Përsa i përket anës formale: standardizimi i fjalësit paraqet si një nga dukuritë më heterogjene, si në grafi të shkrimit ashtu edhe të alfabetizimit e të numerizimit. Është e kuptueshme se, përballë aspektit përmbajtësor dhe cilësisë në përzgjedhje, ku është shprehur vëmendja më e madhe e procesit të mbledhjes, seleksionimit paraprak dhe analizimit të këtij fjalësi, aspektet e formatit të tekstit janë të nënrenditura, por jo pa rëndësi. Kjo çështje shtrohet pasi vërejmë se regjistrimet e sjella nga redaksitë e fushave përkatëse kanë eksploruar teknika të ndryshme kumulative dhe qëmtuese, që kanë prodhuar rezultate të ndryshme.

Për të mbetur te formalizimi, shprehemi se kriteri i numerizimit progresiv është zbatuar në të gjithë rastet, përveç ndonjë përjashtimi, siç është respektuar edhe kriteri i

---

alfabetizimit, që nuk vijnë të unifikuar sipas sipas një skeme të vetme. Fjalës të panumerizuar apo të paalfabetizuar janë aq pak, sa mund të quhen përjashtimorë, por rastet ku njësitë enciklopedike shprehen vetëm me shkronja kapitale në fjalës janë jo të rralla. Ndërkohë, një tjetër kategori e shmangjes nga standardi përfaqësohet nga fjalësit me njësi të shënuara në mënyrë të përzier në teknikë shkrimi.

Për fazën në të cilën ndodhemi luhatjet ndaj standardit janë të mirëkuptuara, por kërkesa për unifikim të grafisë, hierarkisë në shkrim dhe në përmbajtje do i paraprinte, veç të tjerash, përpunimit më efikas të lëndës për sistemin e-reference. Ajo çka propozohet lidhur me standardet është përgatitja dhe rishikimi nga sektori i enciklopedisë i modelve të njësuar, përshtatur sipas kërkesave të reja, shpërndarja e këtij modelimi drejt redaksive dhe këshillimi i vazhdueshëm me redaksitë e fushave dhe redaksinë vendore mbi procesin dhe aspekte të tjera.

Duke u shprehur mirënjohjen anëtarëve dhe përgjegjësve të redaksive, për ekspertizën dhe bashkëpunimin e tyre në krijimin e skicës së parë për arkitekturën e projektit "Enciklopedisë shqiptare", përgëzime u takojnë edhe punonjëseve kërkimore-shkencore të sektorit të enciklopedisë.

## **“Enciklopedia shqiptare” do të realizohet duke zbatuar një disiplinë të vetme shkencore në përzgjedhje**

- Redaksitë e ngritura sipas disiplinave (fushave), në fazën e përzgjedhjes, duhet të propozojnë zgjidhje praktike për kufijtë midis lëndës enciklopedike dhe trashëgimive të tjera, që nuk përfaqësojnë vlera të vetëmjaftueshme për të zënë vend në fjalës; kufij për t’u zbatuar në mënyrë të njëjtë kudo që gjendet kjo lëndë, në gjithë hapësirën historike shqiptare

- Hierarkia midis njësive enciklopedike vendoset duke filluar me të padiskutueshmit, vijuar me të krahasueshmit dhe përmbyllur me të diskutueshmit, si për personat, ashtu edhe për emërtimet e përgjithshme

- “Enciklopedia shqiptare” ka nevojë për përpjesëtime që i përgjigjen natyrës së një enciklopedie si lloj botimi për raportet midis personaliteteve, përveçimeve të tjera, ngjarjeve historike e kulturore, zhvillimeve në trashëgimi e identitet dhe terminologjisë së përgjithshme të njësuar

- Nga relacioni i drejtuesit të redaksisë vendore akad. Shaban Sinani



Me dorëzimin e fjalësit paraprak nga shumica e redaksive të ngritura mbi bazën e

---

disiplinave shkencore (të njohura si “redaksi të fushës”) është bërë e mundur të shihen prirjet dhe të vlerësohen arritjet dhe problemet.

1. Mbështetur në bazën e krijuar të të dhënave rezulton se mbledhja dhe pjesërisht përzgjedhja e lëndës enciklopedike është bërë kryesisht nga fjalësi i “Fjalorit enciklopedik shqiptar” dhe “Fjalorit enciklopedik të Kosovës”. Më pak ose aspak janë këshilluar burimet e dyta: enciklopeditë tematike e krahinore, leksikonët e profesioneve dhe fjalorët terminologjikë.

2. Redaksitë e fushës kanë mundur të ruajnë sensin e masës; nuk vërehet prirje për të përfshirë në fjalës në mënyrë shterruese gjithë inventarin e trashëgimisë shqiptare, me një përjashtim të vetëm.

3. Grupimi i redaksive sipas fqinjësisë së disiplinave dhe caktimi i një anëtari të redaksisë vendore si koordinues për redaksitë e grup-fushave shërbeu për të lehtësuar e mundësuar ndërkomunikimin mes tyre, për të shmangur dyfishimet, për të adresuar njësitë enciklopedike në kufijtë mes tyre.

4. Me punën e kujdesshme të specialistes së gjuhësisë kompjuterike dr. Brikena Liko është konceptuar formatimi digjital i artikullit enciklopedik, me rubrikat dhe disiplinën e vet të njësuar, “shtrat Prokrusti” që është i domosdoshëm për të pasur një disiplinë të vetme pune. Një “template” për artikujt sipas madhësive të tyre u ofrohet të gjithëve atyre që dëshirojnë të punojnë drejtpërsëdrejti në program, në format të numerizuar. Në mjediset e QBEA tashmë ka mundësi që redaktorët të mblidhen, të diskutojnë e të punojnë bashkërisht ose më vete.

5. Në përputhje me kalendarin e miratuar nga redaksia qendrore ka filluar puna për përzgjedhjen dhe stabilizimin e fjalësit themelor, që brenda dy muajsh duhet të dorëzohet si fjalës përfundimtar. Prirja është për të respektuar parimet themelore të enciklopedizimit: përfaqësimin, objektivitetin dhe standardet e njësuar. Në enciklopedi nuk bëhen shpikje e zbulime, por shërbehet informacion i verifikuar dhe vlerësim i gjithëpranuar në përputhje me gjendjen e sotme të dijes.

6. Kalendarin e punës për këtë vit është miratuar nga redaksia qendrore dhe përmban këto objektiva: deri në fund të muajit qershor duhet të përfundojë fjalësi i stabilizuar, me përzgjedhje kritike të asaj që është evidentuar, duke hequr të tepërtën e duke rivlerësuar edhe një herë burimet, sidomos ato dytësore; deri në fund të muajit shtator duhet të përfundojë vendosja në hierarki e njësive enciklopedike sipas meritës, gjegjësisht sipas shkallëzimit të artikujve; deri në fund të dhjetorit duhet të jenë lidhur kontratat me autorët realizues të artikujve sipas kriterit të kompetencës.

Nga problemet që meritojnë vëmendje veçojmë:

1. Ka një prirje për t’u mjaftuar në mbledhje e përzgjedhje me fjalësin e dy fjalorëve enciklopedikë, FESH e FEK, që, siç dihet, nuk kanë natyrën e enciklopedisë dhe kanë pasur kufizimet e tyre të vërejtura nga shqyrtimet kritike, qoftë për shkak të shkallës së



---

njohjes, qoftë për shkak të pasveprimit inercial të kufizimeve ideologjike dhe fetare të mëparshme.

2. Ishte e pritshme një presion për të shtuar në listat e fjalëve-referencë sa më shumë personalitete. Rezervimi ndaj kësaj pjese të trashëgimisë është vërejtur vetëm në disa redaksi (mjekësia, inxhinieritë dhe teknologjitë). Shpërpjesëtimi që vërehet ka lidhje edhe me traditën e botimeve enciklopedike të deritashme (fjalorët enciklopedikë nga vetë natyra e tyre, u bëjnë shumë vend personaliteteve, ndërsa për terminologjinë e përgjithshme nuk gjejnë vend). Enciklopedia ka një rregullim tjetër midis përbërëseve: krahas personaliteteve janë ngjarjet, zhvillimet dhe termat. Kjo strukturë e rrudh detyrimisht vendin e mëparshëm të personaliteteve. Mendohet se personalitetet nuk mund të zënë më shumë se një të tretën e së tërës, kështu që duhen shfrytëzuar dy mundësi: artikujt përmbledhës dhe përfshirja e një pjese të tyre tek termi i përgjithshëm (klinikat dhe shërbimet për mjekët, për shembull).

3. Një prirje teprimi vërehet edhe me përveçimet në përgjithësi, jo vetëm me individët protagonistë të zhvillimeve: emra veprash industriale, subjektsh shoqërore, institucionesh e organizatash, agjencish, shkollash, rrugësh e sheshesh. Kjo pjesë e njësisë të propozuara kërkon rreptësi përzgjedhjeje jo vetëm për të zbatuar një kriter të pranuar nga të gjithë, por edhe për detyrën që kemi për ta mbrojtur “Enciklopedinë shqiptare” nga çdo prekje prej reklamës dhe komercializmit, që do ta komprometonin rëndë përmbajtjen e saj.

4. Në këtë fazë e domosdoshme është që redaksitë e specialitetit (fushës, disiplinës), në Shqipëri e në Kosovë, të ndërkomunikojnë për të përcaktuar një prag të njëjtë pranimit për çdo kategori (personalitete, ngjarje, dukuri, zhvillime) dhe të njëjtin shkallëzim hierarkik. Ky problem nuk zgjidhet duke shtuar parime e kritere, shkencore a deklarative, por duke identifikuar e duke u marrë vesh se cilët janë të barabartët, të njëjtët, të ngjashmit, të përafërtët në gjithë hapësirën historike shqiptare: në Kosovë e në Shqipëri. Redaksitë e gjeologjisë dhe minierave për shembull mund të merren vesh që miniera e Trepçës dhe ajo e Bulqizës qendrojnë në të njëjtin nivel; ato të gjeografisë fizike mund të pranojnë që shpella e Lepenicës dhe ajo e Gadimes janë të dyja për nivelin e artikullit të vogël; kështu edhe për redaksitë e tjera. Enciklopedia është një dije relative dhe nuk bën dot pa krahasimin. Kjo do të përjashtonte standardet e dyfishta apo të shumëfishta, subjektivizmat, ndjeshmëritë krahinore etj.

5. Caktimi i pragjeve është vetëm fillimi i vënies në hierarki të lëndës enciklopedike, që është kusht për një disiplinë të vetme shkencore. Problemi zgjidhet duke krijuar çdo redaksi modele për ilustrim: modele për persona, për subjekte, për emërtime të tjera të përveçme, për ngjarje e dukuri; modele për secilën shkallë hierarkie të tyre referuar shkallëzimit të artikujve. Për këtë një mbështetje të vlerësueshme përbëjnë shembujt e miratuar nga redaksia qendrore. Për një hierarki sa më objektive

---

metodologjikisht do të ishte e këshillueshme që puna të nisej me të padiskutueshmit, ata që janë vetëshquar në histori e kontribute, njësitë që u referohen trashëgimive kombëtare; për të vijuar me të krahasueshmit (kjo edhe për një vendimmarrje të drejtë në caktimin e vendit të tyre sipas madhësisë së artikullit) dhe për t'u ndalur më gjatë tek të diskutueshmit (zgjidhje mund të jetë pranimi për artikuj të vegjël, në artikuj përmbledhës ose tërthorazi në artikuj të përgjithshëm).

6. Është kapërcyer tashmë debati nëse në ESH do të ketë edhe terma të përgjithshëm. Në kushtet e të jetuarit në një botë të hapur e në ndërkomunikim termat e përgjithshëm mund të zënë deri 15 për qind e më shumë; kjo do të vendoset pas diskutimeve shkencore në redaksitë e fushës. Në kriter, termat që kanë dalë jashtë disiplinës së ngushtë dhe u nevojiten të gjithëve, duhet të kenë vend në ESH. Në fakt, duke realizuar projektin e “Enciklopedisë shqiptare” njëherësh po kodifikojmë stilin ligjërimit enciklopedik dhe po plotësojmë edhe një nga kërkesat e paketës së njohur “*acquis communautaire*”, që kërkon një terminologji të njësuar me përdorim mbarëshqiptar.

7. Redaksia e posaçme e ngritur në Maqedoninë e Veriut e ka bërë tashmë përzgjedhjen (nga rreth 1100 njësi janë propozuar rreth 400), duke qenë një hap përpara redaksive të tjera. Hap i parë për integrimin e saj në rrjetin e redaksive është njohja e redaksive të fushave me fjalësin e propozuar dhe zgjedhja e lëndës përkatëse nga secila prej tyre. Më tej do të përcaktohet se cilët janë artikujt që redaksia e ngritur në MV mund t'i realizojë vetë. Këshillimet me redaksinë vendore në Prishtinë janë të parashikuara.

## Drejt stabilizimit të fjalësit të "Enciklopedisë shqiptare"

- Takim pune i redaksive të grup-fushave të albanologjisë të ngritura gjegjësisht pranë ASHSH dhe ASHAK



Sipas kalendarit të miratuar nga redaksia qendrore dhe dy redaksitë vendore të "Enciklopedisë shqiptare", sot nisën takimet midis redaksive të ngritura sipas kufijve të disiplinave me njëra-tjetrën dhe në vijim një takim i dytë si grupim fushave.

Takimet u zhvilluan në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Siç është rënë dakord në redaksinë qendrore, të gjitha mbledhjet dhe takimet e redaksive, të të tre niveleve, për gjashtëmujorin e parë, do të zhvillohen në Tiranë. Në pjesën e dytë të vitit në Kosovë.

Në seancën e parë pati takime e diskutime të redaksive të së njëjtës fushë apo të përafërta: arkeologjia (lashtësia), gjuhësia, letërsia, trashëgimi e identitet dhe artet skenike e pamore. Në këto takime u shkëmbye informacion për fjalësin paraprak të propozuar prej tyre, për përsëritjet e mundshme dhe shmangien e tyre, për zbatimin e kriterëve praktike në përzgjedhjen e parë dhe për proceset e detyrat në vijim.

Drejtuesit e redaksive të fushave në Tiranë (akad. asoc. Gëzim Hoxha, akad. Vasil S. Tole, prof. dr. Anila Omari, prof. asoc. dr. Evalda Paci dhe prof. dr. Josif Papagjoni) dhe drejtuesit e redaksive gjegjëse në Prishtinë bashkëpunuan për këtë problematikë. Koordinimi u bë nga dr. Arian Leka, përgjegjës i sektorit të enciklopedisë në QBEA. Të pranishëm anëtarët e redaksisë vendore dhe nga pjesa e Tiranës e redaksisë qendrore sipas ndarjes së detyrave e përgjegjësisë dhe të ngarkuar me detyrën e ndërveprimit mes tyre.



Në seancën e dytë, që u zhvillua në sallën "Akademikët", redaksitë e grupfushës së albanologjisë patën një takim të përbashkët. Në këtë takim nga redaksia vendore ishte i pranishëm akad. Shaban Sinani. Takimi pati si qëllim kryesor:

1. Njohjen me detajimet e kalendarit të miratuar nga redaksia vendore për periudhën maj-qershor 2024;

2. Njohjen me detyrat që duhet të zgjidhen në takimet e redaksive të grupfushave sipas këtij kalendarit për periudhën 10 maj - 25 maj 2024;

3. Gjatë kësaj periudhe nga redaksitë duhet të nxirren e të njoftohen të dhënat për numrin tërësor të fjalësit në gjendjen e tanishme, për peshën (vendin) që zë fjalësi i çdo redaksie në kuadër të së tërës. Deri në fund të qershorit redaksitë e së njëjtës fushë duhet të kenë arritur në stabilizimin e një fjalësi të përbashkët për gjithë hapësirën shqiptare. Për këtë bashkërisht duhet të hiqen nga fjalësi njësitë e përsëritura dhe duhet bërë përzgjedhja për një përfaqësim relativ sa më objektiv të çdo fushe;

4. Fjalësi i përgatitur nga redaksia e posaçme e trashëgimisë shqiptare në Maqedoninë e Veriut duhet të njihet nga redaksitë e fushave dhe të bëhet pjesë e listës së tyre sipas përkatësisë;

5. Redaksitë e grupfushave në këtë periudhë zgjidhin probleme të diskutueshme për artikuj në kufij të njëra-tjetrës, duke respektuar përparësinë e fushës dominante të veprimtarisë;

6. Për një përzgjedhje me të vërtetë shkencore është e domosdoshme të zgjidhet problemi i pragjeve-kufij të pranimit e promovimit në ESH, duke barasvlerësuar në nivel të njëjtët (të barabartët) dhe duke krahasuar e përafëruar të ngjashmit, duke vendosur vijat e ndarjes me lëndën paraenciklopedike.

7. Redaksitë e fushave dhe të grupfushave gjatë kësaj periudhe formulojnë e propozojnë kritere ndihmëse e plotësuese dhe hartojnë artikuj ilustrues (shembuj për të

---

gjitha madhësitë e tyre, duke ndjekur strukturën e artikujve të përgatitur nga redaksia qendrore).



Për këto çështje diskutuan Anila Omari, Valter Memisha, Arian Leka, Gëzim Hoxha etj.



## Takim i redaksive të fushës së arkeologjisë dhe historisë së lashtë të ngritura për "Enciklopedinë shqiptare" në Shqipëri dhe në Kosovë

Veç anëtarëve të dy redaksive, morën pjesë edhe anëtarë të caktuar për koordinim nga redaksia vendore dhe qendrore: akad. Adem Bunguri dhe akad. Marenglen Verli.



Nga redaksitë e fushave të ngritura në Tiranë ishin të pranishëm akad. asoc. Gëzim Hoxha, prof. dr. Neritan Ceka, dr. Albana Meta, dr. Rovena Kurti, dr. Elio Hobdari. Nga redaksitë e fushave Prishtinë ishin të pranishëm Arianit Buqinica, Exhlale Dobruna-Saliu dhe Premtim Alaj.

Në mbledhjen e sotme u diskutua për punën e bërë deri më tani prej dy redaksive të fushës së arkeologjisë dhe historisë së lashtë.

Të dyja redaksitë ballafaquan fjalësit respektivë të hartuar deri më tani, duke vijuar me një analizë të punës së bërë. Gjithashtu diskutimet u ndalën dhe mbi problemet teknike të hasura gjatë procesit të hartimit të fjalësit, me mundësitë e paralelizmave me fushat e tjera, si dhe aspektet e tjera të lidhura me punën.

Anëtarët e redaksive ndanë mendime dhe shqetësime në lidhje me ndarjen e zërave, standardet e përfshirjes dhe kritere të tjera teknike.

Mes të tjerave u diskutua për rëndësinë e emërimit të vendbanimeve, një prioritet në hartimin e fjalësit.

Në veçanti u bë fjalë për nevojën për të adresuar problemet teknike që mund të

---

shkaktojnë pengesa në realizimin e punës, si dhe për të rritur bashkëpunimin dhe koordinimin midis dy redaksive.

Mbledhja u përfundua me një plan veprimi të përcaktuar për të vazhduar punën në mënyrë efektive dhe për të adresuar çështjet e ridiskutuara gjatë takimit.



## U zhvillua takimi i redaksive të trashëgimisë kulturore dhe identitetit shqiptar të ngritura në Shqipëri e në Kosovë për "Enciklopedinë shqiptare"

Sot më 10 maj 2024, në zyrën e zëvendëskryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil S. Tole u mbajt takimi i redaksive të trashëgimisë kulturore dhe identitetit shqiptar.



Takimin e drejtoi zëvendëskryetari i ASHSH akad. Vasil S. Tole.

Mori pjesë nga redaksia e ngritur në Tiranë prof. dr. Afërdita Onuzi, ndërsa nga redaksitë e fushave të ngritura në Kosovë morën pjesë Tahir Latifi, Zanita Halimi, Rozafa Berisha, Arbnora Dushi etj.

Pas analizës së punës së bërë u ballafaquan fjalësit respektivë të hartuar deri më tani dhe diskutimet u ndalën mbi problemet teknike të hasura gjatë procesit të hartimit të fjalësit, me mundësitë e paralelizmave me fushat e tjera, si dhe aspektet e tjera të lidhura me punën.



---

U dhanë mendime në lidhje me ndarjen e zërave, tipologjitë dhe standardet e përfshirjes dhe për kriteret e tjera teknike të fushës që do të përfshihen në "Enciklopedinë shqiptare".





---

## U mbajt takimi i redaksive të arteve skenike, pamore dhe multimediale të ngritura në Shqipëri e në Kosovë për "Enciklopedinë shqiptare"

Sot më 10 maj 2024, në bibliotekën e Akademisë së Shkencave, u mbajt takimi i redaksive të trashëgimisë kulturore dhe identitetit shqiptar.

Takimin e drejtoi prof.dr. Josif Papagjoni.



Nga redaksitë e fushave në Tiranë morën pjesë prof. dr. Ferid Hudhri, prof. dr. Zana Shuteriqi, dr. Alban Tartari, ndërsa nga redaksitë e fushave në Kosovë, morën pjesë Eqrem Basha, Rauf Dhomi, Rezart Galica, Besim Rexhaj, Arjan Krasniqi, Hazir Haziri.

U diskutuan përparësitë e fushave dhe termave të artit, mbështetur në një përzgjedhje të mirëfilltë shkencore; kriteret ndihmëse e plotësuese për hartimin e artikujve ilustrues, zërave, kategorive dhe artikujve që do të vlerësojnë gjinitë e artit, si kinematografia, arti figurativ, piktura e skulptura monumentale, akuareli, artet multimediale etj.





---

U diskutuan kriteret për një histori të plotë e ngjeshur të vlerave që ka krijuar arti shqiptar në shekuj.

Përfshirja në ESH e emrave që kanë kontribuar dhe institucioneve të artit u vlerësua si pjesë përbërëse e artit.



## Dy redaksitë për letërsinë, në Tiranë e në Prishtinë, takohen për fjalësin themelor të "Enciklopedisë shqiptare"

Në sallën "Akademikët" u mbajt takimi i punës mes dy redaksive të fushës së letërsisë, me të pranishëm Evalda Paci, Eldon Gjika, Arian Leka, Nysret Krasniqi, Muhamet Hamiti, Kujtim Shala, Linditë Tahiri-Aliu.



Në këtë takim u fol për procesin e hartimit të fjalësit paraprak nga të dyja redaksitë, duke pasur në vëmendje referimin ndaj modeleve paraprake të vëllimeve enciklopedike në disa gjuhë, por dhe përparësinë e përfshirjes së zërave të veçantë, për të cilët do të punohet "ex novo". U sqaruan nga ana e redaksisë së letërsisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë disa elemente të fjalësit paraprak, në të cilin janë reflektuar autorë, dukuri, rryma, periodikë letrarë e shkencorë mbi studimet letrare shqiptare. U sqaruan gjithashtu emërtime të zërave përgjithësues, si dhe u fol për mënyrën si do të reflektohen zëra autorialë që lidhen me personalitete që kanë kontribute në më tepër se një fushë studimi.

U fol edhe për një përpjesëtim të arsyetuar mes zërash autorialë dhe zërash përgjithësues, si dhe për pasqyrimin e historikut të institucioneve të rëndësishme nëpërmjet këtyre të fundit.

U sqaruan nga anëtarë të redaksisë vendore të ESH Arian Leka kritere që ndihmojnë në një përfshirje më të gjerë, por përherë të ekuilibruar zërash në fjalësin tashmë në rrugë drejt finalizimit, ndërkohë që u vunë në dukje dhe veçanësi në bocat e gjithsecilës redaksi.

Në këtë takim me prani fizike mes dy redaksive, që pason atë të datës 15 mars 2024 të zhvilluar në modalitetin online, dolën në pah aspekte të procesit të punës në rang

---

redaksie, që meritojnë një vëmendje të shtuar në javët në vijim.



## Përfunduan takimet e pesë redaksive të grupfushës së albanologjisë

- Njësimi i fjalësit themelor të "Enciklopedisë shqiptare" - qëllimi kryesor
- Njoftim i Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike



Më 10 maj në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë filluan takimet e mes redaksive të fushave Tiranë-Prishtinë.

Sipas programit, redaksitë e fushave të arkeologjisë dhe ashtësisë; trashëgimisë kulturore dhe identitetit kombëtar; letërsisë; gjuhësisë dhe sriteve skenike, pamore e multimediale, paraqitën punën e deritanishme të redaksive respektive Shqipëri - Kosovë, evidentuan problematikat të ndeshuara gjatë procesit, ballafaquan pëvojat lidhur me artikujt e Fjalësve, duke u përqendruar në njohjen e realiteteve, adresimin e shqetësimeve, periodizimin e punës mbi listën e stabilizuar të fjalësit dhe përcaktuan detyrat e objektivat në vijim.



---

Përveç redaktorëve përgjegjës dhe anëtarëve të redaksive të fushave përkatëse, në takime morën pjesë dhe anëtarë të redaksisë qendrore dhe vendore.

Takime të tjera të redaksive sipas grupfushave të afërta do të zhvillohen gjatë gjithë këtij muaji, duke vijuar me atë të datës 13 maj. Sipas kalendarit, do të takohen në vijim redaksitë e fushave të historisë së Mesjetës, Bizantit, periudhës osmane dhe Rilindjes; historisë së shekullit XX; redaksitë për ngulmimet historike dhe diasporat; të historisë ushtarake; të historisë së Luftës së Dytë Botërore (nga ana ushtarake), si dhe të redaksive për religjionet.



## Progresi në hartimin e "Enciklopedisë shqiptare": nga fjalësi i përbashkët (i njësuar) drejt fjalësit të stabilizuar

- "Enciklopedia shqiptare" në proces vendimmarrjeje për listën e njësive për lëndën e përzgjedhur për t'u promovuar në faqet e saj
- Dita e dytë e takimeve të redaksive të ngritura sipas disiplinave / fushave në Tiranë e në Prishtinë
- Sot bashkëbisedime të redaksive të historisë, ngulimeve historike dhe religjioneve



Të pranishëm, përveç anëtarëve të redaksive të ngritura në Tiranë: nga redaksitë e kësaj grupfushë nga Prishtina studiuesit Muhamet Mala (redaktor përgjegjës), Bedri Muhadri e Luan Tetaj për historinë e Mesjetës, periudhën e Bizantit dhe atë otomane; Frashër Demaj (redaktor përgjegjës) e Gazmend Rizaj për periudhën e Rilindjes Kombëtare; Fehmi Rexhepi (redaktor përgjegjës), Ibrahim Gashi e Memli Krasniqi, për historinë bashkëkohore; Arbër Hadri (redaktor përgjegjës), Sabit Syla e Shkodran Imeraj për luftën çlirimtare në Kosovë; Kosovar Basha (redaktor përgjegjës) e Avni Rudaku për ngulimet historike dhe diasporën; Jahja Drançolli (redaktor përgjegjës), Ardian Gola, Gëzim Selaci, Abdulla Rexhepi e Kristë Shtufi për religjionet.

Takimet u zhvilluan me një qëllim kryesor, që deri më 25 maj të shmangen përsëritjet dhe të arrihet në një fjalës themelor të integruar për "Enciklopedinë shqiptare", e cila, pavarësisht organizimit të redaksive, do të jetë një vepër unike, me një listë të përbashkët të njësive enciklopedike (jo Tirana më vete, Prishtina më vete). Fjalësi i përbashkët është një kusht që mundëson zbatimin e kufijve dhe pragjeve të përbashkët përgjatë zbatimit (hartimit të artikujve, në përputhje me hierarkitë e brendshme mes tyre) dhe nuk përbën pengesë që të zbatohet parimi i territorialitetit në ndarjen e punës.

Në fjalësin e integruar do të përfshihet sipas fushave edhe lista e njësive

enciklopedike të propozuara prej redaksisë së posaçme të trashëgimisë shqiptare në Maqedoninë e Veriut.



Lista e integruar bën të mundur një përfytyrim të plotë mbi raportet mes saj dhe numrit të përgjithshëm të njësive që do të përmbajë "Enciklopedia shqiptare", me jo më shumë se 10 mijë artikuj. Këto raporte do të shërbejnë për të reflektuar nëse duhet të thellohet përzgjedhja apo ka hapësira për plotësime, sepse nga vetë natyra e tyre enciklopeditë kanë disiplinën e "shtratit të Prokrustit".

Deri në përfundim të kësaj faze redaksitë e fushave do të përpunojnë statistikisht edhe të dhëna të tjera: raportet numerike të artikujve të propozuar prej tyre me zërat e rimarrë nga FESH dhe FEK; sa janë njësitë e shtuara dhe sa të trashëguara nga botimet enciklopedike të mëparshme; cilat janë përqindjet që zënë fushat ndaj vëllimit tërësor. Kjo bëhet me qëllim që të bëhen krahasime dhe të vërehen mundësitë për optimizime të raporteve ndërfaqshore.



Të gjitha këto janë të domosdoshme për t'iu paraqitur mbledhjes së dy redaksive

---

vendore (3 qershor). Pa një panoramim të tillë vështirë të merren vendime për më tej.

Procesi i takimeve dhe bashkëbisedimeve midis redaksive sipas grupfushave të përfaqësuara do të vazhdojë deri më 25 maj 2024. Gjatë muajit qershor do të kalohet prej fjalës të integruar në fjalësin e stabilizuar.

Takimet u zhvilluan me një vullnet të përbashkët për të diskutuar e marrë vendime të arsyetuara drejt për një botim dinjitoz, siç e kërkon amza e trashëgimisë shqiptare.

## Njësimi i "Enciklopedisë shqiptare" nis me kriteret e miratuara nga redaksia qendrore dhe vijon me fjalësin e integruar dhe "pragjet" e barazuar për pranimin e njësive enciklopedike

- Një enciklopedi, një fjalës, një prag pranimi e vënieje në hierarki, një disiplinë shkencore në procesin e përgatitjeve dhe të zbatimit
- Frymë përgjegjësie e mendime konstruktive në të gjitha takimet
- Sot takimet e përbashkëta të katër redaksive të ngritura në Tiranë me gjegjëset e tyre në Prishtinë: redaksia e gjeografisë fizike (studiuesit Perikli Qiriazzi, Skënder Sala, Jostina Dhimitro, Pal Nikolla, Niko Rogo, Ermiona Braholli nga Tirana; si dhe Valbona Bytyqi, Selim Qevani e Tropikë Agaj nga Prishtina); redaksia e gjeografisë sociale (Dhimitër Doka, Bilal Draçi, Nevila Xhindi, Valbona Duri, Brisena Koplaku nga Tirana, si dhe Arsim Ejupi, Ibrahim Ramadani, Tomor Çela nga Prishtina); redaksia për ekonominë dhe financat (Adrian Civici, Selami Xhepa, Andi Koxhaj nga Tirana, si dhe Justina Shiroka-Pula, Besnik Krasniqi, Muhamet Alia, Nail Reshidi e Skënder Ahmeti nga Prishtina); redaksia për sistemet politike dhe drejtësinë (Aurela Anastasi, Altin Shegani, Arben Rakipi nga Tirana, si dhe Arsim Bajrami, Gjyljeta Mushkolaj, Ismet Salihu, Bekim Baliqi e Anton Vukpapaj nga Prishtina)



Morën pjesë në bashkëbisedimet e kësaj dite Dhimitër Haxhimihali (koordinatori i kësaj grupfushë nga redaksia qendrore); Shaban Sinani (drejtues i redaksisë vendore të Tiranës); Kosta Barjaba (koordinatori i caktuar për grupfushën nga redaksia vendore); Arian Leka (përgjegjës për botimet enciklopedike në QBEA).

Gjatë shkëmbimit të informacionit doli se redaksitë për ekonominë e financat, si



dhe dy redaksitë për gjeografinë (fizike dhe sociale) kanë tashmë një fjalës të integruar, pjesërisht të përzgjedhur. Redaksia për sistemet politike e drejtësinë do të kenë konkluduar për fjalësin e integruar deri më 25 maj.



Redaksitë do të paraqesin statistikat e domosdoshme për njohje e vendimmarrje nga redaksitë vendore dhe redaksia qendrore: numri i përgjithshëm i njësive enciklopedike për çdo fushë; sa prej tyre janë marrë nga fjalorët enciklopedikë ekzistues, përqindja që zënë ndaj numrit të përgjithshëm të njësive (10 mijë).

Fjalësi i integruar do të përmbajë edhe njësitë enciklopedike të propozuara nga redaksia e posaçme për trashëgiminë shqiptare në Maqedoninë e Veriut.

Kalimi nga pamja e copëzuar në atë të njësuar është një hap përcaktues për të vijuar më tej me njësimin e pragjeve për pranim dhe për vënie në hierarki, duke siguruar një standard të vetëm dhe një disiplinë shkencore në zbatim.





U theksua se në rastin e emërtimeve të përveçme për vende, male, lumenj etj. kriteri etnogeografik është më i rëndësishëm se ai i ndarjes administrative, që ka ndryshuar e ndryshon me vendime qeveritare e akte të tjera. Po ashtu, u kërkua që njësitë enciklopedike të gjeografisë të trajtohen si trashëgimi natyrore e lidhur me trashëgiminë historike-kulturore dhe që këto njësi duhet të përmbajnë edhe burimin dhe historinë e fjalës, trajtimin albanologjik të përmbajtjes.

U kërkua që dy akademitë të përgatisin dhe të nënshkruajnë kontrata shërbimi me institucionet e specializuara që ruajnë dhe shërbejnë të dhëna të nevojshme (shërbimi meteorologjik, Instat, arkivat shtetërorë etj.).



Përgatitja e "Enciklopedisë" ka nevojë dhe për mbështetjen me art grafik (foto, harta, diagrama, skica etj., që duhet të jenë origjinale ose të autorizuar).

Redaksitë do të përgatisin artikuj ilustrues, sipas modelit të propozuar nga redaksia qendrore, në mënyrë që shembujt t'u japin vlerë zbatuese parimeve e kriterëve të përgjithshme.

U pranua se përzgjedhja nuk mund të bëhet referuar një kriteri të vetëm, sepse kriteret e vetëmjaftueshëm nuk ka. Titujt profesionalë (akademik, profesor); titujt e nderit (dekorata, mirënjohje); titujt e mjeshtrisë (arte, sporte) janë sinjale për vëmendje shkencore, por vendimi do të merret rast pas rasti, mbështetur edhe në kriteret ndihmëse (themelimi i një institucioni, i një njësie shkencore a shërbimi, lënde apo disipline etj.).

Rënia dakord për "të njëjtët në nivel" (të përafërtit, të ngjashmit) në Shqipëri e në Kosovë, që mund të adresohen për artikuj të padiskutueshëm, që nuk kërkojnë kohë për vendimmarrje); për të kaluar më tej te "të krahadueshmit", dhe së fundi për t'u ndalur te

---

"të diskutueshmit", do të shërbejë për të marrë vendime të drejta, për të pranuar pragje të njësuar, duke ekonomizuar kohën e duke respektuar kalendarët e miratuar.

---

## Mbahen takimet e katër redaksive të ngritura në Tiranë me gjegjëset e tyre në Prishtinë për hartimin e "Enciklopedisë shqiptare"



- Redaksitë e fushave të arsimit, shkencave shoqërore, komunikimit dhe sportive u mblodhën për stabilizimin e fjalësit paraprak të "Enciklopedisë shqiptare", shkëmbimin e informacionit dhe vlerësimin e ecurisë mbi prurjet e propozuara prej redaksive të fushave përkatëse, duke shkuar drejt procesit të stabilizimit të një fjalësi themelor të integruar për gjithë hapësirën shqiptare



Në vijim të takimeve të redaksive të ngritura në Tiranë me gjegjëset e tyre në Prishtinë për hartimin e "Enciklopedisë shqiptare", sot, më 17 maj 2024, u mbajt takimi i redaksive të fushave: arsimimi, shkencat shoqërore, komunikimi dhe mjetet e komunikimit dhe sportet.

Të katër grupet bënë një paraqitje të punës së deritanishme të redaksive respektive Shqipëri - Kosovë dhe ballafaqime lidhur me artikujt e fjalësve, si dhe evidentimin e problematikave hasur gjatë punës.

Pas diskutimeve midis anëtarëve të redaksive u bë përcaktimi i detyrave dhe objektivave në vijim.

Nga grupi i punës ngritur për arsimin morën pjesë: Naser Zabeli, redaktor përgjegjës; Majlinga Gjellaj, anëtare; Blerim Saqipi, anëtar; Ismet Potera, anëtar; Selim Mehmeti, anëtar. Takimi u drejtua nga dr. Arian Leka, përgjegjës për botimet enciklopedike.

Nga grupi i punës ngritur për shkencat shoqërore - filozofi - sociologji - psikologji morën pjesë: Shemsi Krasniqi, redaktor përgjegjës; Blerim Latifi, anëtar; Dashamir Bërxulli, anëtar.

Nga grupi i punës në fushën komunikimi dhe mjetet e komunikimit, morën pjesë: Binak Kelmendi, redaktor përgjegjës; Mehmet Gjata, anëtar; Albana Beqiri, anëtare.

Grupi i punës sportet u përfaqësua nga Albert Mecini, redaktor përgjegjës.

Puna vijon sipas afateve të parashikuara. Ndërsa po kalohet nga fjalësi i njësuar drejt procesit të fjalësit të stabilizuar.

Fjalësi i integruar do të përmbajë edhe njësitë enciklopedike të propozuara nga redaksia e posaçme për trashëgiminë shqiptare në Maqedoninë e Veriut.



Kalimi nga pamja e copëzuar në atë të njësuar është një hap përcaktues për të vijuar më tej me njësimin e pragjeve për pranim dhe për vënie në hierarki, duke siguruar një standard të vetëm dhe një disiplinë shkencore në zbatim. Procesi i kalimit nga "Fjalësi paraprak" drejt "Fjalësit themelor" të stabilizuar e vë theksin mbi ndërkomunikimin mes redaksive të fushave, me kërkesën e arritjes së një marrëveshjeje mbi pragjet e pranimit dhe njësimin e prurjeve për çdo kategori, sipas emërtesave: terma, personalitete, dukuri, zhvillime, ngjarje, vende etj.

U diskutua edhe për artikujt ilustrues, sipas modelit të propozuar nga redaksia

---

qendrore, në mënyrë që shembujt t'u japin vlerë zbatuese parimeve e kriterëve të përgjithshme.

Takimet e redaksive të njëjta e të përafërta kryhen në kuadër të kalendarit për stabilizimin e "Fjalësit paraprak" të "Enciklopedisë shqiptare". Ato i shërbejnë shkëmbimit të informacionit dhe vlerësimit të ecuresë mbi prurjet e propozuara prej redaksive të fushave përkatëse dhe i paraprijnë punës për stabilizimin e një Fjalësi themelor të integruar për gjithë hapësirën shqiptare.



## **Pesë redaksi të tjera, të shkencave teknike e natyrore, konvergojnë propozimet për një fjalës të përbashkët të "Enciklopedisë shqiptare"**

- I pranishëm në takimet e punës kryeredaktori i ESH akad. Skënder Gjinushi  
- Sot takimi i parafundmë e redaksive të ngritura mbi bazën e disiplinave shkencore: të pranishëm drejtuesit dhe anëtarët e tyre nga Shqipëria e Kosova: redaksitë e matematikës dhe fizikës, të biologjisë dhe kimisë, të bujqësisë e blegtorisë, të gjeologjisë dhe minierave dhe të mjekësisë. Diskutime konstruktive dhe frymë konstruktive intelektuale e shkencore

- Pjesëmarrës nga grupfusha e redaksive të shkencave të natyrës studiuesit: Fatmir Hoxha, Mimoza Hafizi, Floran Vila, Fetah Podvorica, Qamil Haxhibeqiri, Behxhet Mustafa, Besnik Baraj, Ilia Mikerezi, Mirela Lika. Nga grupfusha e redaksive të bujqësisë, blegtorisë dhe ekonomisë së fshatit: Anila Hoda, Vjolla Ibro, Bajram Berisha, Skënder Kaçiu, Sali Aliu, Kurtesh Sherifi. Nga dy redaksitë e mjekësisë dhe shëndetit: Nestor Thereska, Anila Godo, Arsim Morina, Merita Koçinaj-Berisha, Elton Bahtiri. Nga dy redaksitë e gjeologjisë dhe minierave: Rrapo Ormeni Thoma Korini Naser Peci Kemajl Zeqiri Shkëlzen Shabani



Në mbledhjen e përbashkët të dy redaksive të disiplinave matematikë-fizikë dhe biologji-kimi, të Kosovës dhe të Shqipërisë, mori pjesë dhe diskutoi edhe akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe kryeredaktor i "Enciklopedisë shqiptare". Në fjalën e tij ai u ndal veçmas tek kriteret parësore dhe ndihmëse të nevojshme për konfirmimin e një personaliteti apo ngjarjeje si të denjë për të zënë vend në këtë vepër.

Për të gjitha fushat, tha ai, vlerësimi i personaliteteve që do të përfshihen në ESH duhet të bëhet me shumë maturi. Titujt shkencorë dhe profesionalë, titujt që jepen në arte dhe sporte, mirënjohjet e larta shtetërore, çmimet dhe gradat, janë kusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm.



Artikujt përmbledhës-përshkrues i japin zgjidhje problemit të përfshirjes së shumë personaliteteve, duke kufizuar relativisht numrin tërësor të artikujve, sidomos të emrave të përveçëm, pa ulur cilësinë e veprës si e tërë.

"Enciklopedia" është projekt për prurjet shqiptare në trashëgimi, por do të përmbajë në një përqindje relative edhe terma të përgjithshëm ndërkombëtarë dhe personalitete të huaja të lidhura me Shqipërinë (ose të palidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë, por që "kanë bërë epokë", si për shembull Isaac Newton).

Hartuesit e fjalësit, përgjegjësit dhe anëtarët e redaksive, e kanë për detyrë të hulumtojnë nëpër botë për personalitete shqiptare që kanë jetuar jashtë dhe kanë dhënë kontribut në shkencat e natyrës në vendet ku kanë jetuar dhe punuar.

Fjalorët enciklopedikë ekzistues janë orientues dhe jodetyrues gjatë vendimmarjes se cilët personalitete do të përfshihen në ESH. Jo domosdoshmërisht gjithë emrat që përmenden në FESH e në FEK do të gjejnë pasqyrim edhe në ESH. Në një moment më të vonë, pasi lista e personaliteteve të jetë stabilizuar si për Shqipërinë ashtu edhe për Kosovën, do të duhet të bëhet kujdes i veçantë lidhur me përcaktimin e madhësisë së

artikullit për secilin personalitet, nëse do të jetë artikull më vete apo do të përfshihet në një artikull përmbledhës etj.

Në ESH duhet të dalë në pah që ekziston një "shkollë shqiptare" e shkencave të natyrës. Vërtet historia, si fushë, është pjesë e identitetit kombëtar, por ndërkohë edhe shkencat ekzakte kanë kontribuar në formimin e shoqërisë brez pas brezi. Është e qartë që "Enciklopedia" drejtohet më shumë për nga tradita e trashëgimia, megjithatë, përsa u përket personaliteteve, duhet të qartësohen përfundimisht kriteret mbi bazë të të cilave është kryer përzgjedhja e tyre, tha në përfundim akad. Gjinushi.

Sot u zhvilluan edhe takimet e redaksive të mjekësisë, të gjeologjisë e minierave, të bujqësisë e blegtorisë dhe të biologjisë e kimisë, që u asistuan nga drejtuesi i redaksisë vendore Shaban Sinani dhe përgjegjësi për botimet enciklopedike në QBEA Arian Leka. Një seancë plenare u zhvillua me të gjitha redaksitë së bashku.



U vërejt se redaksitë kanë qenë përzgjedhëse në punën e tyre; numri i njësisve enciklopedike të propozuar është në kufij të arsyeshëm; artikujt janë ndarë në kategori: të konfirmuar, për t'u diskutuar dhe rezervë. Ekziston një mirëkuptim i plotë midis redaksive gjegjëse dhe takimet "in situ" kanë shërbyer për të zgjidhur problemet.

U ritheksua se, pavarësisht ndarjes së punëve midis dy redaksive vendore dhe pa cënuar kriterin e territorialitetit, "Enciklopedia" është një e vetme dhe njësimi nis me fjalësin e përbashkët. Është sukses që të gjitha redaksitë ose i kanë bashkuar propozimet e tyre në një fjalës të integruar, ose janë në përfundim të këtij procesi. Pasi të jetë krijuar një pamje e përgjithshme e tërësore e lëndës së ESH, përmes fjalësit themelor, dy redaksitë vendore dhe ajo qendrore mund të shqyrtojnë edhe raste përjashtimorë ("droit de derogation"), që mund të pranohen për të optimizuar raporte krahinore, periudhash historike, dukurish kulturore e fetare, tha z. Sinani. Ndërkohë, theksoi ai, redaksitë e

---

shkencave të sakta mund të ndriçojnë në artikujt e tyre edhe aspekte albanologjike (rastet e bimësisë endemike ose të llojeve që lidhen me botën shqiptare - lulja "Gentiana", fjala vjen; rastet me lidhje gjuhësore të hershme, me histori shqiptare). Ky është rasti që "albanizmat" në shkencat shoqërore dhe "albanitet" në shkencat teknike të përfaqësohen denjësisht, por edhe kufijtë midis shkencave albanologjike dhe atyre natyrore-teknike të zbuten, sepse botë shqiptare dhe albanologji ka edhe në etnoflorë e etnofaunë, edhe në gjenetikë, edhe në emërtimet e vendeve, edhe në gjeografinë fizike e sociale.



U vu në dukje se enciklopeditë nga natyra e tyre, i largohen modelit të leksikonit dhe fjalorit, kanë më shumë emërtime të përgjithshme, ngjarje, trashëgimi, zhvillime, procese dhe terma. Raportet midis këtyre kategorive mund të optimizohen përmes përfshirjes së emrave të përveçëm (njerëz, institucione, ente, subjekte) tek kategoria referenciale e përgjithshme (hotelet tek turizmi, fabrikat e uzinat tek dega e industrisë etj.).

Në përfundim u tha se mbledhja e përbashkët e dy redaksive vendore, të Tiranës dhe Prishtinës, që do të zhvillohet në ASHSH më 3 qershor, po përgatitet me përgjegjësi.



## **Përfundojnë takimet dypalëshe të redaksive të ngritura sipas fushave / disiplinave në Tiranë e në Prishtinë për "Enciklopedinë shqiptare"**

- Fjalësi i njësuar realizohet sipas kalendarit: një enciklopedi, një fjalës -
- Sot u takuan redaksitë për mjedisin, redaksitë për inxhinieritë dhe teknologjitë, redaksitë për gjeologjinë dhe minierat, redaksitë për energjitë. Të pranishëm anëtarët koordinues nga redaksia vendore, akademikët Dhimitër Haxhimihali e Ilirjan Malollari -



Redaksitë për mjedisin informuan fillimisht mbi gjendjen e "Fjalësi paraprak" në prurjet e pavarura të tyre. Në vijim u shqyrtua taksonomia e "Fjalësit të harmonizuar" mes shprehjes në termave përgjithësues, dukurive dhe ngjarjeve, duke ua kaluar këtyre përparësinë mbi emrat e përveçëm.

Në vijim takimi u përqendrua në çështjet harmonizimit të mëtejshëm mes dy fjalësve, të shmangies përfundimtare të mbivendosjeve dhe të unifikimit e prurjes së përbashkët të listës së njërive enciklopedike deri më datë 25 maj 2024.

Nga të dyja redaksitë u theksua se fryma e gatishmërisë dhe e bashkëveprimit ka qenë e lartë, gjë që dëshmohet nga takimet e drejtpërdrejta, nga komunikimet online, nga shkëmbimi i fjalësve paraprakë të secilës redaksi ndaj tjetrës, që siguruan klimën e unifikimit të materialeve sipas afateve.



Dy redaksitë morën në shqyrtim dhe bënë komente të veçanta ndaj prurjeve respektive, duke u ndalur rast pas rasti mbi propozimet paraprahe lidhur me organizimin e lëndës enciklopedike rreth institucioneve, praninë e zërit përgjithësues, vendin që duhet të përfaqësojë në ESH ligjshmëria dhe konventat ndërkombëtare në lidhje me mjedisin, ku Shqipëria dhe Kosova aderojnë.



Redaksia ka shënjuar me sinjalistikë sipas hijezimit përmes ngjyrave ndarjen e zërave sipas parimit të rëndësisë, duke veçuar po me këtë teknikë prurjet e reja nga trashëgimia FESH-FEK dhe përqindjet në përfaqësimin e përgjithshëm.

Mbi artikujt “zëra të përveçëm - personalitete” redaksitë shqyrtuan qëndrimet mbi praninë në ESH të të pashmangshmëve dhe themeltarëve, duke propozuar që për personalitetet e fushës së mjedisit me veprimtari e krijimtari të hapur përfaqësimi të realizohet përmes institucioneve ku ata kanë kontribuar.



Redaksitë relatuan që prurjet e reja përballë atyre të trashëguara nga FESH dhe FEK të jenë përafërsisht në masën 1 me 3, duke u dhënë përparësi artikujve të rinj apo dhe artikujve që trashëgohen, por që vijnë të përmirësuar, të zgjeruar apo të rivlerësuar edhe në hierarkinë e përfaqësimit.

Redaksitë u dakordësuan mbi formatet e shkallëzuar të artikujve. Ato ranë dardkod që deri më 25 maj 2024 të kryejnë edhe një takim online me qëllim konsultativ dhe informues për të shmangur dyemërtesat e institucioneve me funksione të njëjta në Shqipëri e Kosovë, si dhe për qartësimin e kriterëve të veçanta, përveç atyre që parashikon udhëzuesi, lidhur me personalitetet.



Pas takimit të datës 25 maj 2024 redaksitë do të paraqesin pranë QBEA "Fjalësin e njësuar" e të dakordësuar në formën e vet përfundimtare që, nga 450 artikuj, synon të silltet në 350 njësi enciklopedike të alfabetizuara, numerizuara dhe të ndarë sipas hierarkisë së brendshme të disiplinës.

Në takimin e redaksive për energjitë dhe energjetikën ishin të pranishëm: Naser Sahiti, Prishtinë, redaktor përgjegjës dhe Fejzullah Krasniqi. Nga redaksia në Tiranë morën pjesë

Rajmonda Buhaljoti (redaktore përgjegjëse) dhe Marialis Çelo. Dy redaksitë raportuan se kanë realizuar edhe dy takime të tjera paraprake, konkretisht: i pari gjatë muajit dhjetor; i dyti gjatë ditëve të panairit të librit akademik. Takimi i sotëm është takimi i tretë i radhës.

Aktualisht të dyja redaksitë kanë hartuar një fjalës paraprak të harmonizuar mes tyre. Fjalësi i Shqipërisë ka të përcaktuar edhe madhësinë e zërave, ndërsa fjalësi i Kosovës ende jo - por kjo gjë është e realizueshme brenda afatit.

Anëtarët e redaksive bënë një konfrontim të ri mes dy fjalësave respektivë për të evituar ndonjë përsëritje të mundshme dhe u dakordësuan për sa i përket pjesës së fjalësit që ka të bëjë me ngjarjet, fenomenet, termat e përgjithshëm, si dhe njësuan gjuhën atje ku

---

ishte e nevojshme përta i përket sjelljes së terminologjisë në shqipen e njësuar.

Në lidhje me personalitetet, të dyja redaksitë raportuan se kanë hasur në vështirësi që rrjedhin për shkak të mospërcaktimit/perceptimit të qartë të kriterëve përzgjedhëse. Hapi i radhës mbetet konsultimi me fjalësin e redaksisë së industrive dhe teknologjive, për të parë ndonjë mbivendosje të mundshme dhe sheshimin e tyre. Mbas kësaj do të përgatitet draft-fjalësi i harmonizuar i përbashkët, sikundër është kërkuar brenda afatit kohor 27-28 maj. Por në këtë fjalës jo gjithçka do të jetë përfundimtare për listat e personaliteteve, për shkak të vështirësive që kanë të bëjnë me kriteret përzgjedhëse, të cilat nevojitet të jenë të njësuara.

Gjatë takimeve të datës 24 maj 2024 midis redaksive të Shqipërisë dhe Kosovës për fushat: industri dhe teknologji, energji dhe energjetikë, mjedis, mori pjesë edhe përgjegjësi për redaksinë vendore të Shqipërisë akad. Shaban Sinani, si dhe përgjegjësi për botimet enciklopedike dr. Arian Leka. Gjatë fjalës së tij në takimin e përbashkët përmbyllës, ai theksoi këto çështje:

Enciklopedia ndryshon në tipologji dhe në strukturë nga fjalorët enciklopedikë. Këtë fakt redaksitë duhet ta kenë të qartë tashmë.

Redaksitë kanë arritur në një "Fjalës të përbashkët/ të integruar", jopërfundimtar, i cili do të shërbejë si pikënisje për përmirësime të mëtejshme.

Brenda datës 25 maj 2024 parashikohet dorëzimi i "Fjalësit të përbashkët" nga të gjitha redaksitë e fushave. Bashkë me listat do të dorëzohet edhe një tabelë statistikore me këto të dhëna: emërtimi i redaksisë, fjalësi i integruar - numri i njësive të tij; sa prej tyre janë të reja/shtesë (që nuk gjenden paraprakisht në FESH ose FEK), si dhe vendi në përqindje i fjalësit të çdo njësie ndaj numrit total të njësive.

ESH do të ketë një strukturë katërpjesëshe, të përbërë nga: personalitete, ngjarje, zhvillime/dukuri dhe terma të përgjithshëm. Këta të fundit do të jenë pjesë e "Enciklopedisë", pasi shqiptarët nuk janë "një ishull", për pasojë, në këtë produkt intelektual duhet të gjejnë pasqyrim edhe artikuj të karakterit ndërkombëtar.

Njësimi i termave është i domosdoshëm, pasi, në të ardhmen, në institucionet e Bashkimit Europian, gjuha shqipe do të ketë një sportel të vetëm, për pasojë duhet t'i paraprijmë këtij vizioni, kësaj asprate.

Personalitetet janë dhe do të mbeten edhe për disa kohë një temë sensitive. Për të lehtësuar sadopak barrën e përzgjedhjes së saktë të tyre, duhet të vihet në punë përdorimi i kriterëve ndihmëse. Kjo nënkupton që titujt e nderit, gradat shkencore etj., janë parakushte të domosdoshme, por jo të mjaftueshme që një personalitet të përfshihet ose jo artikull më vete në ESH. Emrat "kandidatë" duhet të kenë patjetër edhe ndonjë meritë shtesë të veçantë apo ndonjë tregues diferencues, që i bën të spikatin krahas personaliteteve të tjera të fushës. Një pjesë e këtyre emrave, që do të gjenden ngultas në udhëkryqin e përfshirjes ose lënies jashtë, mund të gjejnë "strehë" në artikujt e

---

institucioneve ku ata kanë zhvilluar aktivitetin në Shqipëri dhe Kosovë.

Redaksitë e fushave, të të dy vendeve, do të punojnë me pragje të njëjtë të përzgjedhjes. Redaksitë qendrore dhe vendore respektive do të vihen në dijeni për këto pragje dhe për metodologjinë e ndjekur në përzgjedhje.



Fjalësi, që do të përgatitet deri në fund të qershorit, do të jetë “listë themelore e njësive enciklopedike” dhe mbi të, nëse për arsye të rëndësishme, del e nevojshme, do të përdoret një “droit de dérogation” në kuptimin pozitiv. Pra, mund të vendoset të krijohet një hapësirë në të cilën të përfshihen disa personalitete, ngjarje etj., të një tipologjie të veçantë, të cilët në të kundërt mund të mbeteshin jashtë "Enciklopedisë".

Redaksitë e fushave meritojnë vlerësim pasi kanë punuar seriozisht dhe janë në konvergjencë midis tyre.

---

# **Mbi ecurinë e projektit “Historia e Shqiptarëve”**



## Takim i redaksisë së "Historisë së shqiptarëve" në Kryesinë e Akademisë së Shkencave

Ky takim u zhvillua në zyrën e Kryetarit të Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi dhe nën drejtimin e tij, në kuadër të raportimeve periodike për gjendjen aktuale të projektit "Historia e shqiptarëve", i parashikuar për t'u përmbyllur si punë shkencore brenda vitit 2024.



Morën pjesë drejtuesit e redaksive të periudhave të mëdha historike: prof. dr. Neritan Ceka (lashtësia); akad. Pëllumb Xhufi (Mesjeta), prof. dr. Ferit Duka (periudha nga fundi i Mesjetës deri në shek. XX) dhe prof. dr. Paskal Milo (historia bashkëkohore).

Drejtesit e redaksive njoftuan se dy vëllimet e para të "Historisë së shqiptarëve" do të dorëzohen për botim në gjendje të përfunduar deri në fund të muajit dhjetor 2024 dhe do të jenë të gatshëm për botim gjatë vitit 2025. Vëllimi i tretë gjithashtu do të jetë i përfunduar si punë hartuese deri në fund të këtij viti, por dorëzimi për shtyp është parashikuar për mesin e vitit 2025. Gjatë atij viti do të ketë përfunduar (duke përfshirë redaktimin shkencor, gjuhësor, letrar e teknik) edhe vëllimi i katërt, që i përket periudhës bashkëkohore.

Gjatë këtij takimi, përveçse për kalendarin, u diskutua edhe për njësimin e shkrimit akademik në të katër vëllimet; për kalimin e natyrshëm nga njëra periudhë në tjetrën dhe nga një vëllim në tjetrin; për sistemin e referencave, të shënjimeve dhe të bibliografisë; për recensuesit e mundshëm të veprës.

Akad. Gjinushi theksoi se është e rëndësishme që vepra, pavarësisht pranisë së shumë autorëve dhe stileve, duhet të ketë strukturë e formë si një e tërë. Në këtë fazë të fundme, tha ai, është momenti që redaksitë e krijuara sipas periudhave të komunikojnë mes tyre për të mos lejuar momente të pambuluara. Ky komunikim duhet edhe për

---


rikapitulimin tërësor të lëndës së shkruar. Në gjendjen e përfunduar vepra duhet t'i përgjigjet - në vija të përgjithshme - prospektit të saj, miratuar edhe në pikëpamje të strukturës, edhe në pikëpamjen formale-zyrtare. Për të lehtësuar "kapërcimin e kufijve" nga një periudhë në tjetrën dhe nga një redaksi në tjetrën (p. sh., nga lashtësia tek mesjeta) problemin e zgjidhin rimarrjet.



---

**Botime të reja**

**Botohet italisht, me titullin "La guerra di Scutari - da un manoscritto sconosciuto di Marino Barlezio" ("Lufta e Shkodrës - nga një dorëshkrim i panjohur i Marin Barletit"), dalë më parë në shqip, me titullin "Barleti i hershëm", sipas një dorëshkrimi të panjohur të Marin Barletit**



Akademia e Shkencave mundësoi daljen në dritë të kësaj vepre edhe në gjuhën italiane, nismë dhe projekt i "Njësisë së kërkim-studimit për arbëreshët, arvanitët dhe arbneshët" që funksionon pranë saj dhe kryesohet nga akademikët Francesco Altimari e Matteo Mandalà.

Dorëshkrimi i panjohur i Barletit (variant i mëhershëm se teksti që përmban vepra "Rrethimi i Shkodrës"), u zbulua nga prof. dr. Aurel Plasari në Bibliotekën e Parisit. Studimi hyrës u realizua nga prof. dr. Lucia Nadin. Botimi i plotë, që përfshin edhe riprodhimin anastatik të dorëshkrimit, përveç përkujdesjes kritike-filologjike, u përgatit

nga dy autorët Nadin e Plasari. Po ashtu dhe pajisja me shënjime të natyrës historiografike, gjuhësore dhe kulturore.



Parathënia është shkruar nga Matteo Mandalà dhe ent botues në Itali është e mirënjohura "Viella".

Me botimin e këtij dorëshkrimi autograf të Marin Barletit zgjidhet përfundimisht problemi i autorësisë së veprës "Rrethimi i Shkodrës", çështje e hapur dhe e mbetur pezull në diskutime shkencore albanologjike prej më shumë se një shekulli.

Botimi kontribuon për zgjerimin e bibliografisë së literaturës për Shqipërinë dhe shqiptarët në bibliotekat dhe burimet albanologjike europiane. Shekujt e humanizmit europian dhe të qëndresës antiosmane në këtë anë të Adriatikut gjejnë një tjetër referencë të re themelore.

Në vijim shënjimi shoqërues i "Viella Editrice" në anën e pasme të ballinës së botimit italisht, për autorin e dorëshkrimit dhe veprën e tij të sapodalë nga shtypi:

Marino Barlezio, scutarino, primo storico di Albania, nelle due opere "De obsidione Scodrensi" (1504) e "De vita et gestis Scanderbegi" (1510 ca.) raccontò le vicende di cui il suo Paese fu protagonista nel secondo Quattrocento, fino alla presa di Scutari nel



---

1478, ed esse furono una fonte cui attinse nei secoli successivi la storiografia europea. Gli stessi cronisti ottomani non mancarono di descrivere la conquista di Scutari - da loro chiamata "İskenderiye", cioè "Città di Alessandro Magno" - come il passo decisivo personale di Maometto II per realizzare il progetto di sottomissione della rimanente parte dell'Europa.

Il libro presenta uno sconosciuto primissimo testo di Barlezio, *De bello scodrensi*, ritrovato dopo lunghe ricerche, lo inquadra nel contesto storico, ne ricostruisce le fasi redazionali. Invita altresì alla conoscenza di un memorabile evento bellico che non fu questione esclusivamente albanese o veneta, ma si pone come momento chiave nelle vicende di un conflitto che, deflagrato con la caduta di Costantinopoli, avrebbe mantenuto l'Europa in uno stato di permanente inquietudine.

---

# Nekrologji

---

## U nda nga jeta prof. Andrea Shundi ("Nderi i Akademisë")



Kryesia e Akademisë së Shkencave njofton me hidhërim e dhimbje se është ndarë nga jeta studiuesi i mirënjohur i shkencave bujqësore; një nga emrat më të nderuar të inxhinierisë agrare; figurë qendrore shkencore e vreshtarisë dhe verëtarisë; bashkëpunëtor e drejtues për një periudhë pesëvjeçare në strukturat e ASHSH dhe i nderuar me mirënjohjen "Nderi i Akademisë" Andrea Shundi.

Akademia e Shkencave u shpreh ngushëllime familjes dhe të afërmve, bashkësisë së studiuesve dhe kolegëve të tij, që humbën një njeri punëtor, pasionant dhe të ndershëm, që deri në momentet e fundit të jetës nuk pushoi së studiuar e kërkuar; një personalitet që la emër të mirë e të nderuar kudo që jetoi e punoi. Ne të gjithëve do të na mungojë energjia, përkushtimi, qytetaria dhe buzëqeshja e tij; prirja e tij origjinale për t'u dhënë kërkimeve agronomike edhe një përbërëse antropologjike e etnologjike, duke i ndërlidhur ato me albanologjinë. Do të na mungojë bashkëpunimi i tij i frytshëm si organizator ngjarjesh shkencore dhe në kuadër të projektit të "Enciklopedisë shqiptare" si anëtar i njërës prej redaksive të saj.

Meritat shkencore të Andrea Shundit janë vlerësuar edhe me çmimin më të lartë kombëtar që jepet nga Akademia e Shkencave për shkencat natyrore e teknike, çmimin

---

"Radovicka" (bashkë me akad. Nazim Grudën, 2018).

Profesor Andrea Shundi u lind në Tiranë më 1934. Mbas përfundimit të gjimnazit kreu studimet për agronomi në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Më shumë se gjysmën e jetës aktive e kishte të ndërlidhur me veprimtarinë në institucione shkencore: në Institutin e Kërkimeve Bujqësore në Lushnjë (1956-1960, bashkëpunor shkencor); në Universitetin Bujqësor (1980-1992, ligjërues, dekan i fakultetit); në Akademinë e Shkencave (1994-1999, sekretar shkencor i seksionit dhe kryeredaktor i revistës "AJNTS"). Gjatë periudhës tjetër punoi në ekonomi bujqësore dhe administratë teknike, kryesisht në ministrinë e bujqësisë (1964-1975, kryeagronom, drejtor i shkencës, kryeredaktor i "Buletini i Shkencave Bujqësore").

Veprimtarinë shkencore e përqendroi në prodhimin foragjer dhe në vreshtari-verëtari. Ka qenë kumtues në 34 kuvende shkencore kombëtare dhe në 18 evente ndërkombëtare, si dhe pjesëmarrës në 17 studime dhe projekte kombëtare. Andrea Shundi ka qenë gjithashtu ligjërues në universitetet e Viterbos dhe Potencës (Itali), si dhe në Selanik (Greqi). Ishte bashkorganizues i konferencës kombëtare të shkencave bujqësore (1975); i simpoziumit "Shkencat agronomike në zhvillimet e reja ekonomike të Shqipërisë" (1991); si dhe i shumë seminareve mbarëkombëtare për vreshtarinë dhe verëtarinë (2002-2010).

Dy vjet më parë kryesoi konferencën kushtuar llojeve endemike të rrushit në Shqipëri e Kosovë, konferencë shkencore dyditore nga më të rëndësishmet në verëtari e hortikulturë, organizuar nga Akademia e Shkencave.

Veprimtaria botuese e prof. Andrea Shundit përfaqësohet me mbi 48 libra (nga të cilët dy në anglisht) dhe tekste, me një vëllim mbi 10 mijë faqe. Krahas tyre ka botuar rreth 30 artikuj shkencorë dhe 128 artikuj teknikë, një pjesë të botuar në revista ndërkombëtare dhe në me procedurë konkurrimi ("proceedings"). Titujt kryesorë të veprave të botuara prej tij janë: "Agroteknologji dhe veçori të prodhimit foragjer intensiv" (1984), "Fitoteknia" (tekst universitar, 1980 dhe 1987), "Ligjësi dhe parametra për selitjen e bimëve" (1984), "Foragjeret në zonën e ftohtë" (2004), "Vreshtaria dhe verëtaria shqiptare" (2004), "Enciklopedia për vreshtarinë dhe verëtarinë" (2012), "(E)tnogastronomia arbëreshe" (2016), "Verëtaria praktike" (2019), "Hortikultura - vështrim enciklopedik" (2017), "Prodhimi shtëpiak i rrushit dhe i verës" (2008), "Wisdom from vine and wine" (2012), "Doracak për sistemimin e tokave" (1969), "Bujqësia dhe veprimi agronomik në troje shqiptare" (2001), "Jetë agronomike" (2004). Akademia e Shkencave ka miratuar botimin e një libri tjetër në bashkautorësi këtë vit, ku ai është autori i parë: "Ushqimi dhe (eno)gastronomia shqiptare" (2024).

Andrea Shundi është nderuar me urdhrin "Mjeshtër i Madh" (2010) dhe me mirënjohjen "Nderi i Akademisë".

Pushoftë në paqe miku ynë i shtrenjtë Andrea Shundi.

